(3) Plani hapësinor i Republikës së Maqedonisë dhe planet urbanistike në vazhdimësi reciprokisht harmonizohen dhe plotësohen.

Neni 3

Përpunimi, miratimi dhe zbatim i Planit hapësinor të Republikës së Maqedonisë, planeve urbanistike, planit rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacioneve të projektit urbanistik janë punë me interes publik.

Neni 4

(1) Me planifikimin hapësinor dhe urbanistik rregullohen парimet темелоре në procesin e planifikimit dhe rregullimit hapësinor.

(2) Parime në procesin e planifikimit dhe rregullimit hapësinor janë:

- zhvillimi hapësinor i barabartë;
- rregullimi dhe shfrytëzimi racional i hapësirës;
- kushtet për jetesë humane dhe punë të qytetarëve;
- tejkalimi i barrierave urbanistike të personave me invaliditet;
- zhvillimi i qëndrueshëm;
- mbrojtja dhe përparimi i mjedisit jetësor dhe natyrës;
- mbrojtja e trashëgimisë së patundshme kulturore;
- mbrojtja nga rrënimet nga lufta, nga katastrofa natyrore dhe teknologjike dhe avari dhe
- transparenca në procedurën e miratimit dhe zbatimit të dokumentacionit të planit.

Neni 5

Shprehje të veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë këtë domethënie:

- **planifikim i hapësirës** është përpunimi dhe miratimi i dokumentacionit të planit si vijon: planit hapësinor, planeve urbanistike, planit rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik, dokumentacioneve të planit urbanistik dhe dokumentacioneve të projektit urbanistik,
- **Plan hapësinor** është plani për dedikim dhe shfrytëzim në hapësën e territorit të Republikës,
- **plan urbanistik** është plani për rregullimin dhe shfrytëzimin e hapësirës në kuadër të përfshirjes së planit të qytetit, fshatit ose rajonit tjetër të përcaktuar në plan,
- **dokumentacioni i planit urbanistik** është dokumentacioni i planit me të cilin kryhet rregullimi edhe shfrytëzimi hapësirës në kuadër të përfshirjes së planit ose jashtë përfshirjes së planit varësisht nga lloji i ndërtimeve për të cilat ka të bëjë i njëjti,
- **plan rregullues i planit të përgjithshëm urbanistik** është plani me të cilin mund të kryhet përpunimi i përfshirjes në plan të planit të përgjithshëm urbanistik për përcaktimin e kufijve për planifikim detal,
- **projekt arkitektonik-urbanistik** është dokumentacioni i projektit urbanistik i cili përpunohet kur në një parcelë ndërtimore në planin urbanistik përkatësisht dokumentacionin e planit urbanistik është përcaktuar hapësirë caktuar me vija ndërtimore në të cilën është lejuar vendosja e sipërfaqeve për ndërtim të më shumë ndërtimeve dhe për formimin e parcelave ndërtimore në rastet e përcaktuara me këtë ligj,
- **projekt për infrastrukturë** është dokumentacioni i projektit urbanistik që përpunohet për objekte të linjës infrastrukturore të përcaktuara me Ligjin për ndërtim, si dhe për objekte infrastrukturore të përbëra nga më shumë pjesë prej të cilave së paku një pjesë paraqet infrastrukturë të linjës,
- **kushte për planifikim të hapësirës** janë ekstrakti i planit hapësinor në cilin janë shënuar kushtet më të afërta për përpunimin e planeve nga niveli më i ulët,
- **program i planit** është programi me të cilin përcaktohen kufijtë dhe përmbajtjet e përfshirjes së planit,
- **përfshirja e planit** është rajon kufijtë e të cilit, mënyra e rregullimit dhe shfrytëzimit përcaktohen me planin urbanistik dhe dokumentacionin e planit urbanistik,
- **infrastrukturë** janë instalimet ekzistuese dhe të planifikuara, nëntokësore dhe mbitokësore, infrastruktura e komunikacionit, përçues elektroenergetikë, gazpërçues, naftëpërçues, përçues të nxemjes, infrastruktura e telekomunikacionit, sisteme të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe lloje të tjera të instalimeve,
- **parcelë ndërtimore** është toka ndërtimore e planifikuuar për ndërtimin e objektit, ndërsa e përshinë tokën nën ndërtim dhe tokën për përdorim të rregullt të ndërtimit, kufijtë e së cilës janë përcaktuar me planin urbanistik, dokumentacionin e planit urbanistik dhe dokumentacionin e projektit urbanistik,

- **linjë ndërtimore** është linjë që e përcakton sipërfaqen për ndërtim të objektit në kuadër të parcelës ndërtimore,

- **linjë rregulluese** është kufiri mes tokës ndërtimore për përdorim të përgjithshëm dhe tokës ndërtimore të parcelizuar në parcela ndërtimore të dedikuara për ndërtim individual,

- **zgjidhje e nivelizimit** është prezantim vertikal i terrenit me të dhëna teknike për gjendjen dhe animin dhe marrëdhënien ndaj ndërtimeve të planifikuara,

- **paraqitje digjitale** e planit urbanistik, planit rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacioni të projektit urbanistik është leximi i të dhënave nga planet që kanë të bëjnë me parcelat ndërtimore, sipërfaqet për ndërtim dhe atributet e tyre përkatëse në Regjistrin grafik për tokë ndërtimore, që është vendosur në pajtim me Ligjin për kadastrë të patundshmërive,

- **baza të azhurnuara gjeodezike** janë plane të kadastrës në përpjesëtim përkatës, me paraqitje të gjendjes ekzistuese të tokës, parcelave të kadastrës, ndërtimeve dhe të dhëna për instalimet (nëntokësore, mbitokësore, ajrore), me toka të nivelit të terrenit,

- **ekstrakt i Planit hapësinor të Republikës së Maqedonisë** është kopja nga pjesa grafike e Planit hapësinor të Republikës së Maqedonisë, që ka të bëjë me pjesën e territorit të Republikës së Maqedonisë dhe përshkrimin e kushteve më të afërta për planifikimin hapësinor për përpunimin e projektit për infrastrukturë,

- **ekstrakt i planit urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik** dhe dokumentacionit të projektit urbanistik është kopja e pjesës grafike dhe tekstuale të planit dhe përshkrim i dispozitave për realizimin e të njëjtit, i cili mund të vlejë për një ose më shumë parcela ndërtimore, ose tërë planin varësisht nga nevojat,

- **përpunues i planit urbanistik, planit rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik** dhe dokumentacioni të projektit urbanistik është personi juridik bartës i licencës për përpunimin e planeve urbanistike të lëshuar sipas dispozitave të këtij ligji, që përpunon planin urbanistik, dokumentacionin e planit urbanistik, planin rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik, dokumentacionin e planit urbanistik dhe dokumentacionin e projektit urbanistik,

- **miratuesi i planit urbanistik** është komuna, komuna në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit këshilli i të cilit e miraton planin urbanistik,

- **sistem informativ për përpunimin dhe zbatimin e procedurës për miratimin e planeve urbanistike, planeve rregulluese të planit të përgjithshëm urbanistik, dokumentacioneve të planit urbanistik dhe dokumentacioneve të projektit urbanistik** është sistemi i përbërë nga pajisja teknike (serverë dhe pajisje tjera të haduerit), pa baza e të dhënave dhe programi i softuerit si sistem unik qendror për lidhjen e shfrytëzuesve (në tekstin e mëtejshëm: sistemi informativ e-urbanizëm).

Neni 6

(1) Në procedurën gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese do të zbatohen dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(2) Gjatë zbatimit të planeve urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacionit të projektit urbanistik, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

II. PLANIFIKIMI HAPËSINOR

1. Llojet e planit

Neni 7

(1) Varësisht nga hapësira e cila është lëndë e planifikimit miratohen planet si vijojnë:

- 1) Planit hapësinor i Republikës së Maqedonisë dhe
- 2) planet urbanistik:
 - plani i përgjithshëm urbanistik;
 - plani detal urbanistik;
 - plani urbanistik për fshat dhe
 - plani urbanistik jashtë vendbanimit.

(2) Varësisht nga lloji i ndërtimit që është lëndë e planifikimit miratohen llojet e dokumentacionit të planit urbanistik, si vijojnë:

- dokumentacioni i planit urbanistik lokal;
- dokumentacioni i planit urbanistik shtetëror;
- dokumentacioni i planit urbanistik për zonë zhvillimore turistike;
- dokumentacioni i planit urbanistik për autokamp dhe
- dokumentacioni i planit urbanistik për ndërtime me interes të veçantë.

2. Planit hapësinor i Republikës së Maqedonisë

Neni 8

(1) Planit hapësinor i Republikën e Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Planit hapësinor), miratohet për territorin e tërë Republikës dhe paraqet strategji për zhvillim hapësinor të Republikës, i cili jep udhëzime për dedikimin, shfrytëzimin, mbrojtjen, organizimin, rregullimin dhe menaxhimin me hapësirën e Republikës.

(2) Planit hapësinor i përmban dedikimin themelor të tokës, udhëzime për menaxhim dhe shfrytëzim të hapësirës, vendosjen hapësinoe të ndërtimeve ekonomike dhe joekonomike, rrjetin e vendbanimeve, vendosjen hapësinoe të infrastrukturës së komunikacionit dhe tjetër, vlerësimin strategjik të ndikimit mbi mjedisin jetësor, udhëzime dhe masa për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor dhe të natyrës, masa për mbrojtjen e trashëgimisë së patundshme kulturore, masa për mbrojtje nga rrënime luftarake, masa për mbrojtje nga katastrofat natyrore dhe teknologjike dhe avari, parametra për zbatimin e planit dhe paraqitje përkatëse grafike.

(3) Planit hapësinor përpunohet përmes planit hapësinor të rajonit, planit hapësinor të komunës, të komunës në qytetit të Shkupit dhe të qytetit të Shkupit dhe planit hapësinor për rajonin me interes publik për Republikën.

Neni 9

(1) Planit hapësinor për rajonin dhe plani hapësinor për rajonin me interes publik për Republikën janë pjesë përbërëse të Planit hapësinor me të cilin i njëjti përpunohet.

(2) Planit hapësinor për rajonin përpunohet për rajonin i cili paraqet tërësi gjeografike, ekonomike ose funksionale e përcaktuar me planin hapësinor.

(3) Planit hapësinor i komunës, i komunës së qytetit të Shkupit dhe i qytetit të Shkupit përpunohet për rajonin e komunës, për rajonin e komunave të Qytetit të Shkupit dhe për rajonin e Qytetit të Shkupit.

(4) Planit hapësinor për rajonin me interes publik për Republikën përpunohet për park nacional ose kategori tjetër të rajonit të mbrojtur, akumulimit ose burimit të ujit, rajonit me eksploatim vëllimor të lëndëve të para minerale, korridoreve të infrastrukturë dhe të komunikacionit, objekteve dhe sistemeve prodhuese energjetike, sistemeve të melioracionit dhe të tjera me rëndësi për Republikën të përcaktuara me planin hapësinor.

(5) Planet nga paragrafët (2), (3), dhe (4) të këtij neni, përpunohet në pajtim me Planin hapësinor dhe përmbajnë udhëzime për dedikimin e tokës dhe shfrytëzimin e

hapësirës, vendosjen hapësinoe në vendbanime dhe zona të veprimtarisë ekonomike dhe joekonomike, infrastrukturën e komunikacionit dhe infrastrukturën tjetër, vlerësimin strategjik të ndikimit mbi mjedisin jetësor, masat e planit për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor dhe të natyrës, masat për mbrojtjen e trashëgimisë së patundshme kulturore, masat për mbrojtjen nga rrënimet nga lufta, masat për mbrojtje nga katastrofa natyrore dhe teknologjike dhe avari, parametra për zbatimin e planit dhe paraqitje përkatëse grafike, ndërsa plani i hapësirës nga paragrafi (4) i këtij neni përmban edhe kufij të tokës së parapare për ndërtim, parametra më detajore dhe shërbime për ndërtime të nevojshme për planifikimin urbanistik.

3. Planit i përgjithshëm urbanistik

Neni 10

(1) Planit i përgjithshëm urbanistik është plan urbanistik i cili miratohet për vendbanim - qytet, të përcaktuar me ligj.

(2) Planit urbanistik i përgjithshëm përmban paraqitje grafike të zgjidhjeve të planit të përfshirjes, pjesën tekstuale dhe pjesën numerike me tregues të bilancit për përfshirjen e planit edhe për infrastrukturën.

(3) Paraqitja grafike nga paragrafi (2) i këtij neni i përmban: kufirin e përfshirjes së planit i cili paraqet kufirin e qytetit, kufijtë e zonave sipas dedikimit të tokës dhe regjimit të përgjithshëm të ndërtimit dhe përdorimit, rrjetin primar të komunikacionit me zgjidhje të nivelit, infrastrukturën primare, kufijtë e rajoneve urbane për planifikim detajor të hapësirës, kufijtë e tërësive monumentale dhe të mira tjera të mbrojtura si dhe të dhëna tjera të nevojshme për zgjidhje të planit të përcaktuara në pajtim me dispozitën e nenit 15 paragrafi (2) të këtij ligji.

(4) Pjesa tekstuale nga paragrafi (2) i këtij neni i përmban: qëllimin dhe mjete të zgjidhjeve të planit, kushte të veçanta dhe të përgjithshme për zhvillimin hapësinor për zbatimin e planit, kushte të planit për planifikim të hollësishëm hapësinor, masa për mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit jetësor, masa për mbrojtjen nga rrënimet, masa minimale për mbrojtjen e trashëgimisë së patundshme kulturore nëse në përfshirjen e planit ekziston trashëgimi i patundshme kulturore si dhe të dhëna tjera të nevojshme për zgjidhjet e planit të përcaktuara në pajtim me dispozitën e nenit 15 paragrafi (2) të këtij ligji.

(5) Pjesa numerike e paragrafit (2) të këtij neni i përmban: të dhënat numerike për sipërfaqet e tokës ndërtimore, përdorimin me dedikim të tokës në kuadër të linjës rregulluese, dendësinë dhe sipërfaqen e ndërtimit të planifikuar, të dhëna për infrastrukturën si dhe të dhëna tjera të nevojshme për zgjidhjet e planit të përcaktuara në pajtim me nenin 15 paragrafi (2) të këtij ligji.

(6) Të dhëna për gjendjen ekzistuese, mundësitë për zhvillimin hapësinor dhe projeksionet programore për zhvillimin hapësinor paraqesin bazë të dokumentacionit të planit, që është shtojcë e planit.

4. Planit detal urbanistik

Neni 11

(1) Planit detalor urbanistik është plan urbanistik i cili miratohet për përfshirje të planit për të cilin është miratuar plani i përgjithshëm urbanistik.

(2) Planit detalor urbanistik i përmban paraqitjen grafike të zgjidhjeve të planit të përfshirjes, pjesën tekstuale dhe pjesën numerike me indikatorë të bilancit për përfshirjen e planit dhe për infrastrukturën.

(3) Paraqitja grafike nga paragrafi (2) i këtij neni i përmban: kufirin e përfshirjes së planit, linjat rregulluese, parcelimin e tokës ndërtimore, sipërfaqet për ndërtim të objekteve pa linja të caktuara ndërtimore, lartësinë maksimale të ndërtimit të shprehur në metra deri në majë,

dedikimin për tokën dhe ndërtimet, zgjidhjen e planit të rrjetit sekondar të rrjetit të komunikacionit me zgjidhje të nivelimit, kufirin i tërësive monumentale dhe të mirave tjera të mbrojtura si dhe të dhëna tjera të nevojshme për zgjidhjet e planit të përcaktuara në pajtim me nenin 15 paragrafi (2) të këtij ligji.

(4) Pjesa tekstuale nga paragrafi (2) i këtij neni përmban: kushte të përgjithshme për ndërtim, zhvillim dhe shfrytëzim të tokës dhe ndërtimeve, kushte të veçanta për ndërtimin e parcelave të veçanta ndërtimore, të dhëna për infrastrukturën sekondare, masa për mbrojtjen nga rrënimet, masa detalore për mbrojtjen e trashëgimisë së patundshme kulturore sipas bazave mbrojtëse konservuese nëse në përfshirjen e planit ekziston trashëgimi e patundshme kulturore, masa për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës nëse është zbatuar procedura për vlerësim strategjik për ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve si dhe të dhëna tjera të nevojshme për zgjidhjet e planit në pajtim me dispozitat e nenit 15 paragrafi (2) të këtij ligji.

(5) Pjesa numerike e paragrafit (2) të këtij neni përmban: të dhëna për sipërfaqet e parcelave ndërtimore, sipërfaqet e planifikuara për ndërtim, të dhëna për infrastrukturën si dhe të dhëna tjera të nevojshme për zgjidhjet e planit të përcaktuara në pajtim me dispozitat e nenit 15 paragrafi (2) të këtij neni.

(6) Plani detajor urbanistik si plan i nivelit më të ulët, doemos duhet të jetë i harmonizuar me planin e përgjithshëm urbanistik përkatësisht me planin rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik nëse i njëjti është miratuar.

(7) Të dhëna për gjendjen ekzistuese, mundësitë për zhvillim hapësinor dhe projeksione programore për zhvillimin hapësinor paraqesin dokumentacion bazë të planit detal urbanistik, i cili është shtojcë e planit.

5. Plani urbanistik për fshat

Neni 12

(1) Plani urbanistik për fshat është plan urbanistik i cili miratohet për rajonin e vendbanimit - fshat, të përcaktuar me ligj.

(2) Plani urbanistik për fshat përmban paraqitje grafike dhe pjesë tekstuale.

(3) Paraqitja grafike nga paragrafi (2) i këtij neni i përmban: kufirin e përfshirjes së planit i cili e paraqet kufirin e fshatit, dedikimin e tokës dhe ndërtimeve, zgjidhjen e planit të rrjetit primar dhe sekondar të komunikacionit me zgjidhje të nivelit, kufirin e tërësive monumentale dhe të mirave tjera të mbrojtura si dhe të dhëna tjera të nevojshme për zgjidhjet e planit të përcaktuara në pajtim me dispozitat e nenit 15 paragrafi (2) të këtij ligji.

(4) Në paraqitjen grafike nga paragrafi (2) i këtij neni nuk përcaktohen parcelat ndërtimore dhe sipërfaqet për ndërtim, ndërsa parcela kadastrale paraqet parcelë ndërtimore.

(5) Me përjashtim të paragrafit (4) të këtij neni, parcela ndërtimore mund të përbëhet nga dy ose më shumë parcela kadastrale ose në kuadër të një parcele kadastrale mund të formohen dy ose më shumë parcela ndërtimore ose në një parcelë kadastrale mund të parashihen sipërfaqe për ndërtim të dy ose më shumë ndërtimeve, në të cilin rast parcela ndërtimore dhe sipërfaqet për ndërtim përcaktohen me projekt urbanistik-arkitektonik nga neni 51 i këtij ligji.

(6) Pjesa tekstuale nga paragrafi (2) i këtij neni përmban: kushte të përgjithshme për ndërtim, zhvillim dhe shfrytëzim të tokës dhe ndërtimeve, të dhëna për infrastrukturën, masa detalore për mbrojtjen e trashëgimisë së patundshme kulturore sipas bazave mbrojtëse-konservuese nëse në përfshirjen e planit ekziston trashëgimi e patundshme kulturore, masa për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës nëse është zbatuar procedura

për vlerësim strategjik për ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe mbi shëndetin e njerëzve si dhe të dhëna tjera të nevojshme për zgjidhjet e planit të përcaktuar në pajtim me dispozitën e nenit 15 paragrafi (2) të këtij ligji.

(7) Të dhëna për gjendjen ekzistuese, mundësitë për zhvillim hapësinor dhe projeksionet programore për zhvillimin hapësinor paraqesin dokumentacion bazë të planit urbanistik për fshat, që është shtojcë e planit.

6. Plani urbanistik jashtë vendbanimit

Neni 13

(1) Plani urbanistik jashtë vendbanimit është plan urbanistik i cili miratohet për përfshirje të planit që nuk është i përfshirë me planin e përgjithshëm urbanistik dhe me planin urbanistik për fshat.

(2) Plani urbanistik jashtë vendbanimit përmban paraqitje grafike dhe pjesë tekstuale.

(3) Paraqitja grafike nga paragrafi (2) i këtij neni i përmban: kufirin e përfshirjes së planit, dedikimin e tokës dhe ndërtimeve, zgjidhjen e planit të rrjetit primar dhe sekondar të komunikacionit me zgjidhje të nivelit, kufirin e tërësive monumentale dhe të mirave tjera të mbrojtura si dhe të dhëna tjera të nevojshme për zgjidhjet e planit të përcaktuara në pajtim me dispozitën e nenit 15 paragrafi (2) të këtij ligji.

(4) Në paraqitjen grafike nga paragrafi (2) i këtij neni nuk përcaktohen parcelat ndërtimore dhe sipërfaqet për ndërtim, ndërsa parcela kadastrale paraqet parcelë ndërtimore.

(5) Me përjashtim të paragrafit (4) të këtij neni, parcela ndërtimore mund të përbëhet nga dy ose më shumë parcela kadastrale ose në kuadër të një parcelë kadastrale mund të formohen dy ose më shumë parcela ndërtimore ose në një parcelë kadastrale mund të parashihen sipërfaqe për ndërtimin e dy ose me shumë ndërtesave, në të cilin rast parcela ndërtimore dhe sipërfaqet për ndërtim përcaktohen me projektin urbanistik-arkitektonik nga neni 51 i këtij ligji.

(6) Pjesa tekstuale nga paragrafi (2) i këtij neni përmban: kushte të përgjithshme për ndërtim, zhvillim dhe shfrytëzim të tokës dhe ndërtimeve, të dhëna për infrastrukturën, masa detalore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore sipas bazave mbrojtëse-konservuese nëse në përfshirjen e planit ekziston trashëgimi e patundshme kulturore, masa për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës nëse është zbatuar procedura për vlerësim strategjik për ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe mbi shëndetin e njerëzve si dhe të dhëna tjera të nevojshme për zgjidhjet e planit të përcaktuara në pajtim me dispozitën e nenit 15 paragrafi (2) të këtij ligji.

(7) Të dhëna për gjendjen ekzistuese, mundësitë për zhvillim hapësinor dhe projeksionet programore për zhvillimin hapësinor paraqesin bazë dokumentacioni të planit urbanistik jashtë vendbanimit, që është shtojcë e planit.

(8) Me planin urbanistik jashtë vendbanimit nuk mund të jenë lëndë e planifikimit të ndërtimeve me dedikim A2 (banim në ndërtesa banesore) në pajtim me standardet dhe normativat për planifikim urbanistik nga neni 68 i këtij ligji.

7. Plani rregullues i planit të përgjithshëm urbanistik

Neni 14

(1) Plani rregullues i planit të përgjithshëm urbanistik është plan me të cilin mund të kryhet përpunimi i përfshirjes së planit të planit të përgjithshëm urbanistik për përcaktimin e kufijve për planifikim detal.

(2) Plani rregullues i planit të përgjithshëm urbanistik përmban pjesë tekstuale, paraqitje grafike të zgjidhjeve të planit të përfshirjes dhe pjesën numerike me indikatorë të bilancit për përfshirjen e planit edhe për infrastrukturën.

(3) Paraqitja grafike nga paragrafi (2) i këtij neni i përmban kufirin e përfshirjes së planit i cili e paraqet kufirin e kuartit të përcaktuar në planin e përgjithshëm urbanistik, kufijtë e blloqeve të cilat paraqesin kufij të rajoneve urbane për planifikim detal të hapësirës, kufijtë e zonave sipas dedikimit të tokës të përcaktuar në planin e përgjithshëm urbanistik, regjimin e përgjithshëm për ndërtim dhe përdorim, rrjetin primar dhe sekondar të komunikacionit me zgjidhje të nivelimit, infrastrukturë primare dhe sekondare si dhe të dhëna tjera të nevojshme për vendimit e planit të përcaktuara në pajtim me dispozitën e nenit 15 paragrafi (2) të këtij ligji.

(4) Pjesa tekstuale nga paragrafi (2) i këtij neni i përmban qëllimin dhe mjetet e zgjidhjeve të planit, kushteve e veçanta për zhvillim hapësinor, parametrat për zbatimin e planit, kushtet e planit për planifikim të detajuar të hapësirës si dhe të dhëna tjera të nevojshme për zgjidhjet e planit të përcaktuara në pajtim me rregullën nga neni 15 paragrafi (2) i këtij ligji.

(5) Pjesa numerike nga paragrafi (2) i këtij neni, përmban të dhëna numerike për sipërfaqet të tokës ndërtimore, përdorimin me dedikim të tokës në kuadër të linjës rregulluese, dendësinë dhe sipërfaqen e ndërtimit të planifikuar, të dhëna për infrastrukturën si tokës si dhe të dhëna tjera të nevojshme për zgjidhjet e planit të përcaktuara në pajtim me rregullën nga neni 15 paragrafi (2) i këtij ligji.

(6) Planit rregullues i planit të përgjithshëm urbanistik si plan i nivelit më të ulët, doemos duhet të harmonizohet me planin e përgjithshëm urbanistik.

(7) Të dhënat për gjendjen ekzistuese, mundësitë për zhvillim hapësinor dhe projektsonet programore për zhvillimin hapësinor, paraqesin bazë të dokumentacionit të planit rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik, që është shtojcë e planit.

8. Përmbajtja më e përafërt, pëpjesëtimi, forma dhe mënyra e përpunimit

Neni 15

(1) Përmbajtjen më e përafërt, pëpjesëtimin dhe mënyrën e përpunimit grafik të planit hapësinor, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e planifikimit hapësinor.

(2) Përmbajtjen më të përafërt, formën dhe mënyrën e përpunimit të planit të përgjithshëm urbanistik, planit detal urbanistik, planit urbanistik për fshat, planit urbanistik jashtë vendbanimit, dhe planit rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e rregullimit hapësinor.

III. LICENCAT DHE AUTORIZIMET PËR PËRPUNIMIN DHE REVIZIONIN E PLANEVE URBANISTIKE

1. Dhënia e licencave dhe autorizimeve

Neni 16

(1) Përpilimin e planeve urbanistike, dokumentacioneve të planit urbanistik, dokumentacioneve të projektit urbanistik dhe planit rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik mund ta kryejnë persona juridikë që posedojnë licenca për përpilimin e planeve urbanistike.

(2) Licenca për përpilimin e planeve urbanistike e lëshon organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e rregullimit hapësinor, pas kërkesës së parashtruar nga personi juridik me të cilën dorëzohet:

- dëshmi se personi juridik është i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë adekuate dhe

- dëshmi se personi juridik ka të punësuar në marrëdhënie të rregullt pune së paku tre inxhinierë-arkitektë të diplomuar, prej të cilëve dy kanë autorizim për përpilimin e planeve urbanistike.

(3) Bartës i përpilimit të planeve urbanistike, përkatësisht planer - nënshkrues i dokumentacionit të planit të presoni juridik nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të jetë inxhinier-arkitekt i diplomuar që posedon autorizim për përpilimin e planeve urbanistike.

(4) Autorizim për përpilimin e planeve urbanistike lëshon Oda e arkitektëve të autorizuar dhe inxhinierëve të autorizuar (në tekstin e mëtejshëm: Oda), pas kërkesës së parashtruar nga personi fizik me të cilën dorëzohet:

- dëshmi për arsimin e lartë të kryer të drejtimin përkatës (diplomë ose certifikatë për arsim të lartë të kryer, me ç'rast nëse kërkuesi ka kryer arsimin e lartë sipas sistemit evropian të transferimit të kredive (SETK) duhet të ketë marrë 300 kredi);

- dëshmi për përvojë pune prej së paku tre vitesh nga sfera e planifikimit urbanistik dhe

- tri referenca nga sfera e planifikimit urbanistik.

(5) Revizion profesional të planeve urbanistike, dokumentacioneve të planit urbanistik dhe projekteve të infrastrukturës mund të kryjnë persona juridikë që posedojnë licencë për revizion të planeve urbanistike.

(6) Licencë për revizionin e planeve urbanistike lëshon organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e rregullimit hapësinor, pas kërkesës së parashtruar nga personi juridik me të cilën dorëzohet:

- dëshmi se personi juridik është i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë adekuate dhe

- dëshmi se personi juridik ka të punësuar në marrëdhënie të rregullt pune së paku pesë inxhinierë-arkitektë të diplomuar, prej të cilëve katër kanë autorizim për revizion të planeve urbanistike.

(7) Bartës i përpilimit të revizionit profesional, përkatësisht revidues-nënshkrues i raportit për revizion profesional në presonin juridik nga paragrafi (5) i këtij neni, mund të jetë inxhinier-arkitekt i diplomuar që posedon autorizim për revizionin e planeve urbanistike.

(8) Autorizim për revizion të planeve urbanistike lëshon Oda, pas kërkesës paraprake nga personi fizik me të cilën parashtron:

- dëshmi për arsim të lartë të kryer nga dega përkatëse (diplomë ose certifikatë për arsim të lartë të kryer, me ç'rast nëse kërkuesi ka kryer arsim të lartë sipas sistemit evropian të transferit të kredive (SEKT) duhet të ketë marrë 300 kredi);

- dëshmi për përvojë pune prej së paku pesë vjet në sferën e planifikimit urbanistik dhe

- pesë referenca nga sfera e planifikimit urbanistik.

(9) Me përjashtim nga paragrafi (4) dhe paragrafi (8) të këtij neni, autorizim për përpilim të planeve urbanistike dhe autorizim për revizion të planeve urbanistike mund të marrë edhe personi i cili ka pesë vjet përvojë pune në miratimin dhe zbatimin e planeve urbanistike dhe persona me titull shkencor nga sfera e planifikimit urbanistik që kanë dy referenca nga sfera e planifikimit urbanistik, persona të cilët i njohin dispozitat për planifikim urbanistik.

(10) Organi kompetent është i obliguar në afat prej 10 ditësh pune të veprojë për kërkesën për marrjen e licencës dhe autorizimit përkatësisht të lëshojë licencë dhe autorizime ose të marrë vendim për refuzimin e kërkesës. Kundër aktvendimit për refuzimin e kërkesës për lëshimin e licencës përkatësisht autorizimit mund të paraqitet ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedura të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, në afat prej tetë ditësh nga pranimi i aktvendimit.

(11) Licencat nga paragrafi (1) dhe paragrafi (5) të këtij neni lëshohen në periudhë prej shtatë vitesh, kurse autorizimet nga paragrafi (3) dhe paragrafi (7) të këtij neni lëshohen për periudhë prej pesë vitesh.

(12) Për marrjen e licencës përkatësisht autorizimit personat juridikë përkatësisht personat fizikë paguajnë kompensim përkatës. Lartësia e kompensimit për marrjen e licencës që nuk mund të jetë më e lartë se 1 000 euro në kundërvlerë me denarë, si dhe për marrjen e autorizimit që nuk mund të jetë më e lartë se 100 euro në kundërvlerë me denarë, përcaktohet me dispozitën nga neni 18 paragrafi (14) të këtij ligji. Mjetet e realizuar nga kompensimi për marrjen e licencës janë të hyra të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, kurse mjetet e realizuara nga kompensimi për marrjen e autorizimeve janë të hyra të Odës.

(13) Licenca dhe autorizimi para kalimit të afatit për të cilën janë lëshuar mund të përtërihen nëse personi juridik përkatësisht fizik i plotëson kushtet për lëshimin e licencës përkatësisht autorizimit të përcaktuara me këtë ligj. Për përtërirjen e licencës dhe autorizimit parashtrohet kërkesë në organin kompetent që i ka lëshuar, më së voni 15 ditë para kalimit të afatit të vlefshmërisë së të njëjtave, me ç'rast për përtërirjen nuk paguhet kompensim.

(14) Personat juridikë që posedojnë licencë për përpunimin e planeve urbanistike dhe licencë për revizion të planeve urbanistike, gjatë përpunimit dhe revizionit profesional të planeve urbanistike, dokumentacioneve të planit urbanistik, dokumentacioneve të projektit urbanistik si dhe gjatë përpunimit të planit rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik, për shërbime të kryera arkëtojnë në pajtim me Listën e çmimeve të cilin e miraton Oda, me pajtim paraprak të Qeverisë Republikës së Maqedonisë dhe i njëjti publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(15) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafët (2), (4), (6), (8) dhe (13) të këtij neni dhe dokumentacionin e nevojshëm i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor.

Neni 17

(1) Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor, përkatësisht Oda nuk lëshon licencë, përkatësisht autorizimit ose nuk ka marrë aktvendim për refuzim të kërkesës për dhënie të lejes, përkatësisht autorizimit në afatin nga neni 16 paragrafi (10) të këtij ligji, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri ditësh pune të parashtojë kërkesë në sekretarinë e ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor, përkatësisht në sekretarinë e kryetarit të Odës, që ministrin, përkatësisht kryetari të lëshojnë licencë, përkatësisht autorizim.

(2) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (1) të këtij neni i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor.

(3) Me kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni kërkuasi dorëzon edhe kopje të kërkesës nga neni 16 paragrafi (2), paragrafi (4), paragrafi (6) dhe paragrafi (8) të këtij ligji.

(4) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor, përkatësisht kryetari i Odës, është i detyruar që në afat prej pesë ditësh pune nga dita e parashtrimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni në sekretarinë e ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor, përkatësisht në sekretarinë e kryetarit të Odës, të lëshojë licencë, përkatësisht autorizim ose të marrë aktvendim me të cilin refuzohet kërkesa për lëshim të licencës, përkatësisht autorizimit. Nëse ministri, përkatësisht kryetari i Odës nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së organit kompetent.

(5) Nëse ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, përkatësisht kryetari i Odës nuk lëshon licencë përkatësisht autorizim, ose nuk merr aktvendim me të cilin refuzohet kërkesa për lëshim të licencës, përkatësisht autorizimit në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mundet ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditësh pune.

(6) Inspektorati Shtetëror Administrativ është i detyruar që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor, përkatësisht në Odë, nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditësh pune nga dita e mbikëqyrjes së kryer ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(7) Inspektori nga Inspektorati Shtetëror Administrativ pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin merr aktvendim me të cilin e obligon ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor, përkatësisht kryetarin e Odës, që në afat prej dhjetë ditësh të vendosë për kërkesën e parashtruar, përkatësisht ta miratojë ose refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. (8) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, përkatësisht kryetari i Odës nuk vendos në afatin nga paragrafi (7) të këtij neni, inspektori do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të paraparë me Ligjin për inspeksion administrativ dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditësh pune, në të cilin ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, përkatësisht kryetari i Odës, do të vendosë për kërkesën e parashtruar me çfarë në të njëjtin afat do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri ditësh pune do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(9) Nëse ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, përkatësisht kryetari i Odës nuk vendos edhe në afatin plotësues nga paragrafi (8) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditësh pune do të parashtojë fletëparaqitje te prokurori publik kompetent dhe në këtë afat do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(10) Nëse inspektori nuk vepron pas njoftimit nga paragrafi (5) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditësh pune ka të drejtë të parashtojë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kundërshtimi parashtrohet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(11) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ është i detyruar që në afat prej tri ditësh pune ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (10) i këtij neni dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar pas njoftimit nga parashtruesi i kërkesës nga paragrafi (5) i këtij neni dhe/ose nuk ka paraqitur fletëparaqitje në pajtim me paragrafin (9) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtjen e paraparë me Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditësh pune në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin kompetent nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditësh pune nga dita e mbikëqyrjes së kryer ta informojë paraqitësin e kërkesës për masat e marra.

(12) Nëse inspektorin nuk vepron edhe në afatin plotësues nga paragrafi (11) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqes fletëparaqitje te prokurori kompetent publik kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditësh pune do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(13) Në rastin nga paragrafi (12) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ menjëherë, e më së voni në afat prej një ditë pune do të autorizojë inspektor tjetër që ta zbatojë mbikëqyrjen menjëherë.

(14) Në rastet nga paragrafi (13) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditësh pune ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e marra.

(15) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin (11) të këtij neni, qytetari mund të paraqesë fletëparaqitje te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditësh pune.

(16) Nëse ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, përkatësisht kryetari i Odës nuk vendos në afatin nga paragrafi (8) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngritë kontest administrativ para Gjykatës Administrative.

(17) Procedura para Gjykatës Administrative është urgjente.

(18) Pas shpalljes së aktit nënligjor nga paragrafi (2) i këtij nenin në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" të njëjtat menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh shpallen në ueb faqen e organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor.

2. Heqja e licencave dhe autorizimeve

Neni 18

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor do ta heqë licencën për përpunimin e planeve urbanistike para skadimit të afatit ose nuk do ta përtërijë lejen para skadimit të afatit nëse:

- personi juridik ka pushuar f'i plotësojë kushtet për marrjen e licencës të përcaktuara me këtë ligj;

- personi juridik ka përpunuar plan urbanistik për të cilin organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera për rregullimin e hapësirës, ka dorëzuar njoftim për mangësi të konstatuara të planit urbanistik, në pajtim me nenin 38 paragrafi (2) të këtij ligji;

- personi juridik ka përpunuar plan të detajuar urbanistik në të cilin nuk janë respektuar dedikimet e hapësirës të përcaktuara në planin e përgjithshëm urbanistik;

- personi juridik ka përpiluar revizion profesional të planit urbanistik në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore;

- personi juridik ka përpunuar dokumentacion të planit urbanistik në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore;

- personi juridik ka përpunuar projekt urbanistik - arkitektonik në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore;

- personi juridik ka përpunuar projekt për infrastrukturë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore dhe

- personi juridik ka përpunuar revizion profesional të dokumentacionit të planit urbanistik dhe projekt për infrastrukturë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore.

(2) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimi të hapësirës do ta heqë licencën për revizion të planeve urbanistike para skadimit të afatit ose nuk do ta përtërijë licencën para skadimit të afatit nëse:

- personi juridik pushon së ekzistuari;

- personi juridik pushon t'i plotësojë kushtet për marrjen e licencës të përcaktuara me këtë ligj;

- personi juridik ka përpunuar revizion profesional të planit urbanistik në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore dhe

- personi juridik ka përpunuar revizion profesional të dokumentacionit të planit urbanistik dhe projektit për infrastrukturë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore.

(3) Në rastet nga paragrafi (1) alinetë 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni si dhe në rastet nga paragrafi (2) alinetë 1, 2 dhe 3 të këtij neni, licenca hiqet me detyrë zyrtare, kurse në rastet nga paragrafi (1) alinetë 6, 7, 8 dhe 9 të këtij neni si dhe në rastet nga paragrafi (2) alineja 4 të këtij neni në bazë të propozimit të Inspektoratit Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm. Licenca hiqet me aktvendim të ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e rregullimit të hapësirës, nga dita kur aktvendimi për heqjen e licencës bëhet i plotfuqishëm.

(4) Pas miratimit të aktvendimit nga paragrafi (4) të këtij ligji, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, është i detyruar që në Odë të paraqesë propozim për heqjen e autorizimit për përpunimin e planeve urbanistike personit fizik i cili është nënshkrues - planifikues i planit urbanistik për të cilin organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor, ka dorëzuar njoftim për mangësitë e konstatuara të planit urbanistik, të personit fizik i cili është nënshkrues - planifikues i planit të detajuar urbanistik në të cilin nuk janë respektuar dedikimet e hapësirës të përcaktuara me planin e përgjithshëm urbanistik si dhe të personit fizik i cili është nënshkrues i raportit pozitiv për revizion profesional të planit urbanistik të përpunuar në kundërshtim të dispozitave ligjore dhe nënligjore.

(5) Oda do ta heqë autorizimin për përpunimin e planeve urbanistike nëse: -personi fizik është nënshkrues - planifikues i planit urbanistik për të cilin organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera për rregullimin e hapësirës, ka dorëzuar njoftim për mangësitë e konstatuara të planit urbanistik, në pajtim me nenin 38 paragrafi (2) të këtij ligji;

- personi fizik është nënshkrues - planifikues i planit të detajuar urbanistik në të cilin nuk janë respektuar dedikimet e hapësirës të përcaktuara në planin e përgjithshëm urbanistik;

- personi fizik është nënshkrues - planifikues i dokumentacionit të planit urbanistik, i cili është i përpunuar në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore;

- personi fizik është nënshkrues - planifikues i projektit arkitektonik - urbanistik, i cili është përpunuar në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore;

- personi fizik është nënshkrues - planifikues i projektit për infrastrukturë, i cili është përpunuar në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore;

- personi fizik është nënshkrues i raportit pozitiv për revizion profesional të planit urbanistik, i cili është përpunuar në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore dhe

- personi fizik është nënshkrues i raportit pozitiv për revizion profesional të dokumentacionit të planit urbanistik dhe projektit për infrastrukturë, të cilët janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore.

(6) Oda do ta heqë autorizimin për revizion të planeve urbanistike nëse:

- personi fizik është nënshkrues - revidues i raportit pozitiv për revizion profesional të planit urbanistik, i cili është përpunuar në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore dhe

- personi fizik është nënshkrues i raportit pozitiv për revizion profesional të dokumentacionit të planit urbanistik dhe projektit për infrastrukturë, të cilët janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore.

(7) Në rastet nga paragrafi (5) alinetë 1, 2 dhe 6 të këtij neni si dhe në rastet nga paragrafi (6) alineja 1 e këtij neni, autorizimi hiqet në bazë të propozimit të organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, kurse në rastet nga paragrafi (5) alinetë 3, 4, 5 dhe 7 të këtij neni si dhe në rastet nga paragrafi (6) alineja 2 e këtij neni, në bazë të propozimit të Inspektoratit Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm. Autorizimi hiqet me aktvendim të kryetarit të Odës, nga dita kur aktvendimi për heqjen e autorizimit është bërë i plotfuqishëm.

(8) Kundër aktvendimit nga paragrafët (3) dhe (7) të këtij neni mund të parashtrohet ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

(9) Personi juridik licenca e të cilit është hequr për shkak të parregullsive nga paragrafi (1) alineja 2 të këtij neni dhe parregullsitë nga paragrafi (2) alineja 2 të këtij neni, nuk mund të marr licencë të paraparë me këtë ligj, në afat prej një viti nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për heqjen e lejes, kurse personi juridik licenca e të cilit është hequr për shkak të parregullsive nga paragrafi (1) alinetë 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 të këtij neni dhe parregullsitë nga paragrafi (2) alinetë 3 dhe 4 të këtij neni, në afat prej tre vitesh nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për heqjen e lejes. Personi juridik licenca e të cilit është hequr detyrohet që ta kthejë të njëjtën në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, në afat prej tetë ditësh nga plotfuqishmëria e aktvendimit të heqjes së lejes.

(10) Personi përgjegjës në personin juridik leja e të cilit është hequr për shkak të parregullsive nga paragrafi (1) alineja 2 të këtij neni dhe parregullsitë nga paragrafi (2) alineja 2 të këtij neni, nuk mund të themeloj person tjetër juridik për përpunim dhe kryerje të revizionit profesional të planeve urbanistike, dokumentacioneve të planit urbanistik dhe dokumentacioneve të projektit urbanistik, në afat prej një viti nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për heqjen e lejes, kurse personi përgjegjës në personin juridik të cilit i është hequr leja për shkak të parregullsive nga paragrafi (1) alinetë 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 të këtij neni dhe parregullsitë nga paragrafi (2) alinetë 3 dhe 4 të këtij neni, nuk mund të themeloj person tjetër juridik për përpunim dhe kryerje të revizionit profesional të planeve urbanistike, dokumentacioneve të planit urbanistik dhe dokumentacioneve të projektit urbanistik, në afat prej tre vitesh nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për heqjen e lejes.

(11) Bartësi i autorizimit, të cilit i është hequr autorizimi për shkak të parregullsive nga paragrafi (5) dhe paragrafi (6) të këtij neni nuk mund të marrë autorizim të ri të paraparë me këtë ligj, në periudhë prej pesë vitesh nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për heqje të autorizimit. Personi fizik autorizimi i të cilit i është hequr detyrohet që t'ia kthejë të njëjtën Odës, në afat prej tetë ditësh nga plotfuqishmëria e aktvendimit të heqjes së autorizimit.

(12) Aktvendimi i plotfuqishëm për heqje të licencës evidentohet në Regjistrin e licencave të dhëna dhe licencave të hequra dhe i njëjti shpallet në ueb faqen e organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve të rregullimit hapësiror. Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e rregullimit hapësiror, aktvendimin e plotfuqishëm për heqjen e licencës e dorëzon për Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë për shkak të evidentimit të nalimit nga paragrafi (10) i këtij neni.

(13) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës mban regjistër elektronik për licencat e dhëna dhe të hequra, kurse Oda mban regjistër elektronik për autorizimet e dhëna dhe të hequra.

(14) Mënyrën e dhënies, përtëritjes dhe heqjes së licencave dhe autorizimeve, formën dhe përmbajtjen e formularit të licencave dhe autorizimeve, lartësinë e kompensimit për dhënie të licencave dhe autorizimeve, si dhe formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve të rregullimit hapësiror.

3. Përpilimi i planeve urbanistike dhe dokumentacionit të planit urbanistik nga personi i huaj juridik

Neni 19

(1) Përpunim të planeve urbanistike dhe dokumentacionit të planit urbanistik mund të kryejë edhe person i huja juridik.

(2) Personi i huaj juridik mundet në Republikën e Maqedonisë të përpunojë plane urbanistike dhe dokumentacion të planit urbanistik nëse merr vërtetim për përpunimin e të njëjtave nga organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(3) Për marrjen e vërtetimit personi juridik nga shteti i cili është anëtar i Bashkimit Evropian duhet të dorëzojë kërkesë me shkrim dhe dëshmi me të cilat vërtetohet se personi është i regjistruar për kryerje e veprimtarisë përkatëse në vendin në të cilin ka seli përkatësisht se ka licencë përkatësisht për përpunimin e planeve urbanistike përkatësisht dokumentacionin të planit urbanistik, kurse personi juridik nga shteti i cili nuk është anëtar i Bashkimit Evropian, krahas dëshmive të përmendura duhet të dorëzojë edhe listë për plane të përpunuara urbanistike, përkatësisht dokumentacione të planit urbanistik.

(4) Nëse në shtetin në të cilin ka seli personi i huaj juridik nuk lëshohet leje, përkatësisht licencë, personi i huaj juridik nga shteti anëtar i Bashkimit Evropian është i detyruar që me kërkesën të dorëzojë dëshmi nga organi kompetent në atë shtet se në pajtim me dispozitat e saja për përpunimin e planeve urbanistike, përkatësisht dokumentacionit të planit urbanistik nuk lëshohet leje, përkatësisht licencë.

(5) Në bazë të dëshmive të dorëzuara organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e rregullimit të hapësirës, është i detyruar që në afat prej 10 ditësh pune të lëshojë vërtetim në të cilin do të përcaktojë se cili lloj i planeve urbanistike, përkatësisht dokumentacionit të planit urbanistik, në pajtim me këtë ligj, personi i huaj juridik mund t'i përpunojë në Republikën e Maqedonisë ose të miratojë aktvendim për refuzimin e kërkesës për dhënie e vërtetimit.

(6) Kundër aktvendimit nga paragrafi (5) i këtij neni mund të paraqitet ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, në afat prej tetë ditësh nga pranimi i aktvendimit.

(7) Vërtetimi jepet me afat të vlefshmërisë prej tri vitesh, kurse në rastet kur në licencë, përkatësisht lejen e dhënë nga shteti në të cilin personi i huaj juridik ka seli është përcaktuar afati i vlefshmërisë, afati i vlefshmërisë i vërtetimit është identik me afatin e vlefshmërisë në licencë, përkatësisht lejes.

(8) Formën dhe përmbajtjen e vërtetimit nga paragrafi (2) i këtij neni i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësiror.

IV. PROGRAME PËR PËRPILIMIN E PLANEVE URBANISTIKE

1. Programi vjetor i komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit

Neni 20

(1) Për përpilimin e planeve urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji, dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacionit të projektit urbanistik, komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit detyrimisht miratojnë program vjetor, më së voni deri më 31 janar për vitin rrjedhës.

(2) Përpilimi i planeve urbanistike, dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacionit të projektit urbanistik nga programi nga paragrafi (1) i këtij neni, financohet nga Buxheti i komunës, Buxheti i komunës në Qytetin e Shkupit, Buxheti i Qytetit të Shkupit si dhe nga persona të interesuar fizikë dhe juridikë, kërkesat programore të të cilave dhe zona e interesit janë të pranueshme për komunën, komunën në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit.

(3) Programin nga paragrafi (1) i këtij neni, komunat, komunat në Qytetin e Shkupit, dhe Qyteti i Shkupit detyrimisht e publikojnë në fletoren zyrtare të komunës, komunës në Qytetin e Shkupit përkatësisht Qytetin e Shkupit, kurse në formë elektronike edhe në sistemin informativ e-urbanizëm.

2. Thirrje publike për dorëzimin e iniciativave për përpilimin e planeve urbanistike

Neni 21

(1) Komunat me seli në qytet dhe komunat në Qytetin e Shkupit janë të detyruara çdo vit të shpallin dy thirrje publike, një në tremujorin e parë të vitit dhe një në tremujorin e tretë të vitit, kurse komunat me seli në fshat janë të detyruara çdo vit të shpallin një thirrje publike në tremujorin e parë të vitit, për dorëzimin e iniciativave për përpilim të planeve urbanistike nga personat e interesuar fizikë dhe juridikë.

(2) Thirrjet publike nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të zgjasin së paku 30 ditë, kurse shpallen në fletoren zyrtare të komunës përkatësisht komunës në Qytetin e Shkupit, në ueb faqen e komunës përkatësisht komunës në Qytetin e Shkupit, në tabelën e shpalljeve në komunë përkatësisht komunën në Qytetin e Shkupit, në sistemin informativ e-urbanizëm, në gazetë ditore e cila botohet në gjuhën maqedonase, kurse del së paku tre muaj para ditës së shpalljes së thirrjes, kurse në komunat përkatësisht komunat në Qytetin e Shkupit në të cilat së paku 20% nga qytetarët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase dhe në një gazetë ditore e cila botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarët të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, kurse del së paku tre muaj para ditës së shpalljes së thirrjes. Thirrja publike në medien e shtypur duhet të përfshijë së paku një pjesë të një faqeje.

(3) Secili person i interesuar juridik dhe fizik gjatë thirrjes publike mund të dorëzojë iniciativë për përpilim dhe miratim të planeve urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 alinetë 2, 3 dhe 4 të këtij ligji, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose në formë të shkruar. Lëndë e iniciativës mund të jetë miratimi i planit të ri urbanistik ose ndryshimi dhe plotësimi i planit ekzistues urbanistik.

(4) Komisioni për urbanizëm nga neni 23 paragrafi (1) i këtij neni, është i detyruar që në afat prej 15 ditësh pune nga skadimi i afatit për dorëzimin e iniciativave, të vendosë për secilën iniciativë të paraqitur përkatësisht ta pranojë ose refuzojë të njëjtën, ta njoftojë parashtruesin e iniciativës për praninë përkatësisht mospraninë të së njëjtës

me arsyetim, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose në formë të shkruar, kurse për iniciativën e pranuar të paraqesë kërkesë të Këshilli i komunës përkatësisht Këshilli i komunës së Qytetit të Shkupit për parashikimin e përpilimit të planit urbanistik në programin vjetor nga neni 20 paragrafi (1) i këtij ligji.

(5) Nëse iniciativa e paraqitur për përpilimin e planit urbanistik është pranuar, kryetari i Këshillit është i detyruar që propozimin për përpilim të planit urbanistik ta vendosë në mbledhjen e parë të ardhshme të Këshillit, kurse Këshilli është i detyruar në mbledhjen e njëjtë, ta parasheh përpilimin e planit urbanistik në programin vjetor nga neni 20 paragrafi (1) të këtij ligji. Komuna përkatësisht komuna në Qytetin e Shkupit është e detyruar më së voni në afat prej 30 ditësh pune nga hyrja në fuqi e programit me të cilin është paraqitur përpilimi i planit urbanistik ta fillojë procedurën për miratimin e tij.

(6) Me përjashtim nga paragrafi (4) i këtij neni, komisioni për urbanizëm nga neni 23 paragrafi (1) i këtij ligji është i detyruar që ta pranojë secilën iniciativë për përpilimin e planit urbanistik me të cilën lëndë e planifikimit janë ndërtesa me dedikim G (prodhim, distribuim dhe servise) dhe ndërtesa me dedikim B (dedikime komerciale dhe dedikime afariste), në pajtim me standardet dhe normativat për planifikim urbanistik nga neni 68 të këtij ligji, përpilimi i të cilit është financuar nga ana e parashtruesit të iniciativës dhe nëse janë plotësuar standardet dhe normativat për planifikim urbanistik të përcaktuara në nenin 68 të këtij ligji.

(7) Në rastet nga paragrafi (6) i këtij neni, komisioni për urbanizëm nga neni 23 paragrafi (1) i këtij ligji është i detyruar që në afat prej pesë ditësh pune nga skadimi i afatit për dorëzimin e iniciativës të dorëzojë kërkesë të Këshilli i komunës përkatësisht Këshilli i komunës së Qytetit të Shkupit për parashikimin e përpilimit të planit urbanistik në programin vjetor nga neni 20 paragrafi (1) i këtij ligji. Kryetari i Këshillit është i detyruar që propozimin për përpilim të planit urbanistik ta vendosë në mbledhjen e parë të ardhshme të Këshillit, kurse këshilli është i detyruar në mbledhjen e njëjtë, ta parasheh përpilimin e planit urbanistik në programin vjetor nga neni 20 paragrafi (1) i këtij ligji. Komuna përkatësisht komuna në Qytetin e Shkupit është e detyruar më së voni në afat prej 15 ditësh pune nga hyrja në fuqi e programit me të cilin është paraqitur përpilimi i planit urbanistik ta fillojë procedurën për miratimin e tij, kurse planin urbanistik ta miratojë në afat jo më të gjatë se gjashtë muaj.

(8) Në rastet nga paragrafi (6) i këtij neni komuna përkatësisht komuna në Qytetin e Shkupit është e detyruar të lidhë marrëveshje me parashtruesin e iniciativës në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e komunës përkatësisht komunës në Qytetin e Shkupit dhe parashtruesit të iniciativës në lidhje me afatet për miratimin e planit urbanistik dhe realizimin e projektit.

(9) Secili person i interesuar juridik dhe fizik mund të komisioni për urbanizëm nga neni 23 paragrafi (1) të këtij ligji, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose në formë të shkruar të dorëzojë iniciativë për përpilim dhe miratim të planeve urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 alinetë 2, 3 dhe 4 të këtij ligji edhe në periudhën kur nuk është shpallur thirrje publike, rast në të cilin zbatohen dispozitat nga paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni.

(10) Formën dhe përmbajtjen e iniciativës për përpilim të planit urbanistik i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera për rregullim të hapësirës.

(11) Elementet të cilat posaçërisht i përmban marrëveshja nga paragrafi (8) të këtij neni i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera për rregullim të hapësirës.

3. Programi vjetor për financim të përpilimit të planeve urbanistike dhe dokumentacioneve të planit urbanistik i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë

Neni 22

(1) Për përpilimin e planit nga neni 7 paragrafi (1) pika 1 e këtij ligji, Qeveria e Republikës së Maqedonisë miraton program vjetor për financimin e përpilimit të Planit hapësinor, me propozim të organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e planifikimit hapësinor.

(2) Për shkak të stimulimit dhe përshejtimit të procesit të rregullimit të hapësirës, Qeveria e Republikës së Maqedonisë miraton program vjetor për financim të përpilimit të planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacionit të projektit urbanistik, me propozim të organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(3) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës çdo vit shpall thirrje publike për parashtrimin e propozimeve për përpilim të planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacioneve të planit urbanistik dhe dokumentacioneve të projekteve urbanistike, nga ana e komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit.

(4) Thirrja publike nga paragrafi (3) i këtij neni duhet të zgjat së paku 30 ditë, kurse shpallet në sistemin informativ e-urbanizëm, në ueb faqen e organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, në një gazetë ditore që botohet në gjuhën maqedonase, kurse publikohet së paku tre muaj para ditës së publikimit të thirrjes dhe në një gazetë ditore që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, kurse publikohet së paku tre muaj para ditës së shpalljes së thirrjes. Thirrja publike në medien e shtypit duhet të përfshijë së paku një gjysmë të një faqeje.

(5) Komunitat, komunitat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit gjatë thirrjes publike mund të parashtrajnë propozime të organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e rregullimit të hapësirës, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose në formë të shkruar, për përpilimin e planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacionit të projektit urbanistik në pajtim me programin nga paragrafi (2) i këtij neni.

(6) Propozimet që nuk janë parashtruar gjatë thirrjes publike nga paragrafi (3) i këtij neni nuk do të jenë lëndë e shqyrtimit.

(7) Përpilimi i planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacionit të projektit urbanistik, të përcaktuara në programin nga paragrafi (2) i këtij neni, bëhet nga Agjencia për Planifikim të Hapësirës.

(8) Përpilimi i planit hapësinor, planet urbanistike, planet e rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacionit të projektit urbanistik, të përcaktuara në programet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

(9) Me përjashtim të paragrafit (8) të këtij neni, përpilimi i planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacioneve të planit urbanistik dhe dokumentacionit të projektit urbanistik mund të financohet edhe nga Buxheti i komunës, komunës në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, si dhe nga personat e interesuar juridikë dhe fizikë.

(10) Programet nga paragrafët (1) dhe (2) publikohen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" kurse në formë elektronike dhe në sistemin informativ e-urbanizëm.

V. TRUPA PROFESIONALE

1. Komisioni për Urbanizëm

Neni 23

(1) Kryetari i komunës përkatësisht kryetari i komunës në Qytetin e Shkupit, formojnë komision për urbanizëm të komunës. Komisioni për urbanizëm i komunave me seli në qytet dhe komisioni për urbanizëm i komunave në Qytetin e Shkupit përbëhet prej pesë anëtarëve prej të cilëve tre janë bartës të autorizimit për përpilim të planeve urbanistike kurse dy janë persona profesionalë nga sfera e planifikimit urbanistik, me ç'rast së paku dy anëtarë duhet të mos jenë persona të punësuar në administratën e komunës. Komisioni për urbanizëm i komunave me seli në fshat përbëhet prej tre anëtarëve prej të cilëve dy janë bartës të autorizimit për përpilim të planeve urbanistike kurse një është person profesional nga sfera e planifikimit urbanistik, me ç'rast së paku një anëtar duhet të mos jetë person i punësuar në administratën e komunës. Komisionet për urbanizëm veprojnë për iniciativat e parashtruara në pajtim me nenin 20 të këtij ligji, e përpilojnë programin e planit për planet urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 e këtij ligji, planin e rregullimit të planit të përgjithshëm urbanistik dhe dokumentacionin e planit urbanistik lokal për nevojat e komunës, parashtrajnë propozim për miratim ose mospranim të programit të planit për dokumentacionin e planit urbanistik lokal për nevojat e personave juridikë dhe fizikë, japin mendim profesional për draft-planin e përgjithshëm urbanistik përkatësisht të propozimit të planeve urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika alinetë 2, 3 dhe 4 të këtij ligji, japin mendim profesional për propozim-planin e rregullimit të planit të përgjithshëm urbanistik, realizojnë prezantim publik dhe anketë publike gjatë miratimit të dokumentacionit të planit urbanistik lokal, parashtrajnë propozim të kryetari i komunës përkatësisht komuna e Qytetit të Shkupit për miratim të dokumentacionit të planit urbanistik lokal dhe japin mendim për korrigjim teknik të planit urbanistik.

(2) Kryetari i Qytetit të Shkupit formon komision për urbanizëm të Qytetit të Shkupit të përbërë prej së paku pesë anëtarëve prej të cilëve tre janë bartës të autorizimit për përpilimin e planeve urbanistike kurse dy janë persona profesionalë nga sfera e planifikimit urbanistik, me ç'rast së paku dy anëtarë duhet të mos jenë persona të punësuar në administratën e Qytetit të Shkupit. Komisioni për urbanizëm jep mendim për draft-planin e përgjithshëm urbanistik të Qytetit të Shkupit dhe për propozim të planeve detajore urbanistike të komunave në Qytetin e Shkupit përkatësisht propozim të planit të rregullimit të planit të përgjithshëm urbanistik të Qytetit të Shkupit, e përpilon programin e planit për planin e rregullimit të planit të përgjithshëm urbanistik të Qytetit të Shkupit, përpunon programin e planit për planin e rregullimit të planit të përgjithshëm urbanistik të Qytetit të Shkupit.

(3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, formon komision për urbanizëm të organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, të përbërë prej pesë anëtarëve prej të cilëve tre janë bartës të autorizimit për përpilim të planeve urbanistike kurse dy janë persona profesionalë nga sfera e planifikimit urbanistik, me ç'rast së paku dy anëtarë duhet të mos jenë persona të punësuar në administratën e organit. Komisioni për urbanizëm e përpilon programin e planit për planet urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 dhe për dokumentacionin e planit urbanistik të nenit 7 paragrafi (2) të këtij ligji përpilimi i të

cilit është paraparë me programin vjetor për financim të përpilimit të planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike dhe dokumentacionit të projektit urbanistik nga neni 22 paragrafi (2) i këtij ligji, parashtron propozim për miratim ose refuzim të programit të planit për dokumentacionin e planit shtetëror urbanistik, dokumentacionin e planit urbanistik për autokamp dhe dokumentacionin e planit urbanistik për objekte të interesit të veçantë të cilat janë për nevojat e personave juridikë dhe fizikë, parashtron propozim për miratim të dokumentacionit të planit shtetëror urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik për zonë zhvillimore turistike, dokumentacionit të planit urbanistik për autokamp dhe dokumentacionit të planit urbanistik për objekte të interesit të veçantë, zbaton anketë publike dhe prezantim publik gjatë miratimit të dokumentacionit të planit shtetëror urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik për zonë zhvillimore turistike dhe dokumentacionit të planit urbanistik për autokamp.

(4) Anëtarëve të jashtëm të komisioneve nga paragrafi (1), (2) dhe (3) të këtij neni u takon kompensim për pjesëmarrje në punën e komisionit, që sigurohet nga buxheti i organit që e ka formuar komisionin për urbanizëm.

(5) Lartësia e kompensimit nga paragrafi (4) i këtij neni, përcaktohet në bazë të vëllimit të punëve të kryera dhe shpenzimeve reale të bëra për kryerjen e punëve dhe të njëjtën e përcakton kryetari i komunës, kryetari i komunës së Qytetit të Shkupit, kryetari i Qytetit të Shkupit përkatësisht ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

VI. PROCEDURA PËR PËRPILIMIN DHE MIRATIMIN E PLANEVE URBANISTIKE DHE DOKUMENTACIONEVE TË PLANIT URBANISTIK

Neni 24

(1) Procedura për përpilimin dhe miratimin e planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacioneve të planit urbanistik dhe dokumentacioneve të projektit urbanistik zbatohet në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(2) Shfrytëzues të sistemit informativ e-urbanizëm janë përpiluesi i planit urbanistik, planit të rregullimit të planit të përgjithshëm urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacionit të projektit urbanistik, miratuesi i planit urbanistik dhe planit të rregullimit të planit të përgjithshëm urbanistik, organi kompetent për miratim të dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacionit të projektit urbanistik, organet e administratës shtetërore që janë të përfshirë në procedurën për miratimin e planit urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacionit të projektit urbanistik në pajtim me dispozitat e këtij ligji, subjektet nga neni 32 paragrafi (1) i këtij ligji, anëtarët e komisionit për urbanizëm nga neni 23 i këtij ligji, anëtarët e komisioneve nga neni 34 paragrafi (8) i këtij ligji dhe neni 35 paragrafi (10) të këtij ligji, Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm, Inspektorati Shtetëror Administrativ, pjesëmarrësit në debatin profesional dhe anketën publike dhe anëtarët e Këshillave të komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit.

(3) Këmbimi i të dhënave ndërmjet shfrytëzuesve të sistemit informativ e-urbanizëm nga paragrafi (2) i këtij neni, vërtetohet nga ana e shfrytëzuesit me certifikatë valide digjitale të lëshuar nga lëshuesi i autorizuar, nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(4) Mënyrën e zbatimit të procedurës për përpilimin dhe miratimin e planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacioneve

të planit urbanistik dhe dokumentacioneve të projektit urbanistik, në formë elektronike i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

1. Kushtet për planifikim hapësinor

Neni 25

(1) Për shqyrtim të mundësive të planit për planifikim të hapësirës përkatësisht përpilim të planeve urbanistike dhe dokumentacionit të planit urbanistik, organi kompetent për përpilimin e programit të planit në rastet e nenit 26 paragrafi (2) dhe (3) të këtij ligji, përkatësisht parashtruesi i kërkesës për miratim të dokumentacionit të programit të planit në rastet e nenit 26 paragrafi (5) të këtij ligji, detyrohen para përpilimit të programit të planit të sigurojnë kushte për planifikim të hapësirës.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni kushte për planifikim të hapësirës nuk sigurohen gjatë përpilimit të:

- planit detajor urbanistik;
- planit urbanistik përfshirja e planit e të cilit është lëndë e planifikimit me plan tjetër urbanistik ose dokumentacion të planit urbanistik, kurse në fuqi është i njëjti Plan hapësinor sipas të cilit paraprakisht janë lëshuar kushte për planifikim të hapësirës për të njëjtën përfshirje të planit;
- planit urbanistik me të cilin bëhet ndryshim dhe plotësim i planit urbanistik, në periudhë kur në fuqi është Plani i njëherë hapësinor, sipas të cilit paraprakisht janë dhënë kushte për planifikim të hapësirës për të njëjtën përfshirje të planit dhe
- dokumentacionit të planit urbanistik me të cilin rregullohet hapësirë në përfshirjen e planit në suazat e planit të përgjithshëm urbanistik.

(3) Gjatë ndryshimit dhe plotësimit të planeve urbanistike me të cilat bëhet zgjerimi i përfshirjes së planit, sigurohen kushte për planifikim të hapësirës vetëm për pjesën për të cilën zgjerohet përfshirja e planit.

(4) Kërkesë për marrje të kushteve për planifikim të hapësirës parashtrohet në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm në Agjencinë për Planifikim të Hapësirës. Me kërkesën për marrje të kushteve për planifikim të hapësirës për përpilim të planit urbanistik, dokumentacionit të planit shtetëror dhe lokal urbanistik për nevojat e komunës, komunës në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, parashtrohet propozim i programit të planit nga neni 26 të këtij ligji dhe informatë nëse plani i propozuar është në suazat e përfshirjes së planit valid urbanistik ose dokumentacionit të planit urbanistik përkatësisht nëse është në suazat e përfshirjes së planit urbanistik përkatësisht dokumentacionit të planit urbanistik që është në procedurë miratimi, me ç'rast nëse është në suazat e përfshirjes së planit urbanistik përkatësisht dokumentacionit të planit urbanistik që është procedurë miratimi, komuna detyrohet të parashtrorë edhe kopje të kushteve të dhëna për planifikim për përfshirjen e planit në fjalë. Me kërkesën për marrje të kushteve për planifikim të hapësirës për përpilim të dokumentacionit të planit urbanistik për nevojat e personave fizikë dhe juridikë parashtrohet propozim i programit të planit nga neni 26 i këtij ligji.

(5) Pas pranimit të kërkesës për marrje të kushteve për planifikim të hapësirës për përpilim të dokumentacionit të planit urbanistik për nevojat e personave juridikë dhe fizikë në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni si dhe në rastet nga paragrafi (9) të këtij neni, Agjencia për Planifikim të Hapësirës, me detyrë zyrtare, menjëherë parashtron kërkesë në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm te komuna në rajonin e të cilës është përfshirja e planit, për marrje të informatës nëse përfshirja e propozuar është në përbërje të përfshirjes së planit të planit

valid urbanistik ose dokumentacionit të planit urbanistik përkatësisht nëse është në përbërje të përfshirjes së planit të planit urbanistik përkatësisht dokumentacionit të planit urbanistik që është në procedurë për miratim.

(6) Komuna në të cilën është parashtruar kërkesa nga paragrafi (5) i këtij neni, detyrohet në afat prej tri ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës, të dërgojë përgjigje në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, me ç'rast nëse përfshirja e propozuar është në përbërje të përfshirjes së planit urbanistik përkatësisht dokumentacionit të planit urbanistik që është në procedurë miratimi, komuna është e detyruar të parashtrorë edhe kopje të kushteve të dhëna për planifikim për përfshirjen e planit në fjalë.

(7) Agjencia për Planifikim të Hapësirës është e detyruar që në afat prej 10 ditëve nga pranimi i kërkesës nga paragrafi (4) i këtij neni të përpilojë elaborat për kushte për planifikim të hapësirës dhe të parashtrorë kërkesë për lëshim të aktvendimit në pajtim me paragrafin (8) të këtij neni të organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e planifikimit hapësiror, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm. Me kërkesën parashtrohen elaborat për kushte për planifikim të hapësirës dhe propozim të programit të planit.

(8) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e planifikimit hapësiror është i detyruar që në afat prej pesë ditëve të punës nga pranimi i kërkesës nga paragrafi (7) i këtij neni, të miratorë aktvendim për kushte për planifikim të hapësirës ose aktvendim për refuzim të kërkesës dhe të njëjtin ta dërgojë te parashtruesi i kërkesës për marrje të kushteve për planifikim të hapësirës, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(9) Me përjashtim të paragrafit (4) të këtij neni, gjatë përpilimit të planeve urbanistike dhe dokumentacioneve të planit urbanistik, përpilimi i të cilave financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, kushtet për planifikim të hapësirës përpilohen dhe jepen me detyrë zyrtare.

(10) Parashtruesi i kërkesës për dhënie të kushteve për planifikim të hapësirës, detyrohet t'i kompensojë shpenzimet për përpilimin e kushteve për planifikim të hapësirës, lartësinë e të cilit e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e planifikimit hapësiror, në bazë të shpenzimeve reale të bëra për dhënien e kushteve për planifikim të hapësirës.

(11) Me përjashtim të paragrafit (10) të këtij neni, gjatë përpilimit të planeve urbanistike dhe dokumentacioneve të planit urbanistik përpilimi i të cilave financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, si dhe gjatë përpilimit të planeve urbanistike për fshat, kërkuesi nuk i kompenzon shpenzimet për përpilimin e kushteve për planifikim të hapësirës, kurse shpenzimet kompensohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë me programin vjetor për financim të përpilimit të planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacioneve të planit urbanistik dhe dokumentacionit të projektit urbanistik nga neni 22 paragrafi (2) i këtij ligji.

2. Programi i planit

Neni 26

(1) Planet urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji, planet e rregullimit të planit të përgjithshëm urbanistik dhe dokumentacioneve të planit urbanistik nga neni 7 paragrafi (2) të këtij ligji përpilohen në bazë të programit të planit me të cilin përcaktohet kufiri dhe përmbajtja e përfshirjes së planit dhe i njëjti përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike.

(2) Programi i planit për planet urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 dhe për dokumentacionin e planit urbanistik lokal për nevojat e komunës, komunës së Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit përpilohet nga ana e komisionit për urbanizëm të organit kompetent për miratimin e planit urbanistik përkatësisht për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik, ndërsa të njëjtin e miraton kryetari i komunës, kryetari i komunës së Qytetit të Shkupit përkatësisht kryetari i Qytetit të Shkupit.

(3) Programi i planit për plane urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 dhe për dokumentacionin e planit urbanistik nga neni 7 paragrafi (2) të këtij ligji përpilimi i të cilit është paraparë me programin vjetor për financimin e përpilimit të planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacionin e planit urbanistik dhe dokumentacionin të projektit urbanistik nga neni 22 paragrafi (2) të këtij ligji, e përpilon komisioni për urbanizëm i organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës ose Agjencia për Planifikim të Hapësirës, dhe të njëjtin e miraton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(4) Programi i planit për përpilimin e dokumentacionit të planit urbanistik për nevojat e personave juridikë dhe fizikë përpilohet nga ana e personit juridik me licencë për përpilimin e planeve urbanistike, dhe të njëjtin e miraton organi kompetent për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik.

(5) Në rastet nga paragrafi (4) i këtij neni, dorëzohet kërkesë për miratimin e programit të planit në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, me të cilën dorëzohet propozim i programit të planit, të komisioni për urbanizëm i organit kompetent nga paragrafi (4) i këtij neni, që detyrohet në afat prej pesë ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës për miratimin e programit të planit të dorëzohet propozim të kryetari i komunës, kryetari i komunës së Qytetit të Shkupit përkatësisht të ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, për miratimin ose për mospranimin e kërkesës për miratimin e programit të planit, në formë elektronike nëpërmjet sistemit të informativ e-urbanizëm.

(6) Kryetari i komunës, kryetari i komunës së Qytetit të Shkupit përkatësisht ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, në bazë të propozimit të dorëzuar, detyrohet në afat prej tri ditësh pune nga pranimi i propozimit nga paragrafi (5) i këtij neni të miratorë aktvendim me të cilin e miraton programin e planit ose të dorëzojë njoftim për mospranimin e programit të planit me arsyetim të shkaqeve për mospranim në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(7) Nëse programi i planit ka të bëjë me planet urbanistike ose me dokumentacionin e planit urbanistik nga neni 73 i këtij ligji, komisioni kompetent detyrohet me detyrë zyrtare të dorëzojë kërkesë për pëlqim të Ministria e Mbrojtjes, në rastet nga paragrafi (2) dhe (3) të këtij neni para verifikimit të programit të planit, ndërsa në rastet nga paragrafi (5) i këtij neni menjëherë pas pranimit të kërkesës për miratimin e programit të planit.

(8) Organi kompetent nga paragrafi (7) i këtij neni, detyrohet të veprojë për kërkesën për pëlqim në afat prej tri ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, ndërsa në të kundërtën do të konsiderohet se nuk ka vërejtje dhe nëse për shkak të mosveprimit të tij në ardhmen krijohen dëme, obligimi për kompensimin e dëmit do të jetë në ngarkim të tij.

(9) Programi i planit i miratuar verifikohet, me vërtetim për verifikim në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, nga ana e anëtarëve të komisionit të organit i cili e ka miratuar programin e planit.

(10) Formën dhe përmbajtjen e programit të planit nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

3. Kërkesa për ridedikim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

Neni 27

(1) Nëse me programin e planit nga neni 26 i këtij ligji dhe me projektin për infrastrukturë përfshihen sipërfaqe të reja bujqësore organi i cili e ka miratuar programin e planit, detyrohet menjëherë pas verifikimit të programit të planit përkatësisht pas pranimit të projektit për infrastrukturë, me detyrë zyrtare, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, të parashtrijë kërkesë për ridedikim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm të organi e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë, me të cilën e dorëzon dokumentacionin e përcaktuar me Ligjin për tokë bujqësore.

(2) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë, pas pranimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, menjëherë fillon procedurë për ridedikim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në pajtim me Ligjin për tokë bujqësore, ndërsa pas miratimit të aktit me të cilin është dhënë pëlqim për dedikim të përhershëm, detyrohet që të njëjtin ta dorëzojë te organi i cili e ka dorëzuar kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(3) Plani urbanistik nuk mund të miratohet përkatësisht dokumentacioni i planit urbanistik nuk mund të miratohet nëse nuk miratohet akt me të cilin është dhënë pëlqim për ridedikim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në pajtim me Ligjin për tokë bujqësore,

(4) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni, plani urbanistik përkatësisht dokumentacioni i planit urbanistik përpilimi i të cilit financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, dokumentacioni i planit urbanistik për ndërtesa me interes të veçantë si dhe projekti për infrastrukturë mund të miratohet përkatësisht të lejohet gjatë procedurës për ridedikim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore edhe para miratimit të aktit me të cilin është dhënë pëlqim për ridedikim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

(5) Nëse përpilimi i planit urbanistik përkatësisht dokumentacionit të planit urbanistik dhe projektit për infrastrukturë, për të cilët është dorëzuar kërkesë në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni është ndërprerë dhe të njëjtat nuk do të miratohen përkatësisht të lejohen, miratuesi i planit urbanistik përkatësisht parashtruesi i kërkesës për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik përkatësisht projektit për infrastrukturë detyrohet të dorëzojë njoftim te organi i administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(6) Shpenzimet eventuale për ridedikimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore (shpenzimet për kryerjen e vlerësimit të dëmit eventual, për kompensimin e dëmit eventual për shkak të ndërprerjes së marrëveshjeve për marrje me qira), si dhe për kompensimin e dëmit eventual për shkak të mosdorëzimit të njoftimit në pajtim me paragrafin (5) të këtij neni, janë obligim i miratuesit të planeve urbanistike përkatësisht parashtruesit të kërkesës për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik dhe projektit për infrastrukturë.

(7) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni procedura për ridedikim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nuk zbatohet gjatë miratimit të planit urbanistik për fshat, me të cilin rregullohet hapësirë në kufijtë e vendbanimit në fshat.

4. Vlerësimi strategjik për ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe mbi shëndetin e njerëzve

Neni 28

(1) Vlerësimi strategjik për ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe mbi shëndetin e njerëzve zbatohet gjatë miratimit të planit të përgjithshëm urbanistik, planit urbanistik për fshatra, dokumentacionit, dhe gjatë miratimit të planit urbanistik detajor vetëm nëse nuk është zbatuar vlerësim strategjik për ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe mbi shëndetin e njerëzve gjatë miratimit të planit të përgjithshëm urbanistik mbi bazë të të cilit është përpiluar plani detajor urbanistik në fjalë.

(2) Miratuesi i planeve urbanistike dokumentacionit të planit urbanistik nga paragrafi (1) i këtij neni detyrohet pas miratimit të programit vjetor nga neni 20 paragrafi (1) i këtij neni, të miratojë vendim për zbatim ose vendim për moszbatimin e vlerësimit strategjik për ndikim mbi mjedisin jetësor dhe mbi shëndetin e njerëzve, në të cilin janë arsyetuar shkaqet për zbatimin përkatësisht moszbatimin e vlerësimit, në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara me Ligjin për mjedis jetësor.

(3) Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në afat prej tetë ditësh nga pranimi i vendimit me të cilin është vendosur të moszbatohet vlerësimi strategjik për ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe mbi shëndetin e njerëzve, formularët dhe dokumentet tjera shoqëruese të përcaktuara me Ligjin për mjedis jetësor, nuk miraton aktvendim me të cilin e obligon miratuesin e planit urbanistik përkatësisht dokumentacionit të planit urbanistik të zbatojë vlerësim strategjik për ndikim mbi mjedisin jetësor dhe mbi shëndetin e njerëzve, nuk zbatohet vlerësim strategjik.

5. Fazat e përpilimit të planeve urbanistike

Neni 29

(1) Plani hapësinor dhe plani i përgjithshëm urbanistik përpilohen në dy faza, përkatësisht si draft-plane dhe propozim-plan.

(2) Plani urbanistik i detajuar, plani urbanistik për fshat dhe plani urbanistik jashtë vendbanimit, përpilohen në një fazë, si propozim-plan.

Neni 30

(1) Draft-Planin Hapësinor e përcakton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë pas debatit profesional të zbatuar paraprakisht me pjesëmarrje të publikut profesionalë, përfaqësuesve të organeve të administratës shtetërore, përfaqësuesve të njësive të vetëqeverisjes lokale, institucioneve kompetente për mbrojtjen e trashëgimisë së patundshme kulturore, institucioneve shkencore-profesionale, ndërmarrjeve komunale dhe organizatave joqeveritare.

(2) Debatin profesional për Draft-Planin hapësinor, planin hapësinor të rajonit, planin hapësinor të komunës, të komunave të Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit dhe planin hapësinorë të rajoneve me interes publik, e organizon organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e planifikimit hapësinor i cili përpilon edhe raport për debatin profesional.

(3) Raportin nga paragrafi (2) i këtij neni me procesverbal nga debati, listën dhe arsyetimin për vërejtjet e pranuar dhe të papranuara nga debati profesional, e përpilon komisioni profesional i përbërë prej tre anëtarësh edhe atë një përfaqësues i miratuesit - person profesional nga sfera e planifikimit hapësinor, një përfaqësues i përpiluesit të dokumentacionit të planit-bartës i përpilimit të planit dhe një punëtor shkencorë dhe profesional nga sfera e planifikimit hapësinor.

(4) Raporti nga paragrafi (2) i këtij neni është pjesë përbërëse e propozim-planit.

Neni 31

Draft-planin e përgjithshëm urbanistik, propozim-planin detajor urbanistik, propozim-planin urbanistik për fshat dhe propozim-planin urbanistik jashtë vendbanimit e përpilon përpiluesi i planit urbanistik, në pajtim me programin e miratuar të planit nga neni 26 i këtij ligji.

6. Të dhëna dhe informata

Neni 32

(1) Subjektet të cilat i kryejnë punët nga sfera e mbrojtjes së mjedisit jetësor, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, mbrojtjes dhe shpëtimit, mbrojtjes shëndetësore, arsimit, bujqësisë, ekonomisë së ujërave, transportit dhe lidhjeve, aviacionit, sigurisë, rrugëve publike, si dhe subjektet kompetente për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së komunikacionit, ujësjellësit, kanalizimit, elektroenergetike, telekomunikuese, përcimit të nxemjes dhe gazpërçuese, detyrohen t'i dorëzojnë të gjitha të dhënat dhe informatat me të cilat disponojnë të përpiluesi i planit hapësinor, planit urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacionit të projektit urbanistik.

(2) Për marrjen e të dhënave dhe informatave nga paragrafi (1) i këtij neni, përpiluesi i planit urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacionit të projektit urbanistik, dorëzon kërkesë të subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(3) Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni, detyrohen t'i dorëzojnë të gjitha të dhënat dhe informatat të përpiluesi i planit urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacionit të projektit urbanistik, në afat prej 10 ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(4) Nëse subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk i dorëzojnë të dhënat dhe informatat me të cilat disponojnë, në afatin nga paragrafi (3) i këtij neni do të konsiderohet se nuk disponojnë me të dhënat dhe informatat e kërkuara, me ç'rast dëmet e ardhshme eventuale të shkaktuara për shkak të mosdorëzimit të të dhënave dhe informatave do të jenë në ngarkim të subjekteve të cilat nuk i kanë dorëzuar të dhënat dhe informatat e nevojshme, përkatësisht nuk i janë përgjigjur kërkesës.

(5) Nëse subjektet nga paragrafi (1) i këtij kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në afatin nga paragrafi (3) i këtij neni, dorëzon informatë se për përfshirjen në fjalë duhet të përpilohen baza mbrojtëse konservuese, ose është në rrjedhë përpilimi baza mbrojtëse konservuese, në planin urbanistik, në dokumentacionin e planit urbanistik dhe dokumentacionin e projektit urbanistik nuk inkorporohen bazat mbrojtëse konservuese, e në procedurë për lëshimin e lejes për ndërtim detyrimisht sigurohen kushtet mbrojtëse konservuese për ndërtimet në përfshirjen në fjalë. Në këtë rast në pjesën tekstuale të planit urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacionit të projektit urbanistik detyrimisht konstatohet obligimi për sigurimin e kushteve mbrojtëse konservuese në procedurë për lëshimin e lejes për ndërtim.

(6) Të dhënat dhe informatat nga paragrafi (1) i këtij neni janë pjesë përbërëse dhe shtojcë e bazës së dokumentacionit të planit urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacionit të projektit urbanistik.

(7) Mënyrën e përgatitjes dhe dorëzimit të të dhënave dhe informatave nga paragrafi (1) i këtij neni, nga sfera e planifikimit të hapësirës i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e planifikimit hapësinor.

(8) Mënyrën e përgatitjes dhe dorëzimit të të dhënave dhe informatave nga paragrafi (1) i këtij neni, nga sfera e planifikimit të hapësirës, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e planifikimit të hapësirës.

(9) Mënyrën e përgatitjes dhe dorëzimit të të dhënave dhe informatave nga paragrafi (1) i këtij neni, nga sfera e rregullimit të hapësirës, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

7. Mendimi profesional i draft-planit dhe propozim-planit

Neni 33

(1) Pas përpilimit të draft-planit të përgjithshëm urbanistik, përkatësisht propozim-planit të përgjithshëm urbanistik, propozim-planit urbanistik për fshat dhe propozim-planit urbanistik jashtë vendbanimit, komisioni kompetent për urbanizëm nga neni 23 i këtij ligji, detyrohet në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, të japë mendim profesional për shqyrtimin e shkallës së harmonizimit të draft-planit të përgjithshëm urbanistik përkatësisht të propozim-planit detajor urbanistik, planit urbanistik për fshat dhe planit urbanistik jashtë vendbanimit, me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të të njëjtit.

(2) Komisioni kompetent nga neni 23 i këtij ligji detyrohet mendimin nga paragrafi (1) i këtij neni ta japë në afat prej 15 ditësh pune nga dita e dorëzimit të draft-planit të përgjithshëm urbanistik përkatësisht në afat prej tetë ditësh pune nga dita e dorëzimit të propozim-planit detajor urbanistik, planit urbanistik për fshat dhe planit urbanistik jashtë vendbanimit, nga ana e përpiluesit të planit urbanistik, ndërsa në të kundërtën do të konsiderohet se është lëshuar mendim pozitiv.

(3) Përpiluesi i planit urbanistik, detyrohet të veprojë sipas mendimit profesional nga paragrafi (1) i këtij neni dhe ta dorëzojë draftin përkatësisht propozimin e planit të miratuesi i planit urbanistik.

8. Debat i profesional i draft-planit të përgjithshëm urbanistik

Neni 34

(1) Debat i profesional zbatohet mbi draft-planin e përgjithshëm urbanistik pas marrjes së mendimit profesional për të njëjtin në pajtim me nenin 33 të këtij ligji.

(2) Komuna organizon debat profesional për draft-planin e përgjithshëm urbanistik, ndërsa Qyteti i Shkupit organizon debat profesional për draft-planin e përgjithshëm urbanistik të Qytetit të Shkupit, më së voni në afat prej 10 ditësh pune nga pranimi i draft-planit të përgjithshëm urbanistik për të cilin është dhënë mendim profesional në pajtim me nenin 33 të këtij ligji.

(3) Për mbajtjen e debatit profesional njoftohen subjektet nga neni 32 paragrafi (1) i këtij ligji, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, ndërsa shpallet edhe njoftim në sistemin informativ e-urbanizëm si dhe në dy gazeta publike, së paku tri ditë pune para mbajtjes së debatit, ku detyrimisht theksohet emërtimi i planit, koha dhe vendi mbajtjes së debatit profesional.

(4) Debat i profesional njëkohësisht zbatohet edhe në formë elektronike edhe të shkruar.

(5) Debat i profesional në formë elektronike zbatohet nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, ndërsa debati profesional në formë me shkrim zbatohet me nxjerrjen e planit në vend publik i cili gjendet në komunë përkatësisht në Qytetin e Shkupit ose në hapësirat e komunës përkatësisht të Qytetit të Shkupit.

(6) Pjesëmarrje në debatin profesional krahas subjekteve nga neni 32 paragrafi (1) i këtij ligji mund të marrin edhe persona tjerë të interesuar nga rajoni i përfshirë me planin.

(7) Subjektet nga neni 32 paragrafi (1) i këtij ligji dhe personat e interesuar mund të dorëzojnë vërejtje për draft-planin, më së voni në afat prej pesë ditësh pune nga mbajtja e debatit profesional, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose në formë me shkrim, ndërsa nëse të njëjtat nuk dorëzohen do të konsiderohet se nuk kanë vërejtje të zgjidhjes së planit.

(8) Për debatin e mbajtur publik përpilohet raport, të cilin me procesverbalin nga debati dhe me arsyetimet e veçanta për vërejtjet e pranuar dhe të papranuara nga debati profesional e përpilon komisioni profesional i përbërë prej tre anëtarëve edhe atë një përfaqësues i miratuesit të planit (person profesional nga sfera e planifikimit hapësinorë), një përfaqësues i përpiluesit të planit (bartës i përpilimit të planit), dhe një punëtor profesional nga sfera e planifikimit urbanistik, të cilin e formon kryetari i komunës përkatësisht kryetari i Qytetit të Shkupit.

(9) Raporti nga paragrafi (8) i këtij neni përpilohet më së voni në afat prej 10 ditësh nga dita e përfundimit të shqyrtimit profesional dhe i njëjti është pjesë përbërëse e propozim-planit, dhe nxirret edhe në formë elektronike në sistemin informativ e-urbanizëm.

(10) Përpiluesi i planit përpilon plan përfundimtar të planit të përgjithshëm urbanistik më së voni në afat prej 15 ditësh pune nga përpilimi i raportit nga paragrafi (8) i këtij neni dhe të njëjtin e dorëzon te miratuesi i planit urbanistik.

9. Prezantimi publik dhe anketa publike

Neni 35

(1) Prezantimi publik dhe anketa publike zbatohen mbi propozim-planin të detajuar urbanistik, mbi propozim-planin urbanistik për fshat dhe propozim-planit urbanistik jashtë vendbanimit, pas marrjes së mendimit profesional mbi propozim-planin në pajtim me nenin 33 të këtij ligji.

(2) Komuna përkatësisht komuna në Qytetin e Shkupit fillon procedurë për zbatimin e prezantimit publik dhe anketës publike për propozim-planin urbanistik të detajuar, propozim-planin urbanistik për fshat dhe propozim-planin urbanistik jashtë vendbanimit, më së voni në afat prej pesë ditësh pune pas pranimi të propozim-planit urbanistik për të cilin është dhënë mendim profesional në pajtim me nenin 33 të këtij ligji.

(3) Për mbajtjen e prezantimit publik dhe anketës publike njoftohen subjektet nga neni 32 paragrafi (1) i këtij ligji, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, ndërsa shpallet edhe kumtesë në sistemin informativ e-urbanizëm, si dhe në dy gazeta publike, së paku tri ditë pune para fillimit të anketës publike, në të cilën detyrimisht theksohet emërtimi i planit, koha dhe vendi i mbajtjes së anketës publike, koha dhe vendi i mbajtjes së prezantimit publik, vendpozita dhe sipërfaqja e përfshirjes së planit.

(4) Pjesëmarrje në prezantimin dhe në anketën publike mund të marrin subjektet nga neni 32 paragrafi (1) i këtij ligji, si dhe personat e interesuar juridikë dhe fizikë nga rajoni i përfshirë me planin.

(5) Anketa publike nga paragrafi (1) i këtij neni njëkohësisht zbatohet edhe në formë elektronike edhe me shkrim.

(6) Anketa publike në formë elektronike zbatohet nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, ndërsa anketa publike me shkrim zbatohet me nxjerrjen e planit në vend publik i cili gjendet në komunë ose në hapësirat e komunës.

(7) Prezantimi publik është prezantim profesional i planit i cili organizohet në suaza të anketës publike dhe zgjat një ditë pune.

(8) Anketa publike për propozim-planin detajor urbanistik zgjat së paku dhjetë ditë pune, ndërsa për propozim-planin urbanistik për fshat dhe propozim-planin

urbanistik jashtë vendbanimit, së paku pesë ditë pune, në të cilin afat subjektet nga neni 32 paragrafi (1) i këtij ligji si dhe të gjithë personat e interesuar fizikë dhe juridikë mundin me fletë anketuese të dorëzojnë vërejtje dhe propozime për propozim-planin, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose në formë me shkrim.

(9) Nëse në afatet e përcaktuara në paragrafin (8) të këtij neni subjektet nga neni 32 paragrafi (1) i këtij ligji dhe pjesëmarrësit tjerë, nuk dorëzojnë vërejtje dhe propozime, do të konsiderohet se nuk kanë vërejtje dhe propozime për zgjidhjen e planit.

(10) Për prezantimin e zbatuar publik dhe anketën publike përpilohet raport me arsyetim për vërejtjet e pranuar dhe të papranuara për planin urbanistik, nga ana e komisionit profesional të formuar nga kryetari i komunës përkatësisht komunës së Qytetit të Shkupit, i cili përbëhet prej tre anëtarësh edhe atë përfaqësuesi i përpiluesit të planit (person i punësuar në administratën komunale kompetent për planifikim hapësinorë dhe punëtor profesional nga sfera e planifikimit hapësinor).

(11) Raporti nga paragrafi (10) i këtij neni përpilohet më së voni në afat prej pesë ditësh pune nga dita e kryerjes së anketës publike dhe i njëjti është pjesë përbërëse e propozim-planit, dhe paraqitet edhe në formë elektronike në sistemin informativ e-urbanizëm.

(12) Në bazë të raportit, komisioni nga paragrafi (10) i këtij neni detyrohet, në afat prej pesë ditësh pune nga përpilimi i raportit ta njoftojë çdo subjekt nga neni 32 paragrafi (1) të këtij ligji dhe çdo person fizik dhe juridik të cilët kanë parashtrues fletë anketuese, me arsyetim për pranimin ose mospranimin e vërejtjeve ose propozimeve të tyre, me ç'rast personat të cilët kanë parashtruar fletë anketuese në formë elektronike njoftohen në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, ndërsa personat të cilët kanë parashtruar fletë anketuese në formë në letër njoftohen me shkrim.

(13) Nëse komisioni nga paragrafi (10) i këtij neni vlerëson se propozim-planin me vërejtjet e pranuar nga anketa publike ka pësuar ndryshime të rëndësishme (ndryshim i kufirit të përfshirjes urbanistike, ndryshim i linjës së rregullimit dhe ndryshim i dedikimit të tokës), sërish zbatohet prezantim publik dhe anketa publike. Anketa e përsëritur publike dhe prezantimi publik zgjat së paku pesë ditë pune.

(14) Përpiluesi i planit përpilon propozim-plan përfundimtar urbanistik, më së voni në afat prej dhjetë ditësh pune nga përpilimi i raportit nga paragrafi (10) i këtij neni dhe të njëjtin e dorëzon te miratuesi i planit urbanistik.

10. Mendimi për propozim-planin urbanistik përfundimtar

Neni 36

(1) Miratuesi i planit urbanistik detyrohet menjëherë pas pranimi të propozim-planit përfundimtar detajor urbanistik, propozim-planit përfundimtar urbanistik për fshat dhe propozim-planit përfundimtar urbanistik jashtë vendbanimit, nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm më formë elektronike, të dorëzojë kërkesë për mendim te organi kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, te organi kompetent për mbrojtjen e mjedisit jetësor, te Agjencia për Kadastër të Patundshmërive, ndërsa komunat në Qytetin e Shkupit dhe te Qyteti i Shkupit.

(2) Te organi kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe te organi për mbrojtjen e mjedisit jetësor, dorëzohet kërkesë për mendim në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, vetëm nëse të njëjtat kanë dorëzuar vërejtje dhe propozime për planin urbanistik gjatë anketës publike.

(3) Organi kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe organi për mbrojtjen e mjedisit jetësor detyrohen të japin mendim nëse është vepruar sipas

vërejtjeve dhe propozimeve të tyre të dhëna gjatë anketës publike, Agjencia për Kadastro të Patundshmërive detyrohet të japë mendim për gjendjen e përcaktuar pas krahasimit të kryer të të dhënave të planit urbanistik me të dhënat e planit të kadastrës, ndërsa Qyteti i Shkupit nëse propozimi i planit detajor urbanistik në komunat e Qytetit të Shkupit është në pajtim me planin e përgjithshëm urbanistik dhe nëse janë respektuar dispozitat për rrjetin primar të komunikacionit të planit të përgjithshëm urbanistik në Qytetin e Shkupit.

(4) Subjektet nga paragrafi (3) i këtij neni detyrohen në afat prej pesë ditësh pune nga pranimi i kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm të japin mendim, ndërsa në të kundërtën do të konsiderohet se nuk kanë vërejtje dhe se është dhënë mendim pozitiv, me ç'rast dëmet e ardhshme eventuale të shkaktuara për shkak të mosveprimit, do të jenë në ngarkim të organit i cili nuk ka vepruar për kërkesën.

(5) Nëse në procedurën për miratimin e planit urbanistik janë zbatuar dy anketa publike, propozimi përfundimtar i planit urbanistik dorëzohet edhe te komisioni kompetent për urbanizëm nga neni 23 i këtij ligji i cili detyrohet të dorëzojë mendim profesional për shqyrtimin e shkallës së harmonizimit të propozimit përfundimtar të planit urbanistik, me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të të njëjtit, në afatin e përcaktuar në paragrafin (4) të këtij neni, ndërsa në të kundërtën do të konsiderohet se nuk ka vërejtje dhe se është dhënë mendim pozitiv.

11. Revizioni profesional

Neni 37

(1) Mbi Draft-planin hapësinor, mbi propozim-planet përfundimtare urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji, mbi dokumentacionin e planit urbanistik nga neni 7 paragrafi (2) të këtij ligji si dhe mbi projektin për infrastrukturë, kryhet revizion profesional me të cilin përcaktohet nëse të njëjtat janë përpiluar në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji.

(2) Revizion profesional mbi draft-planin nga neni 7 paragrafi (1) pika 1 të këtij ligji, kryen komision profesional që e formon ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e planifikimit hapësinor dhe përbëhet prej së paku tre anëtarësh të institucioneve profesionale-shkencore, punëtorë të shquar shkencorë dhe profesionalë nga sfera e planifikimit hapësinor dhe urbanistik dhe nga sfera tjera esenciale për përpilimin e dokumentacionit të planit.

(3) Revizion profesional mbi propozim-planet përfundimtare urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji, pas zbatimit të procedurës nga neni 36 i këtij ligji, pas zbatimit të procedurës nga neni 36 i këtij ligji, si dhe mbi dokumentacionin e planit urbanistik nga neni 7 paragrafi (2) të këtij ligji, përpilimi i të cilit parashihet me programin vjetor për financimin e përpilimit të planeve urbanistike, planeve rregulluese të planeve të përgjithshme, dokumentacionit të planeve urbanistike dhe dokumentacionit të projekteve urbanistike urbanistike nga neni 22 paragrafi (2) të këtij ligji, kryen komisioni profesional që e formon ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e rregullimit hapësinor, që përbëhet nga së paku tre anëtarë, nga të cilët së paku dy janë bartës të autorizimit për përpilimin e planeve urbanistike ose autorizimit për revizionin e planeve urbanistike.

(4) Revizion profesional mbi propozimin përfundimtar të planeve urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji, pas zbatimit të procedurës nga neni 36 i këtij ligji si dhe mbi dokumentacionin të planit urbanistik nga

neni 7 paragrafi (2) të këtij ligji, përpilimi i të cilit është paraparë me programin vjetor për financimin e përpilimit të planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacionit të projektit urbanistik nga neni 22 paragrafi (2) të këtij ligji, kryen komisioni profesional të cilin e formon ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, i cili përbëhet nga së paku tre anëtarë, prej të cilëve së paku dy janë bartës të autorizimit për përpilimin e planit urbanistik ose autorizimit për revizion të planeve urbanistike.

(5) Revizion profesional mbi projektin për infrastrukturë kryen personi juridik i cili posedon licencë për revizion të planeve urbanistike ose personi juridik i cili posedon licencë për revizionin e dokumentacionit të projektit të lëshuar në pajtim me Ligjin për ndërtim.

(6) Për revizionin e kryer profesional, përpilohet raport për revizion profesional të planit urbanistik, dokumentacionit urbanistik të planit dhe projektit për infrastrukturë, në të cilin konstatohet nëse të njëjtit janë përpiluar në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të të njëjtit ose kanë mangësi të cilat duhet të mënjanohej. Raporti për revizion profesional në rastet nga paragrafi (3) i këtij neni nënshkruhet nga ana e personit përgjegjës në personin juridik dhe personit fizik të cilët e kanë kryer revizionin profesional, ndërsa në rastet nga paragrafi (2) dhe paragrafi (4) i këtij neni nga ana e anëtarëve të komisionit.

(7) Personi juridik i cili e ka përpiluar planin urbanistik, dokumentacionin e planit urbanistik dhe projektin për infrastrukturë si dhe personi fizik i cili ka marrë pjesë në përpilimin e të njëjtëve, nuk mund të kryejë revizionin profesional për të njëjtin plan urbanistik, dokumentacion të planit urbanistik përkatësisht projekt për infrastrukturë.

(8) Formën dhe përmbajtjen e raportit për revizion profesional të planeve urbanistike, dokumentacionit të planit urbanistik dhe projektit për infrastrukturë i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

12. Pëlqimi i planit urbanistik

Neni 38

(1) Për planet e nenit 7 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji të përpiluara në formë të propozim-planit dhe për të cilat është përpiluar raport pozitiv për revizionin profesional në pajtim me nenin 37 të këtij ligji, pëlqim jep organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, me të cilin vërtetohet se të njëjtat janë përpiluar në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe me rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji.

(2) Organi kompetent nga paragrafi (1) i këtij neni detyrohet në afat prej dhjetë ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për marrjen e pëlqimit nga ana e miratuesit të planit, të japë pëlqim ose të dorëzojë njoftim për mangësi të e konstatuara të planit urbanistik të miratuesi i planit urbanistik, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, ndërsa në të kundërtën do të konsiderohet se pëlqimi është lëshuar.

(3) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, gjatë shqyrtimit të sërishëm të planit urbanistik për të cilin paraprakisht është lëshuar njoftim për mangësi në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, nuk mund të theksojë mangësi të reja të cilat paraprakisht nuk janë theksuar në njoftimin për mangësi, përveç nëse është zbatuar sërish anketë publike.

(4) Pas marrjes së pëlqimit nga paragrafi (2) i këtij neni, plani urbanistik dorëzohet te miratuesi i planit urbanistik, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

13. Miratimi i planit urbanistik

Neni 39

(1) Kryetari i komunës, komunës së Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit detyrohet që më së voni tri ditë pune pas marrjes së pëlqimit nga neni 38 paragrafi (2) i këtij ligji, e nëse nuk është lëshuar pëlqim dhe nuk është dorëzuar njoftim për mangësitë e konstatuara të planit urbanistik, pas skadimit të afatit për lëshimin e pëlqimit të përcaktuar në nenin 38 paragrafi (2) të këtij ligji, ta dorëzojë propozimin e planit në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, te Këshilli i komunës, komunës së Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit ndërsa kryetari i Këshillit detyrohet propozimin e planit ta vendosë në mbledhjen e parë të ardhshme të Këshillit, ndërsa Këshilli detyrohet të vendosë për të njëjtin në mbledhjen e njëjtë.

(2) Planin urbanistik për të cilin nuk është dhënë pëlqim ose nuk është dorëzuar njoftim për mangësitë e konstatuara të planit urbanistik te miratuesi i planit urbanistik, në pajtim me nenin 38 paragrafi (2) të këtij ligji, organi kompetent mund ta miratojë pas marrjes së njoftimit të kryetarit të komunës, komunës në Qytetin e Shkupit përkatësisht kryetarit të Qytetit të Shkupit, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, në të cilin është vërtetuar se organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës nuk ka vepruar në pajtim me nenin 38 paragrafi (2) të këtij ligji.

(3) Nëse kryetari i komunës, komunës në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit nuk e dorëzon propozimin e planit te Këshilli në afatin e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, së paku 1/3 e anëtarëve të Këshillit mund të dorëzojnë propozim për miratimin e propozim-planit te kryetari i Këshillit të komunës, të komunës në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, i cili detyrohet që propozim-planin ta vendosë në mbledhjen e parë të ardhshme të Këshillit, ndërsa Këshilli detyrohet të vendosë për të njëjtin në mbledhjen e njëjtë.

(4) Raporti për anketën e zbatuar publike nga neni 35 paragrafi (10) i këtij ligji dhe propozimi i planit urbanistik, duhet të jenë të kapshme në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm për çdo anëtar të Këshillit të komunës, komunës së Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit.

(5) Këshilli i komunës, komunës në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit mund ta miratojë përkatësisht të mos e miratojë propozim-planin nëse konsideron se i njëjti nuk është përpiluar në pajtim me rregullat ligjore me ç'rast detyrohet të miratojë vendim me arsyetim për parregullsinë e konstatuar për shkak të së cilës propozim-planin nuk është miratuar.

(6) Në rastet nga paragrafi (5) i këtij neni, kur është miratuar vendim me arsyetim për parregullsinë e konstatuar për shkak të së cilës propozim-planin nuk është miratuar, kryetari i komunës, komunës në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit detyrohet në afat prej tri ditësh pune nga mbajtja e mbledhjes së Këshillit, ta dorëzojë propozim-planin dhe vendimin e miratuar në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, ndërsa organi detyrohet në afat prej 10 ditësh pune t'i kontrollojë konstatimet në arsyetimin e vendimit për parregullsinë e konstatuar dhe nëse përcakton se të njëjtat janë të bazuara ta anulojë pëlqimin e dhënë dhe ta njoftojë përpiluesin e planit, ndërsa nëse përcakton se të njëjtat janë të pabazuara përsëri ta dorëzojë propozimin e planit te komuna, komuna në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(7) Në rastet nga paragrafi (6) i këtij neni kur pëlqimi i dhënë është anuluar, përpiluesi i planit detyrohet t'i qaset mënjanimit të parregullsisë të konstatuara dhe sërish ta dorëzojë propozim-planin te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës për marrjen e pëlqimit, me ç'rast nëse sërish është dhënë pëlqim, kryetari i komunës, komunës në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit detyrohet më së voni tri ditë pune pas marrjes së pëlqimit ta dorëzojë propozim-planin te Këshilli i komunës, komunës në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, ndërsa kryetari i Këshillit detyrohet propozim-planin ta vendosë në mbledhjen e parë të ardhshme të Këshillit, ndërsa Këshilli detyrohet të vendosë për të njëjtin në mbledhjen e njëjtë.

(8) Në rastet nga paragrafi (6) i këtij neni kur pëlqimi i dhënë nuk është anuluar, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës përsëri e dorëzon propozim-planin te komuna, komuna në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, me ç'rast kryetari i komunës, komunës në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit detyrohen tri ditë pune pas pranimit të propozim-planit ta dorëzojë të njëjtin në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm te Këshilli i komunës, komunës në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, ndërsa kryetari i Këshillit detyrohet propozim-planin ta vendosë në mbledhjen e parë të ardhshme të Këshillit, ndërsa Këshilli detyrohet të vendosë për të njëjtin në mbledhjen e njëjtë.

(9) Plani urbanistik konsiderohet se është miratuar nëse për vendimin për miratimin e planit urbanistik kanë votuar së paku 1/3 nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit të komunës, komunës në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, me ç'rast numri i tyre nuk është më i vogël se numri i anëtarëve të Këshillit të komunës, komunës në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit që kanë votuar kundër vendimit për miratimin e planit urbanistik.

(10) Formën dhe përmbajtjen e pëlqimit dhe njoftimin për mangësitë e konstatuara i përcakton ministri i cilin udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

14. Procedura për përpilimin dhe miratimin e planit të rregullimit të planit të përgjithshëm urbanistik

Neni 40

(1) Plani i rregullimit të planit të përgjithshëm urbanistik përpilohet në bazë të programit të planit nga neni 26 i këtij ligji.

(2) Programi i planit për planin rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik përpilohet në bazë të ekstraktit të planit të përgjithshëm urbanistik me ç'rast për plan rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik të komunës të njëjtin e përpilon komisioni për urbanizëm i komunës nga neni 23 paragrafi (1) të këtij ligji, ndërsa programin e planit për planin rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik të Qytetit të Shkupit, e përpilon komisioni për urbanizëm i Qytetit të Shkupit nga neni 23 paragrafi (2) të këtij ligji.

(3) Programin e përpiluar të planit nga paragrafi (2) i këtij neni e miraton kryetari i komunës përkatësisht kryetari i Qytetit të Shkupit me ç'rast i njëjti verifikohet me vërtetim për verifikim në formë elektronike nga ana e anëtarëve të komisionit nga paragrafi (2) i këtij neni, nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(4) Pas verifikimit të programit të planit përpilohet propozim i planit rregullues i planit të përgjithshëm urbanistik, i cili dorëzohet te komuna përkatësisht Qyteti i Shkupit Këshilli i të cilit e miraton planin rregullues i planit të përgjithshëm urbanistik.

(5) Pas pranimi të planit rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik, komuna përkatësisht Qyteti i Shkupit, parashtrohet kërkesë për mendim në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm te Agjencia për Kadastër të Patundshmërive. Agjencia për Kadastër të Patundshmërive detyrohet të japë mendim për gjendjen e përcaktuar pas zbatimit të kryer të të dhënave nga plani rregullues i planit të përgjithshëm urbanistik me të dhënat nga plani i kadastrës, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, në afat prej pesë ditësh pune nga pranimi i kërkesës, ndërsa në të kundërtën do të konsiderohet se nuk ka vërejtje dhe se është dhënë mendim pozitiv, me ç'rast dëmtimet e ardhshme eventuale të shkaktuara për shkak të mosveprimit, do të jenë në ngarkim të Agjencisë për Kadastër të Patundshmërive.

(6) Pas zbatimit të procedurës nga paragrafi (5) i këtij neni, për propozimin e planit rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik mendim jep komisioni për urbanizëm i komunës nga neni 23 paragrafi (1) të këtij ligji, ndërsa për propozim-planin rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik të Qytetit të Shkupit, mendim jep komisioni për urbanizëm i Qytetit të Shkupit nga neni 23 paragrafi (2) i këtij ligji.

(7) Komisioni kompetent nga paragrafi (6) i këtij neni detyrohet në afat prej pesë ditësh pune nga dita e pranimi të propozimit të planit rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm të japë mendim pozitiv me të cilin vërtetohet se propozimi i planit rregullues i planit të përgjithshëm urbanistik është përpiluar në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të të njëjtit ose të dorëzojë njoftim për mangësi të konstatuara të përpiluesi i planit, ndërsa në të kundërtën do të konsiderohet se është lëshuar mendim pozitiv.

(8) Planin rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik të Qytetit të Shkupit, të përpiluar në formë të propozim-planit, për të cilin është dhënë mendim pozitiv në pajtim me paragrafin (5) të këtij neni dhe paragrafin (7) të këtij neni, e miraton Këshilli i Qytetit të Shkupit, ndërsa planin rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik të komunës, të përpiluar në formë të propozim-planit, për të cilin është dhënë mendim pozitiv në pajtim me paragrafin (5) të këtij neni dhe paragrafin (7) të këtij neni e miraton Këshilli i komunës.

15. Organe kompetente për miratimin e Planit hapësinor, planeve urbanistike dhe planit rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik

Neni 41

(1) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miraton Planin hapësinor.

(2) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë detyrohet ta miratojë Planin hapësinor, në afat prej gjashtë muajsh nga dita e dorëzimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(3) Këshilli i Qytetit të Shkupit miraton plan të përgjithshëm urbanistik të Qytetit të Shkupit dhe plan rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik të Qytetit të Shkupit.

(4) Këshillat e komunave në Qytetin e Shkupit miratojnë:

- plan të detajuar urbanistik,
- plan urbanistik për fshat dhe
- plan urbanistik jashtë vendbanimit.

(5) Këshillat e komunave me seli në qytet miratojnë:

- plan të përgjithshëm urbanistik,
- plan rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik,
- plan të detajuar urbanistik,
- plan urbanistik për fshat dhe
- plan urbanistik jashtë vendbanimit.

(6) Këshillat e komunave me seli në fshat miratojnë:

- plan urbanistik për fshat dhe

- plan urbanistik jashtë vendbanimit.

(7) Këshilli i komunës, Këshilli i komunës në Qytetin e Shkupit përkatësisht Këshilli i Qytetit të Shkupit detyrohet që planet urbanistike dhe planet e rregullimit të planit të përgjithshëm urbanistik, të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, t'i miratojë në afat prej dy muajsh nga dita e lëshimit të pëlqimit.

16. Obligime pas miratimit të vendimit për miratimin e Planit hapësinor, planit urbanistik dhe planit rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik

Neni 42

(1) Vendimi për miratimin e Planit hapësinor, si dhe ekzemplari i verifikuar nga plani i miratuar detyrimisht dorëzohen te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e planifikimit hapësinor.

(2) Planin i miratuar hapësinor verifikohet në pesë ekzemplarë prej të cilëve një ruhet në arkivin e miratuesit të planit, një në Arkivin Shtetëror të Republikës së Maqedonisë, një dorëzohet te organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e planifikimit hapësinor, një dorëzohet te Agjencia për Planifikim të Hapësirës dhe një dorëzohet te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(3) Vendimi për miratimin e planeve urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji si dhe për miratimin e planit rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik detyrimisht nxirret në formë elektronike në sistemin informativ e-urbanizëm, nga miratuesi i planeve urbanistike dhe planit rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik.

(4) Pas zbatimit të veprimit nga paragrafi (3) i këtij neni, plani i miratuar urbanistik dhe plani rregullues i planit të përgjithshëm urbanistik bëhet pjesë përbërëse e regjistratit elektronik të planeve të miratuara urbanistike në suaza të sistemit informativ e-urbanizëm, në të cilin qasje kanë miratuesi i planit urbanistik, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, Agjencia për Planifikim të Hapësirës dhe Agjencia për Kadastër të Patundshmërive.

(5) Miratuesi i planit urbanistik përkatësisht i planit rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik është i obliguar që ekzemplarin nga plani i miratuar urbanistik dhe plani rregullues i planit të përgjithshëm urbanistik në formë elektronike ta shpallë në ueb faqen e vet.

(6) Agjencia për Kadastër të Patundshmërive detyrohet që në afat prej tetë ditësh pune nga pranimi i njoftimit me formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, për miratimin e planit të kryejë paraqitje digjitale të planit urbanistik dhe planit rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik.

(7) Planin i miratuar urbanistik nuk mund të zbatohet para se të plotësohen kushtet nga paragrafët (3) dhe (6) të këtij neni.

17. Periudha e planit

Neni 43

(1) Planifikimi i hapësirës kryhet për periudhë prej së paku:

- pesëmbëdhjetë vjet për Plan hapësinor,
- dhjetë vjet për plan të përgjithshëm urbanistik, plan urbanistik për fshat dhe plan urbanistik jashtë vendbanimit dhe

- pesë vjet për plan të detajuar urbanistik.

(2) Periudha për planifikimin e hapësirës e përcaktuar në planin rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik duhet të jetë adekuat me periudhën për planifikimin e hapësirës të përcaktuar në planin e përgjithshëm urbanistik sipas të cilit është miratuar.

(3) Plani hapësinor vlen deri në miratimin e Planit të ri Hapësinor, ndërsa plani urbanistik deri në miratimin e planit të ri urbanistik.

VII. DOKUMENTACIONE TË PLANIT URBANISTIK

1. Dispozita të përgjithshme për dokumentacione të planit urbanistik

Neni 44

(1) Për rregullim të hapësirës, varësisht nga lloji i ndërtesës mund të përpunohen llojet në vijim të dokumentacioneve të planit urbanistik: dokumentacioni i planit urbanistik lokal, dokumentacioni i planit urbanistik shtetëror, dokumentacioni i planit urbanistik për zonë turistike zhvillimore, dokumentacioni i planit urbanistik për autokamp dhe dokumentacioni i planit për ndërtesa me interes të veçantë.

(2) Dokumentacionet e planit urbanistik i përpilon person juridik me licencë për përpilimin e planeve urbanistike, të lëshuar në pajtim me dispozitat të këtij ligji.

(3) Dokumentacionet e planit urbanistik detyrimisht përmbajnë masa të detajuara për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të patundshme sipas bazave konservatore të mbrojtura nëse në përfshirjen e planit ekziston trashëgimi kulturore e patundshme.

(4) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e përpunimit të dokumentacionit të planit urbanistik i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

Neni 45

(1) Dokumentacionit e planit urbanistik të lejuara janë pjesë përbërëse e regjistrit elektronik të dokumentacioneve të lejuara të planit urbanistik në suaza të sistemit informativ e-urbanizëm, kurse të njëjtat detyrimisht publikohen në ueb faqen e organit i cili i ka lejuar.

(2) Qasje në regjistrin elektronik të dokumentacioneve të planit urbanistik nga paragrafi (1) i këtij neni, kanë organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, Agjencia për Planifikim të Hapësirës, Inspektorati për Ndërtimtari dhe Urbanizëm dhe Agjencia për Kadastër të Patundshmërive.

2. Dokumentacioni i planit urbanistik lokal

Neni 46

(1) Dokumentacioni i planit urbanistik lokal është dokumentacion i planit me të cilin mund të kryhet rregullim dhe shfrytëzim i hapësirës me përcaktimin e parcelës jashtë përfshirjes së planit, për ndërtesa nga kategoria e dytë të përcaktuara me Ligjin për ndërtim.

(2) Me dokumentacionin e planit urbanistik lokal nuk mund të rregullohet hapësira për ndërtesa me dedikim A1 (banim në shtëpi banimi) dhe A2 (banim në ndërtesa banimi), në pajtim me standardet dhe normativat për planifikim urbanistik nga neni 68 i këtij ligji, përveç për përputhje të objekteve me dedikimin e theksuar për të cilat është miratuar aktvendim për përcaktimin statusit juridik në pajtim me ligjin për veprim me objekte të ndërtuara pa leje.

(3) Me përjashtim nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni me dokumentacionin e planit urbanistik lokal mund të kryhet rregullimi dhe shfrytëzimi i hapësirës jashtë përfshirjes së planit me përcaktimin e më shumë parcelave ndërtimore për ndërtesa me dedikim A1 (banim në shtëpi banimi), në pajtim me standardet dhe normativat për planifikim urbanistik nga neni 68 të këtij ligji, nëse lëndë e planifikimit është përfshirja e planit me sipërfaqe prej së paku një hektar, në të cilën parashihen së paku 20 parcela ndërtimore për ndërtim të ndërtesave me dedikimin e theksuar.

(4) Dokumentacioni i planit urbanistik lokal lejohet nga ana e komunës në rajonin e së cilës është përfshirja e planit që është lëndë e planifikimit.

(5) Dokumentacioni i planit urbanistik lokal përpilohet në bazë të kushteve për planifikim të hapësirës kurse gjatë përpilimit të dokumentacionit të planit urbanistik lokal, zbatohet procedurë për mbledhjen e të dhënave dhe informatave në nenin 32 të këtij ligji.

(6) Para përpilimit të dokumentacionit të planit urbanistik lokal, zbatohet procedurë e përpilimit përkatësisht miratimit të programit të planit, të përcaktuar në nenin 26 të këtij ligji, veprohet në pajtim me nenin 28 të këtij ligji, kurse me programin e planit përfshihen sipërfaqe të reja bujqësore, veprohet në pajtim me nenin 27 të këtij ligji.

(7) Kërkesë për miratimin e dokumentacionin të planit urbanistik lokal mund të dorëzojnë organet shtetërore, personat fizikë dhe juridikë, të cilëve u është lejuar programi i planit në pajtim me nenin 26 të këtij ligji, në formë elektronike nëpërmjet sistemit të e-urbanizmit. Me kërkesën dorëzohet propozim i dokumentacionit të planit urbanistik lokal me raport pozitiv për revizion profesional.

(8) Nëse komuna, komuna në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, kanë nevojë për përpilim të dokumentacionit të planit urbanistik lokal, vendim për përpilimin e të njëjtit miraton Këshilli i komunës, Këshilli në komunën e Qytetit të Shkupit përkatësisht Këshilli i Qytetit të Shkupit, që nxirret në formë elektronike në sistemin informativ e-urbanizëm.

(9) Pas pranimit të kërkesës për miratimit të dokumentacionit të planit urbanistik lokal, komisioni për urbanizëm i komunës nga neni 23 paragrafi (1) i këtij ligji, zbaton procedurë për prezantim publik dhe anketë publike në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar në nenin 35 të këtij ligji, me ç'rast afati për anketë publike është së paku pesë ditë pune.

(10) Me përjashtim nga paragrafi (9) i këtij neni prezantimi publik dhe anketa publike nuk zbatohen, nëse me dokumentacionin e planit urbanistik lokal parashihet ndërtim i ndërtesave me dedikim G2 (industri e lehtë) në pajtim me standardet dhe normativat për planifikim urbanistik nga neni 68 i këtij ligji.

(11) Nëse pas prezantimit të zbatuar publik dhe anketës publike, dokumentacioni i planit urbanistik lokal pëson ndryshime, parashtuesi i kërkesës për miratimin e të njëjtit, detyrohet të dorëzojë raport pozitiv për revizion profesional të dokumentacionit të planit urbanistik lokal të ndryshuar.

(12) Pas zbatimit të prezantimit publik dhe anketës publike, organi kompetent nga paragrafi (4) i këtij neni, dorëzon kërkesë për mendim në formë elektronike te Agjencia për Kadastër të Patundshmërive. Agjencia për Kadastër të Patundshmërive detyrohet të japë mendim për gjendjen e përcaktuar pas zbatimit të kryer të të dhënave nga dokumentacioni i planit urbanistik me të dhënat nga plani i kadastrës, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, në afat prej pesë ditësh pune nga pranimi i kërkesës, e në të kundërtën do të konsiderohet se nuk ka vërejtje dhe se është dhënë mendim pozitiv, do të jenë në ngarkim të Agjencisë për Kadastër të Patundshmërive.

(13) Pas zbatimit të veprimeve nga paragrafët (9) dhe (12) të këtij neni, komisioni për urbanizëm i komunës përkatësisht komunës së Qytetit të Shkupit nga neni 23 paragrafi (1) i këtij ligji, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, dorëzon propozim te kryetari i komunës përkatësisht të komunës në Qytetin e Shkupit, për miratimin ose refuzimin e kërkesës për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik lokal, që në bazë të propozimit të dorëzuar, miraton aktvendim me të cilin e miraton dokumentacionin e planit urbanistik lokal ose e refuzon kërkesën për miratimin e të njëjtit.

(14) Nëse kryetari i komunës përkatësisht komunës së Qytetit të Shkupit, në afat prej 10 ditësh pune nga pranimi i propozimit nga paragrafi (13) të këtij neni nuk miraton aktvendim për miratimin ose refuzimin e kërkesës, komisioni për urbanizëm i komunës detyrohet të dorëzojë propozim për miratimin e dokumentacionit planit urbanistik lokal te kryetari i Këshillit të komunës përkatësisht Këshillit të komunës në Qytetin e Shkupit, i cili është i obliguar që propozimin të vendosë në mbledhjen e parë të ardhshme të Këshillit kurse Këshilli të vendosë për të njëjtin në mbledhjen e njëjtë.

(15) Për dokumentacionin e planit urbanistik lokal të miratuar dorëzohet njoftim në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm dhe Agjencia për Kadastër të Patundshmërive.

(16) Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive detyrohet në afat prej tetë ditësh pune nga pranimi i njoftimit në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik lokal të kryejë paraqitje digjitale të dokumentacionit të planit urbanistik.

(17) Dokumentacioni i planit urbanistik lokal zbatohet pas miratimit të tij edhe pas plotësimit të kushteve nga paragrafët (15) dhe (16) të këtij neni.

(18) Shpenzimet për paraqitje digjitale si dhe për zbatimin e anketës publike dhe prezantimit publik janë në llogari të parashtruesit të kërkesës për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik lokal.

3. Dokumentacioni i planit urbanistik shtetëror

Neni 47

(1) Dokumentacioni i planit urbanistik shtetëror është dokumentacion i planit me të cilin mund të kryhet rregullimi dhe shfrytëzimi i hapësirës me përcaktimin e parcelës ndërtimore jashtë përfshirjes së planit, për ndërtesa nga kategoria e parë të përcaktuara me Ligjin për ndërtim dhe me të cilën mund të kryhet rregullimi dhe shfrytëzimi i hapësirës me përcaktimin e parcelës ndërtimore e cila përfshin rajon të dy ose më shumë komunave, jashtë përfshirjes së planit.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, për zona teknologjike zhvillimore industriale, me dokumentacion të planit urbanistik shtetëror mund të kryhet rregullimi dhe shfrytëzimi i hapësirës, me përcaktimin e më shumë parcelave ndërtimore në suaza të zonës.

(3) Dokumentacioni i planit urbanistik shtetëror miratohet nga ana organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(4) Dokumentacioni i planit urbanistik shtetëror përpilohet në bazë të kushteve për planifikim të hapësirës kurse gjatë përpilimit të dokumentacionit të planit urbanistik shtetëror, zbatohet procedura për mbledhjen e të dhënave dhe informatave në nenin 32 të këtij ligji.

(5) Para përpilimit të dokumentacionit të planit urbanistik shtetëror, zbatohet procedurë e përpilimit përkatësisht miratimin e programit të planit, të përcaktuar në nenin 26 të këtij ligji, veprohet në pajtim me nenin 28 të këtij ligji, kurse nëse me programin e planit përfshihen sipërfaqe të reja bujqësore, veprohet në pajtim me nenin 27 të këtij ligji.

(6) Kërkesë për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik shtetëror mund të dorëzojnë organet shtetërore, komunat, komunat e Qytetit të Shkupit, Qyteti i Shkupit si dhe personat juridikë dhe fizikë të interesuar, të cilëve u është miratuar programi i planit në pajtim me nenin 26 të këtij ligji, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm. Me kërkesën dorëzohet propozim i dokumentacionit të planit urbanistik shtetëror me raport pozitiv për revizion profesional.

(7) Pas pranimit të kërkesës për miratimit të dokumentacionit të planit urbanistik shtetëror, komisioni për urbanizëm i organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës nga neni 23 paragrafi (3) të këtij ligji, zbaton procedurë për prezantim publik dhe anketë publike në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji, me ç'rast afati për anketën publike është së paku pesë ditë pune.

(8) Anketën publike dhe prezantimin publik për dokumentacionin e planit urbanistik shtetëror përpilimi i të cilit është paraparë me programin vjetor për financim të përpilimit të planeve urbanistike, planeve rregulluese të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacionit të projektit urbanistik nga neni 22 paragrafi (2) të këtij ligji, komisioni e zbaton në bashkëpunim me Agjencinë për Planifikim të Hapësirës, kurse për dokumentacionin e planit urbanistik për nevojat e organit shtetëror, komunave, komunave në Qytetin e Shkupit, Qytetin e Shkupit, personave fizikë dhe juridikë, e zbaton në bashkëpunim me përpiluesin e të njëjtit.

(9) Nëse pas prezantimit të zbatuar publik dhe anketës publike, dokumentacioni i planit urbanistik shtetëror pëson ndryshime, parashtruesi i kërkesës për miratimin e të njëjtit, detyrohet të dorëzojë raport pozitiv për revizion profesional të dokumentacionit të planit urbanistik shtetëror të ndryshuar.

(10) Pas zbatimit të prezantimit publik dhe anketës publike, organi kompetent nga paragrafi (3) i këtij neni dorëzon kërkesë për mendim në formë elektronike te Agjencia për Kadastër të Patundshmërive. Agjencia për Kadastër të Patundshmërive detyrohet të japë mendim për gjendjen e përcaktuar pas krahasimit të kryer të të dhënave nga dokumentacioni i planit urbanistik me të dhënat nga plani i kadastrës, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, në afat prej pesë ditësh pune nga pranimi i kërkesës kurse në të kundërtën do të llogaritet se nuk ka vërejtje dhe se është dhënë mendim pozitiv, me ç'rast dëmet e ardhshme eventuale do të jenë në ngarkim të Agjencisë për kadastër të Patundshmërive.

(11) Pas zbatimit të veprimeve nga paragrafët (7) dhe (10) të këtij neni, komisioni për urbanizëm i organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës nga neni 23 paragrafi (3) të këtij ligji, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, dorëzon propozim te ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, për miratimin apo refuzimin e kërkesës për miratim të dokumentacionit të planit urbanistik shtetëror, i cili në bazë të propozimit të dorëzuar, në afat prej 10 ditësh pune miraton aktvendim me të cilin e miraton dokumentacionin e planit urbanistik shtetëror ose e refuzon kërkesën për miratimin e të njëjtit, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(12) Për dokumentacionin e planit urbanistik shtetëror të miratuar dorëzohet njoftim në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizmit te komuna në rajonin e së cilës është përfshirja e planit të dokumentacionit të planit urbanistik shtetëror, Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm dhe Agjencia për Kadastër të Patundshmërive.

(13) Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive detyrohet në afat prej tetë ditësh pune nga pranimi i njoftimit në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm për miratimin e dokumentacionin e planit urbanistik shtetëror të kryejë paraqitje digjitale të dokumentacionit të planit urbanistik.

(14) Dokumentacioni i planit urbanistik shtetëror zbatohet pas miratimit të tij dhe pas plotësimit të kushteve nga paragrafët (12) dhe (13) të këtij neni.

(15) Shpenzimet për paraqitje digjitale si dhe për zbatimin e anketës publike dhe prezantimit publik janë në llogari të parashtruesit të kërkesës për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik shtetëror.

4. Dokumentacioni i planit urbanistik për zonë turistike zhvillimore

Neni 48

(1) Dokumentacioni i planit urbanistik për zonë turistike zhvillimore është dokumentacion i planit me të cilin mund të kryhet rregullimi dhe shfrytëzimi i hapësirës me përcaktimin e një ose më shumë parcelave ndërtimore, në përfshirjen e planit dhe jashtë përfshirjes së planit, për formimin e zonës turistike zhvillimore.

(2) Me dokumentacionin e planit urbanistik për zonë turistike zhvillimore mund të planifikohen vetëm ndërtesa me dedikim A4 (vendosje e përkohshme), B1 (dedikime të vogla komerciale dhe afariste), B2 (njësi të mëdha tregtare), B3 (njësi të mëdha hotelierike), B5 (komplekse hotelierike), B6 (ndërtesa për mbledhje) dhe D3 (sport dhe rekreacion) në pajtim me standardet dhe normativat për planifikim urbanistik nga neni 68 i këtij ligji.

(3) Dokumentacioni i planit urbanistik për zonë turistike zhvillimore përpilohet në bazë të kushteve për planifikim të hapësirës dhe/ose ekstraktit nga plani urbanistik nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji.

(4) Kërkesë për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik për zonë turistike zhvillimore, mund të dorëzojnë organet shtetërore, si dhe persona fizikë dhe juridikë të interesuar, të cilëve u është miratuar programi i planit në pajtim me nenin 26 të këtij ligji, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(5) Dokumentacioni i planit urbanistik për zonë turistike zhvillimore miratohet në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik.

(6) Për dokumentacionin e planit urbanistik për zonë turistike zhvillimore të miratuar dorëzohet njoftim në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm te komuna në rajonin e së cilës është përfshirja e planit e dokumentacionit të planit urbanistik, Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm dhe Agjencia për Kadastrë të Patundshmërive.

(7) Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive detyrohet në afat prej tetë ditësh pune nga pranimi i njoftimit në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik për zonë turistike zhvillimore të kryejë paraqitje digjitale të dokumentacionit të planit urbanistik.

(8) Dokumentacioni i planit urbanistik për zonë turistike zhvillimore zbatohet pas miratimit të tij edhe pas plotësimit të kushteve nga paragrafët (6) dhe (7) të këtij neni.

(9) Shpenzimet për paraqitje digjitale si dhe për zbatimin e anketës publike dhe prezantimit publik janë në llogari të parashtruesit të kërkesës për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik për zonë turistike zhvillimore.

5. Dokumentacioni i planit urbanistik për autokamp

Neni 49

(1) Dokumentacioni i planit urbanistik për autokamp është dokumentacion i planit me të cilin mund të kryhet rregullimi dhe shfrytëzimi i hapësirës me përcaktimin e një ose më shumë parcelave ndërtimore, në përfshirjen e planit dhe jashtë përfshirjes së planit, për formimin e autokampit.

(2) Me dokumentacionin e planit urbanistik për autokamp, hapësira për kampim duhet të parashihet në së paku 70% nga përfshirja e planit, kurse në hapësirën tjetër mund të planifikohen vetëm ndërtesa me dedikim A4 (vendosje e përkohshme), B1 (dedikime të vogla

komerciale dhe afarise), B2 (njësi të mëdha tregtare), B3 (njësi të mëdha hotelierike), B5 (komplekse hotelierike), B6 (ndërtesa për mbledhje) dhe D3 (sport dhe rekreacion) në pajtim me standardet dhe normativat për planifikim urbanistik nga neni 68 i këtij ligji.

(3) Dokumentacioni i planit urbanistik për autokamp përpilohet në bazë të kushteve për planifikim të hapësirës dhe/ose ekstraktit nga plani urbanistik nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji.

(4) Kërkesë për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik për autokamp, mund të dorëzojnë organet shtetërore, si dhe persona fizikë dhe juridikë të interesuar, të cilëve u është miratuar programi i planit në pajtim me nenin 26 të këtij ligji, në formë elektronike nëpërmjet sistemit e-urbanizëm.

(5) Dokumentacioni i planit urbanistik për autokamp miratohet në mënyrë dhe procedurë përcaktuar për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik.

(6) Për dokumentacionin e planit urbanistik për autokamp të miratuar dorëzohet njoftim në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm te komuna në rajonin e së cilës është përfshirja e planit të dokumentacionit të planit urbanistik, Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm dhe Agjencia për Kadastrë të Patundshmërive.

(7) Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive detyrohet që në afat prej tetë ditësh pune nga pranimi i kërkesës në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm për miratimin e dokumentacionin e planit urbanistik për autokamp të kryejë paraqitje digjitale të dokumentacionit të planit urbanistik.

(8) Dokumentacioni i planit urbanistik për autokamp zbatohet pas miratimit të tij edhe pas plotësimit të kushteve nga paragrafët (6) dhe (7) të këtij neni.

(9) Shpenzimet për paraqitje digjitale si dhe për zbatimin e anketës publike dhe prezantimit publik janë në llogari të parashtruesit të kërkesës për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik për autokamp.

6. Dokumentacioni i planit urbanistik për ndërtime me interes të veçantë

Neni 50

(1) Dokumentacioni i planit urbanistik për ndërtesa me interes të veçantë është dokumentacion i planit me të cilin mund të kryhet rregullimi dhe shfrytëzimi i hapësirës me përcaktimin e një ose më shumë parcelave ndërtimore, në përfshirjen e planit dhe jashtë përfshirjes së planit, për ndërtim të ndërtesave me interes të veçantë.

(2) Ndërtesë me interes të veçantë për të cilën do të përpilohet dokumentacioni i planit urbanistik nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohet me Vendim nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

(3) Dokumentacioni i planit urbanistik për ndërtesa me interes të veçantë përpilohet në bazë të kushteve për planifikim të hapësirës dhe/ose ekstraktit nga plani urbanistik nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 e këtij ligji.

(4) Kërkesë për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik për ndërtesa me interes të veçantë, mund të dorëzohet vetëm nëse është miratuar vendim nga paragrafi (2) i këtij neni, me ç'rast dorëzohet në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(5) Dokumentacioni i planit urbanistik për ndërtime me interes të veçantë miratohet në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik shtetëror.

(6) Në procedurë për miratimin e dokumentacionin e planit urbanistik për ndërtesa me interes të veçantë nuk zbatohet prezantim publik dhe anketë publike, si dhe në procedurën nga neni 28 i këtij ligji.

(7) Për dokumentacionin e planit urbanistik për ndërtesa me interes të veçantë të miratuar dorëzohet njoftim në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ

e-urbanizëm te komuna në rajonin e së cilës është përfshirja e planit të dokumentacionit të planit urbanistik, Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm dhe Agjencia për Kadastrë të Patundshmërive.

(8) Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive detyrohet në afat prej tetë ditësh pune nga pranimi i njoftimit në formë elektronike nëpërmjet sistemit informtiv e-urbanizëm për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik për ndërtime me interes të veçantë të kryejë paraqitje digjitale të dokumentacionit të planit urbanistik.

(9) Dokumentacioni i planit urbanistik për ndërtesa me interes të veçantë zbatohet pas miratimit të saj dhe pas plotësimit të kushteve nga paragrafët (7) dhe (8) të këtij neni.

(10) Shpenzimet për paraqitje digjitale janë në llogari të parashtruesit të kërkesës për miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik për ndërtesa me interes të veçantë.

VIII. DOKUMENTACION I PROJEKTIT URBANISTIK

1. Projekti arkitektonik urbanistik

Neni 51

(1) Projekti arkitektonik urbanistik është dokumentacion i projektit urbanistik që përpunohet në bazë të planeve urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 alinetë 2, 3 dhe 4 të këtij ligji dhe dokumentacionit të planit urbanistik nga neni 7 paragrafi (2) i këtij ligji, kur në një parcelë ndërtimore në planin urbanistik përkatësisht dokumentacionin e planit urbanistik është përcaktuar hapësirë me vija ndërtimore në të cilën është lejuar vendosje e sipërfaqeve për ndërtim të më shumë ndërtimeve në pajtim me përqindjen e ndërtimit të tokës të caktuar me standardet dhe normat për planifikim hapësinor nga neni 68 i këtij ligji dhe i cili përpunohet për shkak të formimit të parcelave ndërtimore gjatë përpunimit të planit detal urbanistik, planit urbanistik për fshat, planit urbanistik për vendbanim periferik, dokumentacionit të planit urbanistik dhe akteve të përgjithshme nga neni 84 i këtij ligji.

(2) Me një projekt arkitektonik urbanistik mund të formohen parcela të veçanta ndërtimore me aktvendim urbanistik për çdo parcelë ndërtimore veçanërisht në rastet në vijim:

- kur në plan detal urbanistik është formuar parcelë ndërtimore me sipërfaqe prej minimum pesë hektarëve në të cilën është paraparë ndërtim i ndërtimeve me dedikim për A (banim) në pajtim me standardet dhe normat për planifikim hapësinor nga neni 68 i këtij ligji dhe

- kur në plan detal urbanistik, dokumentacion të planit shtetëror urbanistik, dokumentacion të planit lokal urbanistik dhe dokumentacion të planit urbanistik për ndërtime me interes të veçantë është formuar parcelë ndërtimore me sipërfaqe prej minimum 10 hektarësh në të cilën është paraparë ndërtim i ndërtimeve me dedikim B1 (arsim dhe shkencë) në pajtim me standardet dhe normat për planifikim urbanistik nga neni 68 i këtij ligji.

(3) Me një ose më shumë projekte arkitektonike urbanistike mund të formohen parcela të veçanta ndërtimore me aktvendim urbanistik për çdo parcelë ndërtimore veçanërisht në rastet në vijim:

- kur në një parcelë ndërtimore në planin detal urbanistik dhe dokumentacionin e planit urbanistik është paraparë ndërtim i ndërtimeve me dedikim për G (prodhimtari, distribuim dhe servise), në pajtim me standarde dhe normat për planifikim urbanistik nga neni 68 i këtij ligji;

- kur në një parcelë ndërtimore në planin detal urbanistik dhe dokumentacionin e planit urbanistik është paraparë ndërtim i ndërtimeve me dedikim D3 (sport dhe rekreacion), në pajtim me standarde dhe normat për planifikim urbanistik nga neni 68 i këtij ligji;

- kur rregullohet hapësirë me dokumentacion shtetëror të planit urbanistik për zonat zhvillimore teknologjike industriale;

- kur rregullohet hapësirë me dokumentacionin e planit urbanistik për zonë zhvillimore teknologjike, dokumentacionin e planit urbanistik për autokamp dhe dokumentacionin e planit urbanistik për ndërtime me interes të veçantë;

- gjatë përpunimit të planit urbanistik për fshat në rastet kur parcela ndërtimore përbëhet prej dy ose më shumë parcelave kadastrale ose kur në suazat e një parcele kadastrale formohen dy ose më shumë parcela ndërtimore ose kur në një parcelë kadastrale parashihen dy ose më shumë ndërtime;

- gjatë përpunimit të planit urbanistik për vendbanim periferik në rastet kur parcela ndërtimore përbëhet prej dy ose më shumë parcelave kadastrale ose kur në suazat e një parcele kadastrale formohen dy ose më shumë parcela ndërtimore ose kur në një parcelë kadastrale parashihen dy ose më shumë ndërtime dhe

- gjatë përpunimit të akteve të përgjithshme të nenit 84 të këtij ligji, në rastet kur parcela ndërtimore përbëhet prej dy ose më shumë parcelave kadastrale ose kur në suazat e një parcele kadastrale formohen dy ose më shumë parcela ndërtimore ose kur në një parcelë kadastrale parashihen dy ose më shumë ndërtime.

(4) Me një ose më shumë projekte arkitektonike urbanistike mund të bëhet riparcializim, ridedikim (parashikim i dedikimeve që janë përcaktuar me dokumentacionin ekzistues të planit urbanistik shtetëror si dhe dedikime që nuk janë përcaktuar me dokumentacionin ekzistues të planit urbanistik shtetëror) dhe formim i parcelave të reja ndërtimore, në kuadër të zonës teknologjike zhvillimore industriale dhe në kuadër të zonës ndërtimore të formuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në të cilat me dokumentacionin e planit urbanistik shtetëror paraprakisht janë përcaktuar parcela ndërtimore, si dhe ndryshim i trasesë dhe zhvendosja e pikave të lidhjeve infrastruktururore në kuadër të zonave të përmendura të cilat paraprakisht janë përcaktuar me dokumentacionin e planit shtetëror urbanistik.

(5) Gjatë përpunimit të projektit arkitektonik urbanistik aplikohen standardet dhe normat për planifikim urbanistik të nenit 68 të këtij ligji, kurse i njëjti përmban aktvendim për parcelën ndërtimore, sipërfaqe për ndërtim me vija ndërtimore, dedikim të ndërtimeve, lartësi maksimale të ndërtimeve të paraqitur në metra deri në rreth, infrastrukturë të brendshme rrugore dhe të dhëna tjera të caktuara me dispozitën nga paragrafi (14) i këtij neni.

(6) Projektin arkitektonik urbanistik e përpunon person juridik i cili ka licencë për përpunimin e planeve urbanistike të lëshuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji kurse përpunimin e tij e financon kërkuksi.

(7) Projektin arkitektonik urbanistik në të cilin janë përcaktuar sipërfaqet për ndërtim të ndërtimeve të kategorisë së dytë në pajtim me Ligjin për ndërtim dhe me të cilin bëhet përpunim i planit urbanistik për fshat, planit urbanistik për vendbanim periferik, dokumentacionit të planit lokal urbanistik dhe aktit të përgjithshëm të nenit 84 të këtij ligji, e miraton kryetari i komunës përkatësisht komunës në Qytetin e Shkupit, kurse projektin arkitektonik urbanistik në të cilin janë përcaktuar sipërfaqe për ndërtim të ndërtimeve të kategorisë së parë në pajtim me Ligjin për ndërtim, i cili është përpunuar në bazë të dokumentacionit të planit urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik për zonë turistike zhvillimore, dokumentacionit të planit urbanistik për autokamp dhe dokumentacionit të planit urbanistik për ndërtime me interes të veçantë si dhe në rastet nga paragrafi (4) i këtij neni, e miraton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e rregullimit të hapësirës.

(8) Projektet arkitektonik urbanistik dhe kërkesa për miratimin e tij parashtrihen në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(9) Pas pranimit të kërkesës për miratim të projektit arkitektonik urbanistik me të cilin formohen parcela ndërtimore, organi kompetent nga paragrafi (7) i këtij neni parashtron kërkesë për mendim në formë elektronike në Agjencinë për Kadastër të Patundshmërive. Agjencia për Kadastër të Patundshmërive është e obliguar të japë mendim për gjendjen e konstatuar pas krahasimit të të dhënave nga projekti me të dhënat nga plani i kadastrës, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, në afat prej pesë ditëve të punës nga pranimi i kërkesës, kurse në të kundërtën do të konsiderohet se nuk ka vërejtje dhe se është dhënë mendim pozitiv, me ç'rast dëmet eventuale të ardhshme për shkak të mosveprimit, do të jenë në barë të Agjencisë për Kadastër të Patundshmërive.

(10) Në rastet kur me projektin arkitektonik urbanistik përpunohet plan urbanistik për fshat, plan urbanistik për vendbanim periferik dhe akt i përgjithshëm nga neni 84 i këtij ligji, organi kompetent nga paragrafi (7) i këtij ligji, pas pranimit të kërkesës për miratim, është i obliguar të zbatojë procedurë për sondazh publik dhe prezantim publik të projektit arkitektonik urbanistik në mënyrë dhe në procedurë të caktuara në nenin 35 të këtij ligji, me ç'rast sondazhi publik zgjat më pak se pesë ditë pune.

(11) Organi kompetent nga paragrafi (7) i këtij neni është i obliguar në afat prej 10 ditëve të punës nga dita e pranimit të kërkesës për miratim të projektit arkitektonik urbanistik të konstatojë nëse projekti arkitektonik urbanistik është përpunuar në pajtim me standardet dhe normat për planifikim urbanistik nga neni 68 i këtij ligji, me ç'rast është i detyruar të miratojë projektin me vërtetim për verifikim në formë elektronike ose të dërgojë njoftim për mangësi të konstatuara, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(12) Pas miratimit të projektit arkitektonik me të cilin formohen parcela ndërtimore, ekzemplar i tij dërgohet në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm në Agjencinë për Kadastër të Patundshmërive, që është e obliguar të bëjë harmonizim digjital në afat prej tetë ditëve të punës nga pranimi i projektit.

(13) Projektet arkitektonik urbanistik me të cilin formohen parcela ndërtimore përdoret pas miratimit të tij dhe pas përmbushjes së obligimit nga paragrafi (12) i këtij neni.

(14) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e përpunimit të projektit arkitektonik urbanistik e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e rregullimit të hapësirës.

2. Projektet për infrastrukturë

Neni 52

(1) Projektet për infrastrukturë është dokumentacion i projektit urbanistik që përpunohet për ndërtim infrastrukturor në linjë të formuara në më shumë pjesë prej të cilave së paku një pjesë paraqet infrastrukturë në linjë, në rastet kur traseja e objektit infrastrukturor në linjë nuk është përcaktuar në planin urbanistik të nenit 7 pikës 2 të këtij ligji.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni projektet për infrastrukturë mund të përpunohet edhe nëse traseja e objektit infrastrukturor në linjë është përcaktuar në planin urbanistik nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji, përkatësisht dokumentacionit të planit urbanistik nga neni 7 paragrafi (2) të këtij ligji nëse me dispozitat e planit urbanistik përkatësisht dokumentacionit të planit urbanistik parashihet përpunim i projektit për infrastrukturë ose është miratuar vendim në Këshillin e komunës, komunën e Qytetit të Shkupit dhe Qytetin e Shkupit të përpunohet projekt i tillë, si dhe në rastet kur nevojitet të ndryshohet

traseja dhe/ose pika lidhëse e objektit infrastrukturor në linjë, që janë përcaktuar në dokumentacion të planit urbanistik për zonën zhvillimore industriale teknologjike dhe për zonën industriale të formuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në dhe jashtë zonës.

(3) Projektet për infrastrukturë përpunohet në bazë të kushteve për planifikim të hapësirës ose ekzemplar i planeve urbanistike ose ekzemplar i dokumentacionit të planit urbanistik me ç'rast i njëjti përmban aktvendim teknik për infrastrukturë me gjitha elementet e veta (pusetë, pusët, stacione për matje, mure mbështetëse, viadukte, lëshime, mbikalime, nënkalime, tunele, udhëkryqe të mëdha dhe tjera) në pjesën tekstuale dhe shtojca grafike dhe e paraqet trasenë e infrastrukturës dhe të dhëna tjera të caktuara me dispozitën nga paragrafi (13) i këtij neni.

(4) Me projektin për infrastrukturë përpunohet për objekte infrastrukturorë të formuara nga më shumë pjesë prej të cilave së paku një pjesë paraqet infrastrukturë në linjë krahas trasës së infrastrukturës përcaktohen edhe sipërfaqet për ndërtim të pjesëve të objektit me të cilat objekti infrastrukturor paraqet tërësi ndërtimore dhe funksionale.

(5) Projektet për infrastrukturë përmban edhe studim për vlerësim të ndikimit të projektit mbi mjedisin jetësor, përkatësisht elaborat për mbrojtjen e mjedisit jetësor të miratuar nga organi kompetent, nëse me dispozitat nga fusha e mjedisit jetësor është paraparë përpunim i studimit, përkatësisht elaborat për atë lloj infrastrukturë dhe për intervenimin e njëjtë paraprakisht nga organi kompetent nuk janë miratuar studim për vlerësim të ndikimit të projektit mbi mjedisin jetësor ose elaborat për mbrojtjen e mjedisit jetësor gjatë miratimit të planit urbanistik përkatësisht të dokumentacionit të planit urbanistik.

(6) Projektin për infrastrukturë e përpunon person juridik i cili është bartës i licencës së lëshuar në pajtim me këtë ligj, për përpunim të planeve urbanistike ose person juridik i cili është bartës i licencës për përpunim të dokumentacionit të projektit që është lëshuar në pajtim me Ligjin për ndërtim dhe në të bëhet revizion profesional në pajtim me nenin 37 të këtij ligji.

(7) Projektet për infrastrukturë me raport pozitiv për revizion profesional, për ndërtim infrastrukturor në linjë të kategorisë së parë në pajtim me Ligjin për ndërtim, me kërkesë për miratim parashtrihet te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e rregullimit të hapësirës, për ndërtim vijore infrastrukturorë të kategorisë së dytë në pajtim me Ligjin për ndërtim në komunën në zonën e të cilës parashihet objekt infrastrukturor, kurse për ndërtim vijore infrastrukturorë për të cilat në pajtim me Ligjin për ndërtim, leje për ndërtim jep Qyteti i Shkupit, parashtrihet në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(8) Pas pranimit të kërkesës për miratim të projektit për infrastrukturë, organi kompetent nga paragrafi (7) i këtij neni, menjëherë parashtron kërkesë për mendim në formë elektronike në Agjencinë për Kadastër të Patundshmërive. Agjencia për Kadastër të Patundshmërive është e obliguar të japë mendim për gjendjen e konstatuar pas krahasimit të të dhënave nga projekti me të dhënat nga plani i kadastrës, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm, në afat prej pesë ditëve të punës nga pranimi i kërkesës, kurse në të kundërtën do të konsiderohet se nuk ka vërejtje dhe se është dhënë mendim pozitiv, me ç'rast dëmet eventuale të ardhshme për shkak të mosveprimit, do të jenë në barë të Agjencisë për Kadastër të Patundshmërive.

(9) Nëse me projektin për infrastrukturë përfshihen sipërfaqe të reja bujqësore, organi kompetent para miratimit të projektit për infrastrukturë vepron në pajtim me nenin 27 paragrafin (1) të këtij ligji.

(10) Organi kompetent nga paragrafi (7) i këtij neni te i cili është parashtruar projekti për infrastrukturë është i obliguar në afat prej 10 ditëve të punës nga dita e pranimit

të kërkesës të konstatohet nëse projekti është përpunuar në pajtim me standardet për projektim dhe standardet dhe normat për planifikim urbanistik të nenit 68 të këtij ligji, pas çka është i obliguar të miratohet projekti me vërtetim për verifikim në formë elektronike ose të dërgojë njoftim për mangësi të konstatuara.

(11) Pas miratimit të projektit për infrastrukturë, ekzemplar i të njëjtit dërgohet në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm në Agjencinë për Kadastër të Patundshmërive, që është e obliguar të bëjë harmonizim digjital në afat prej tetë ditëve të punës nga pranimi i projektit.

(12) Projekti për infrastrukturë përdoret pas miratimit të tij dhe pas përbushjes së obligimit nga paragrafi (11) i këtij neni.

(13) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e përpunimit të projektit për infrastrukturë e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e rregullimit të hapësirës.

IX. ZBATIMI I PLANEVE URBANISTIKE DHE DOKUMENTACIONIT TË PLANIT URBANISTIK

1. Ekstrakti i Planit hapësinor, planit urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik dhe projektit arkitektonik urbanistik

Neni 53

(1) Për shqyrtimin e mundësive të planit për rregullim të hapësirës konkrete, çdo person juridik dhe fizik mund të marrë ekstrakt të Planit hapësinor, planit urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik si dhe të projektit arkitektonik urbanistik me të cilin është formuar parcelë ndërtimore, pas kërkesës së parashtruar në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose me shkrim.

(2) Ekstrakti nga Plani hapësinor i Republikës së Maqedonisë përmban kopje të pjesës grafike të Planit hapësinor të Republikës së Maqedonisë, që ka të bëjë me pjesë të territorit të Republikës së Maqedonisë dhe përshkrim të kushteve më të përafërta të hapësirës për shkak të përpunimit të projektit të infrastrukturës.

(3) Ekstrakti i planit të përgjithshëm urbanistik përmban kopje të shtojcës grafike (plan sintenzor) dhe kopje të pjesës tekstuale (kushte të përgjithshme dhe të veçanta për zhvillim hapësinor, parametra për zbatimin e planit, kushteve të planit për planifikim detal të hapësirës, masat për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, natyrës dhe mjedisit jetësor dhe masave për mbrojtje nga rrënimin dhe tjera), për hapësirë konkrete që është pjesë e planit të përgjithshëm urbanistik.

(4) Ekstrakti i planit detal urbanistik, planit urbanistik për fshat, planit urbanistik për vendbanim periferik, dokumentacionit të planit urbanistik dhe projektit arkitektonik urbanistik me të cilin është formuar parcelë ndërtimore, përmban kopje të shtojcës grafike (plan sintenzor) dhe kopje të pjesës tekstuale (kushte të përgjithshme dhe të veçanta për ndërtim) në të cilën janë paraqitur parametrat urbanistikë për parcelën konkrete, masa për mbrojtje të trashëgimisë kulturore sipas bazave konservatoro-mbrojtëse nëse në parcelën konkrete ndërtimore ekziston trashëgimi i patundshme kulturore, si dhe të dhëna për infrastrukturën dhe instalimet ekzistuese (ujësjellës, kanalizim, lidhje elektrike, kurse nëse ka edhe lidhje për gazpërçues dhe përçues termal).

(5) Kërkesa për marrje të Ekstraktit të planit hapësinor parashtrohet në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e planifikimit hapësinor, për marrje të Ekstraktit të planeve urbanistike nga paragrafi (3) dhe (4) të këtij neni, në komunën, komunën në Qytetin e Shkupit përkatësisht Qytetin e Shkupit, kurse për marrje të Ekstraktit të dokumentacionit të planit urbanistik dhe projektit

arkitektonik urbanistik, kërkesa parashtrohet te organi kompetent që ka miratuar këtë dokumentacion. Parashtrues i kërkesës për marrje të Ekstraktit të planit urbanistik, përkatësisht dokumentacionit të planit urbanistik për ndërtime me klasë bazike të dedikimit G2 (industri e lehtë), dedikim G3 (servise) dhe dedikim G4 (depo), në pajtim me standardet dhe normat për planifikim urbanistik të nenit 68 të këtij ligji, në emër të investitorit, mund të jetë edhe shoqëria tregtare për punë gjeodezike.

(6) Organi kompetent nga paragrafi (5) i këtij neni, te i cili është parashtruar kërkesa për marrje të Ekstraktit të Planit hapësinor, planit urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik dhe projektit arkitektonik urbanistik, është i obliguar në afat prej pesë ditëve të punës, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose me shkrim, varësisht nga mënyra se si është parashtruar kërkesa, të lëshojë Ekstraktin ose të dërgojë njoftim se për intervenimin në fjalë nuk është miratuar plan urbanistik, dokumentacioni i planit urbanistik përkatësisht projekt arkitektonik urbanistik.

(7) Organi kompetent nga paragrafi (5) i këtij neni është i obliguar nga plani urbanistik përkatësisht dokumentacioni i planit urbanistik, ta lëshojë edhe nëse plani urbanistik nuk përmban disa nga parametrat dhe të dhënat theksuara në paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni.

(8) Nëse komuna, komuna në qytetin Shkup përkatësisht qyteti Shkup, në afatin e përcaktuar në paragrafin (6) të këtij neni nuk lëshon certifikatë nga plani urbanistik përkatësisht dokumentacioni i planit urbanistik, certifikatën mund ta lëshojë organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve të rregullimit të hapësirës, pas kërkesës së parashtruar nga personi fizik dhe juridik te i cili dorëzohet kërkesa e dorëzuar te komuna, komuna e qytetit Shkup përkatësisht qyteti Shkup.

(9) Me përjashtim nga paragrafi (5) i këtij neni Agjencia për Planifikim të Hapësirës mund të lëshojë certifikatë nga plani urbanistik përkatësisht dokumentacioni i planit urbanistik pas kërkesës së parashtruar nga organi shtetëror, agjencia ose fondi i themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe persona juridikë në pronësi dominante ose të tërësishme të Republikës së Maqedonisë, kurse Drejtoria për Zona Zhvillimore Industriale Teknologjike mund të lëshojë certifikatë nga dokumentacioni i planit urbanistik shtetëror për zona zhvillimore industriale teknologjike.

(10) Formën dhe përmbajtjen e ekstraktit nga Plani i hapësinor e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore për kryerjen e punëve nga sfera planifikimit hapësinor.

(11) Formën dhe përmbajtjen e ekstraktit nga planet nga paragrafët (3) dhe (4) i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

X. AGJENCIA PËR PLANIFIKIM TË HAPËSIRËS

Neni 54

Agjencia për Planifikim të Hapësirës e zbaton politikën e planifikimit dhe rregullimin e hapësirës në Republikë (në tekstin e më poshtëm: Agjencia).

Neni 55

(1) Agjencia ka cilësi të personit juridik me autorizime publike me të drejta, obligime dhe përgjegjësi të përcaktuara me ligj dhe statut.

(2) Selia e Agjencisë është në Shkup.

(3) Agjencia është pavarur në punën e saj.

1. Punë të cilat i kryen Agjencia

Neni 56

Agjencia i kryen punët në vijim:

- përpunon Plan hapësinor të Republikës;

- e ndjek zbatimin e Planit hapësinor të Republikës;

- e përpunon Planin hapësinor të Republikës,
- përpunon elaborat për kushtet për planifikim të hapësirës;
- e mban dhe azhurnon sistemin e vetëm informativ-hapësinor të të dhënave;
- përpunon plane urbanistike dhe dokumentacion të planit urbanistik;
- i përpunon planet urbanistike, planet rregulluese të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacionin e planit urbanistik dhe dokumentacionin projektues-urbanistik përpunimi i të cilit është përcaktuar në programin vjetor për financim të përpunimit të planeve urbanistike, planeve rregulluese të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacionit projektues urbanistik nga neni 22 paragrafi (2) të këtij ligji;
- përpunon projekte urbanistike arkitektonike dhe projekte për infrastrukturë;
- lëshon ekstrakt të planit urbanistik përkatësisht dokumentacionit të planit urbanistik për kërkesën e parashtruar nga organi shtetëror, agjencia ose fondi të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe personat juridikë në pronësi të plotë ose dominante të Republikës së Maqedonisë;
- përpunon analiza profesionale dhe informacione për gjendjen në planifikim për nevojat e organeve shtetërore dhe organeve të administratës shtetërore dhe
- kryen edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe me Statutin e Agjencisë.

Neni 57

- Puna e Agjencisë bazohet në këto parime:
- kompetencë,
 - profesionalizëm,
 - transparencë dhe
 - përgjegjësi në punë dhe rezultatet e arritura.

2. Të hyrat e Agjencisë

Neni 58

- (1) Mjetet për punën e Agjencisë sigurohen nga mjete personale që realizohen nga puna, nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë për realizimin e programeve vjetore që i miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë për financimin e përpunimit të Planit hapësinor të Republikës dhe planeve urbanistike, planeve rregulluese të planit të përgjithshëm urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik si dhe dokumentacionit të projektit urbanistik, nga donacione dhe burime tjera të përcaktuara me ligj.
- (2) Nëse me punën e Agjencisë realizohen të hyra dhe shpenzime më të mëdha, ato do përdoren për realizimin e aktiviteteve të Agjencisë.

3. Organet e Agjencisë

Neni 59

Organet e Agjencisë janë Këshilli Drejtues dhe drejtori.

Neni 60

- (1) Me Agjencinë menaxhon Këshilli Drejtues që është i përbërë prej shtatë anëtarëve.
- (2) Anëtarët e Këshillit Drejtues të Agjencisë emërohen dhe shkarkohen nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit që udhëheq me organin kompetent të administratës shtetërore për punët nga sfera e planifikimit hapësinor, në pajtim me ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e rregullimit të hapësirës.
- (3) Anëtarët të Këshillit Drejtues emërohen dy përfaqësues nga organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e planifikimit hapësinor, dy përfaqësues të organit të administratës shtetërore

kompetent për kryerje të punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës, dy përfaqësues nga të punësuarit në Agjenci dhe një anëtar nga jashtë.

(4) Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues zgjat katër vite, me mundësi për rizgjedhje.

(5) Anëtarët e Këshillit Drejtues nga radhët e tyre e zgjedhin kryetarin e Këshillit Drejtues në mbledhjen e parë.

Neni 61

- Këshilli Drejtues i Agjencisë i kryen këto punë:
- miraton Statutin e Agjencisë;
 - miraton programin vjetor për punë, planin financiar dhe llogarinë vjetore financiare të Agjencisë;
 - miraton raportin vjetor për punën e Agjencisë;
 - e zgjedh dhe shkarkon drejtorin e Agjencisë;
 - i miraton aktet e përgjithshme për organizimin dhe sistematizimin e punës së Agjencisë dhe
 - kryen punë tjera të përcaktuara me Statutin.

Neni 62

- (1) Me punën e Agjencisë udhëheq drejtori.
- (2) Përzgjedhja e drejtorit bëhet nëpërmjet shpalljes publike, që publikohet në tre gazeta ditore që publikohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilët një prej gazetave publikohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.
- (3) Drejtori i Agjencisë mund të zgjidhet personi që i plotëson kushtet si vijojnë:
- 1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
 - 2) në momentin e zgjedhjes të mos ketë të shquptuar dënim ose sanksion kundërvajtës, ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - 3) të ketë së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të kryer VII/1;
 - 4) të ketë së paku pesë vite përvojë pune dhe tre vite përvojë pune në pozitë udhëheqëse;
 - 5) të posedojë një prej certifikatave të pranura ndërkombëtare si më poshtë ose vërtetime për njohe aktive të gjuhës angleze, jo më të vjetër se 5 vite:
 - TOEFEL IBT së paku 74 pikë;
 - (IELTS) - së paku 6 pikë;
 - (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku nivelin B2;
 - (FCE) (Cambridge English: First) - të kaluar;
 - (BULATS) - së paku 60 pikë;
 - (APTIS) - së paku nivelin B2.
 - 6) të ketë të dhënë testin psikologjik dhe testin e integritetit.
- (4) Mandati i drejtorit zgjat katër vite, me mundësi për rizgjedhje.

Neni 63

- Drejtori i Agjencisë i kryen punët në vijim:
- e përfaqëson dhe prezanton Agjencinë;
 - e organizon punën dhe udhëheq me shërbimet profesionale të Agjencisë;
 - propozon strategjinë dhe planet aksionare të Këshillit Drejtues;
 - i implementon vendimet e Këshillit Drejtues;
 - kujdeset për punën e ligjshme dhe shpenzimin e mjeteve financiare;
 - bën harmonizimin e aktiviteteve të punës së Agjencisë;
 - përpilon programin vjetor për punë dhe planin vjetor financiar për mjetet e nevojshme dhe burimet e tyre;
 - i propozon dhe realizon aktet e përgjithshme për organizimin dhe sistematizimin e punës së Agjencisë;
 - miraton akte të veçanta për të punësuarit nga sfera e marrëdhënieve të punës dhe
 - vendos për çështje tjera të përcaktuara me ligj dhe Statutin e Agjencisë.

Neni 64

(1) Të punësuarit në Agjenci që kryejnë çështje administrative kanë status të nëpunësve administrativë.

(2) Të punësuarit e Agjencisë që kryejnë punë ndihmëse dhe teknike kanë status të personelit ndihmës-teknik.

(3) Për personelin ndihmës-teknik në Agjenci do të zbatohet Ligji për të punësuarit në sektorin publik dhe rregullat e përgjithshme për marrëdhënie të punës.

(4) Mënyra e përcaktimit të pagës bazë dhe shtesave të pagës për të punësuarit në Agjenci si dhe shumën e koeficientit të rrogës bazë e përcakton Agjencia.

3. Aktet e Agjencisë

Neni 65

Agjencia e miraton Statutin, programin vjetor të punës dhe planin vjetor financiar për të cilat jep pëlqim Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Neni 66

Me Statutin e Agjencisë në veçanti rregullohen:

- aktivitetet dhe kompetencat e Agjencisë;
- mënyra e realizimit të aktiviteteve në sferën e Agjencisë;
- të drejtat, kompetencat dhe përgjegjësitë e të punësuarve dhe
- çështje tjera që dalin nga kompetenca e Agjencisë.

5. Raportet vjetore të Agjencisë

Neni 67

(1) Agjencia dorëzon së paku dy herë në vjet raporte për punën e vet dhe shfrytëzimin e mjeteve, te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e planifikimit hapësiror.

(2) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e planifikimit hapësiror, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të raporteve nga paragrafi (1) i këtij neni, ato i dorëzon te Qeveria e Republikës së Maqedonisë për miratim.

XI. DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 68

(1) Planet urbanistike, dokumentacioni i planit-urbanistik, planet rregulluese të planit të përgjithshëm urbanistik dhe dokumentacioni urbanistik-projektues përpilohen në bazë të standardeve dhe normativave për planifikim urbanistik, me të cilat rregullohen bazat për planifikim racional rregullimi dhe shfrytëzimi i hapësirës, për shkak të krijimit të kushteve për jetë humane dhe punë të qytetarëve.

(2) Standardet dhe normativat nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohen nga ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

Neni 69

Planet urbanistike, dokumentacioni i planit urbanistik, planet rregulluese të planit të përgjithshëm urbanistik dhe dokumentacioni urbanistik i projektit përpilohen në formë elektronike, që përcaktohet me rregullën nga neni 15 paragrafi (2) të këtij ligji.

Neni 70

(1) Planet urbanistike, plani rregullativ i planit të përgjithshëm urbanistik, dokumentacioni i planit urbanistik, projekti arkitekturor-urbanistik me të cilin formohen parcelat ndërtimore, projekti për infrastrukturë dhe aktet e përgjithshme nga neni 84 i këtij ligji, përpilohen në sipërfaqe të azhurnuara gjeodezike që përpilohen nga tregtarët individë, gjeodezistë të autorizuar dhe shoqëri tregtare për punë gjeodezike.

(2) Gjatë përpunimit të planit rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik, përpilohen sipërfaqet e azhurnuara gjeodezike vetëm për rrjetin sekondar të qarkullimit.

(3) Me kërkesë të miratuesit ose përpunuesit të planeve urbanistike, planit rregullues të planit të përgjithshëm urbanistik, dokumentacionit të planit urbanistik, projektit arkitekturor-urbanistik me të cilin formohen parcelat shtetërore, projektit për infrastrukturë dhe akteve të përgjithshme nga neni 84 i këtij ligji, Agjencia për Kadastër të Patundshmërive lëshon plane të vërtetuara dhe të digjitalizuara kadastrale.

(4) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni, Agjencia për Kadastër të Patundshmërive, planet që nuk janë digjitalizuar i jep me shkrim deri në digjitalizim e tyre, ndërsa të njëjtat digjitalizohen nga ana e tregtarëve individë, gjeodezistë të autorizuar dhe shoqëri tregtare për punë gjeodezike.

(5) Azhurnimi i vazhdueshëm i sipërfaqeve gjeodezike dhe shpenzimet për azhurnimin e tyre janë obligim i miratuesit të planit.

(6) Për planet urbanistike, plani rregullues i planit të përgjithshëm urbanistik, dokumentacioni i planit urbanistik, dhe dokumentacioni projektues urbanistik, përpilimi i të cilit është paraparë në programin vjetor për financimin e përpunimit të planeve urbanistike, planeve rregulluese dhe planeve të përgjithshme urbanistike, nga neni 22 paragrafi (2) i këtij ligji, Agjencia për Kadastër të Patundshmërive bën azhurnimin e planeve kadastrale, jep plane të digjitalizuara dhe të vërtetuara kadastrale dhe kryen përputhjen e tyre digjitale, pa kompensim.

Neni 71

Të gjitha ndërtimet ekzistuese mbitokësore dhe nëntokësore në kuadër të përfshirjes së planit, evidentohen në sipërfaqe të azhurnuar gjeodezike në bazën e dokumentacionin bazë të planit urbanistik, përkatësisht dokumentacionit të planit urbanistik, kurse në sipërfaqen gjeodezike në bazë të së cilës përpilohet plani i përgjithshëm urbanistik, evidentohet vetëm infrastruktura ekzistuese mbitokësore dhe nëntokësore primare.

Neni 72

(1) Gjatë përpunimit të planeve urbanistike me të cilat rregullohet hapësira për ndërtime, me dedikim për banim, përqindja e ndërtimit të parcelës ndërtuese duhet të jetë 70%, kurse lartësia e ndërtimit e shprehur në metra deri në 10,2 metra. Për ndërtime për banim në njësi banesore, përqindja e ndërtimit duhet të jetë 70%, kurse shumata e ndërtimit, e shprehur në metër për parcelat ndërtimore me sipërfaqe prej 500 deri 1000 m² duhet të jetë së paku 25,2 metër, kurse për parcela ndërtimore me sipërfaqe më të madhe prej 1000 m² duhet të jetë së paku 30 metër. Sipërfaqja e parcelës ndërtimore për ndërtime me dedikim për banim në ndërtesa banesore duhet të jetë së paku 500 m².

(2) Zbatimi i parametrave nga paragrafi (1) i këtij neni, gjatë përpunimit të planeve urbanistike është i kushtëzuar me harmonizimin e tyre me planet e përgjithshme administrative, sigurimin e numrit të nevojshëm të vendeve për parkim në parcelat ndërtimore, si dhe standardet dhe normativat për planifikim urbanistik të përcaktuara me rregullën nga neni 68 i këtij ligji.

Neni 73

(1) Për sipërfaqe të planifikuara në planet e përgjithshme urbanistike, të dedikuara për nevojat e mbrojtjes mund të miratohet plan i detajuar urbanistik dhe dokumentacioni i planit urbanistik pas pëlqimit të marrë paraprak nga Ministria e Mbrojtjes.

(2) Përmbajtja, përdorimi dhe dedikimi i këtyre sipërfaqeve përcaktohet me programin e planit nga neni 26 i këtij ligji.

Neni 74

(1) Kufijtë e planeve urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 alinetë 2, 3 dhe 4 të këtij ligji në përfshirjen e planit të të cilit ka rajon me tërësi monumentale, të shpallur me ligj ose me akt tjetër për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore me rëndësi të veçantë, duhet të jenë në pajtim me kufijtë që janë përcaktuar me ligjin e veçantë me të cilin shpallet tërësi monumentale.

(2) Nëse tërësia monumentale përfshin rajone të dy ose më shumë komunave, plani urbanistik miratohet nga këshillat e komunave në rajonin e të cilëve gjendet tërësia monumentale.

(3) Planin urbanistik nga paragrafi (2) i këtij neni, përpilohet dhe miratohet në procedurë të përcaktuar me këtë ligj, kurse i njëjti do të konsiderohet i miratuar nëse këshillat e komunave në rajonet e të cilëve ka tërësi monumentale, kanë miratuar vendimin me të cilin e kanë miratuar planin urbanistik dhe kanë kryer vërtetimin të tij.

(4) Në rajonin e përfshirë me tërësinë monumentale nuk mund të bëhet rregullimi dhe përdorimi i hapësirës me dokumentacionin shtetëror dhe lokal të planit urbanistik.

Neni 75

Zgjerimi i planit përfshirës të planit të përgjithshëm urbanistik kryhet me miratimin e planit të ri të përgjithshëm urbanistik.

Neni 76

Planin i detajuar urbanistik, i miratuar në pajtim me planin e përgjithshëm urbanistik që është shfuqizuar, mund të zbatohet vetëm nëse dedikimet për planin e detajuar urbanistik janë në pajtim me dedikimet e përcaktuara në planin e ri të përgjithshëm urbanistik.

Neni 77

Nëse gjatë procedurës së miratimit të planit të detajuar urbanistik, miratohet një plan i përgjithshëm urbanistik, procedura e miratimit të planit të detajuar urbanistik, do të vazhdojë vetëm nëse ai është në pajtim me planin e ri të përgjithshëm urbanistik.

Neni 78

Me planin e detajuar urbanistik, lëndë e planifikimit mund të jetë edhe ndryshimi dhe plotësimi i një parcele ndërtimore, nëse plani i detajuar urbanistik që është lëndë e ndryshimit dhe plotësimit, është në pajtim me planin e përgjithshëm urbanistik.

Neni 79

(1) Planin urbanistik dhe dokumentacioni i planit urbanistik me të cilat, lëndë e planifikimit është një parcelë shtetërore për të cilën është marrë pëlqim për ridedikim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, shfuqizohet, nëse nuk kanë siguruar leje për ndërtim dhe nuk kanë filluar me ndërtimin e ndërtimit të planifikuar, në afat prej tre viteve nga miratimi i Vendimit për dhënie të pajtimit për ridedikim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, organi kompetent që e ka miratuar planin urbanistik, përkatësisht ka miratuar dokumentacionin e planit urbanistik, miraton vendim për shfuqizimin e planit urbanistik, përkatësisht vendim për shfuqizimin e dokumentacionit të planit urbanistik, në afat prej tre ditëve deri në dorëzimin e Vendimit për pushimin e Vendimit për dhënie të pëlqimit për ridedikim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore nga organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e bujqësisë.

Neni 80

Nëse me planet urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 alinetë 2, 3 dhe 4 të këtij ligji, nevojitet të rregullohet përfshirja e planit që përfshin një rajon të dy

ose më shumë komunave, çdo komunë mund ta zbatojë në veçanti procedurën e përpilimit të miratimit të planit urbanistik për rajonin që është në kuadër të territorit të saj, përveç në rastet nga neni 74 paragrafi (2) të këtij ligji.

Neni 81

Procedura për përpilimin e planit urbanistik dhe dokumentacionin e planit urbanistik, konsiderohet se ka filluar nëse është miratuar plani i dokumentacionit nga neni 26 i këtij ligji.

Neni 82

Ndryshime dhe plotësime të planeve urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 i këtij ligji, kryhen në të njëjtën procedurë të përcaktuar për miratimin e tyre.

Neni 83

(1) Në plan të miratuar urbanistik mund të bëhet korrigjim teknik.

(2) Korrigjimi teknik mund të kryhet vetëm për ndonjë gabim teknik të numrave dhe/ose mosharmonizim të parametrave në pasqyrën grafike, pjesën tekstuale dhe pjesën numerike të planit urbanistik.

(3) Përpiluesi i planit urbanistik, përgatit propozim për korrigjim teknik dhe dorëzon kërkesë te komisioni për urbanizëm nga neni 23 i këtij ligji, te organi kompetent që e ka miratuar planin urbanistik, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(4) Komisioni për urbanizëm është i obliguar që në afat prej pesë ditëve të punës nga pranimi i kërkesës që të japë mendim pozitiv për korrigjim teknik ose ta refuzojë kërkesën për korrigjim teknik në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(5) Pas mendimit të marrë pozitiv të propozimit për korrigjim teknik nga komisioni për urbanizëm, organi kompetent që e ka miratuar planin urbanistik, e dorëzon propozimin për korrigjimin teknik te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës për marrjen e pëlqimit, në formë elektronike ose nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(6) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës është i obliguar që në afat prej pesë ditëve të punës të japë pëlqim për korrigjim teknik ose ta refuzojë kërkesën për korrigjim teknik, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

(7) Pas pëlqimit të marrë nga organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sferat e rregullimit të hapësirës, korrigjimin teknik në afat prej 15 ditëve të punës e miraton Këshilli i komunës, komunës së Qytetit të Shkupit, përkatësisht Qytetit të Shkupit, që e ka miratuar planin urbanistik me të cilin ka të bëjë korrigjimi teknik.

(8) Korrigjimi teknik është pjesë përbërëse e planit urbanistik dhe ai mund të zbatohet pas plotësimit të kushteve nga paragrafët (5), (6) dhe (7) të këtij neni.

Neni 84

(1) Deri në miratimin e planit urbanistik për fshat, ndërtimet në fshatrat që nuk kanë dokumentacion urbanistik, mund të kryhen në kushte dhe mënyrë që me akt të përgjithshëm do t'i përcaktojë komuna, komuna e qytetit të Shkupit, që miratohet me pëlqim paraprak nga organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

(2) Forma dhe përmbajtja e aktit të përgjithshëm nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohen nga ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit të hapësirës.

Neni 85

(1) Me planin e detajuar urbanistik dhe me projektin e infrastrukturës mund të përcaktohen edhe kushtet për ndërtimin e rrugëve dhe traseve për biçikleta.

(2) Mënyra e ndërtimit të rrugëve dhe traseve të biçikletave përcaktohen nga ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e rregullimit të hapësirës.

XII. MBIKËQYRJA

Neni 86

Mbikëqyrje të zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të tij, kryen organi i administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e planifikimit hapësinor, në pjesën e planifikimit hapësinor, ndërsa në pjesën e planifikimit urbanistik e kryen organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e rregullimit hapësinor.

1. Mbikëqyrja inspektuese

Neni 87

Punët e mbikëqyrjes inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të tij e kryejnë Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm, si dhe Inspektorati Shtetëror Administrativ.

Neni 88

(1) Lëndë e mbikëqyrjes inspektuese të Inspektoratit Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm janë dokumentacioni i planit urbanistik nga neni 7 paragrafi (2) i këtij ligji dhe dokumentacioni i projektues urbanistik.

(2) Subjekt i mbikëqyrjes inspektuese është organi që e ka miratuar dokumentacionin e planit urbanistik, përkatësisht dokumentacionin projektues urbanistik.

(3) Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm, inspektimin e kryen nëpërmjet inspektorëve urbanistikë.

Neni 89

Inspektor urbanistik mund të jetë personi i cili:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- është i moshës madhore;
- ka aftësi të përgjithshme shëndetësore;
- nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës, ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- ka të paktën 300 kredi sipas SETK ose shkallën e VII/1 të kryer nga sfera e arkitekturës, që dëshmohej me vërtetim;
- ka pesë vite përvojë pune nga sfera e arkitekturës;
- i plotëson kushtet e tjera të përcaktuara në aktin e sistematizimit të vendeve të punës;
- posedon certifikatë të pranuar ndërkombëtare për punë me programe kompjuterike për punë në zyrë, dhe atë si vijon:

- 1) Certipoint IC3 GS4 Key Applications – të mbaruar me sukses,
- 2) Microsoft: MOS Eörd ili MOS Excell – të mbaruar me sukses,
- 3) ECDL: Core - të mbaruar me sukses,
- ka marrë mendim pozitiv për përkatësi në vendin e punës nëpërmjet testit psikologjik dhe testit të integritetit, në pajtim me rregullat që kanë të bëjnë me nëpunësit shtetërore dhe
- ka licencë për inspektor nga sfera e kompetencave të shërbimeve inspektuese.

Neni 90

(1) Inspektori urbanistik ka legjitimacion zyrtar.

(2) Formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit nga paragrafi (1) i këtij neni, mënyrën e lëshimit dhe heqjes së saj, si dhe dukjen e shenjës, me propozim të drejtorit të Inspektoratit Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e rregullimit hapësinor.

(3) Legjitimacionin zyrtar nga paragrafi (1) i këtij neni e jep drejtori i inspektoratit.

(4) Legjitimacioni zyrtar ka vlerë prej gjashtë viteve.

(5) Pas skadimit të vlefshmërisë, inspektori është i obliguar që ta kthejë legjitimacionin te drejtori i inspektoratit i cili obligohet t'i japë legjitimacion të ri.

Neni 91

(1) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm përpilon propozim Program vjetor për punën e inspektoratit dhe e dorëzon atë te Këshilli Inspektues, më së voni deri më 30 shtator në vitin rrjedhës për vitin e ardhshëm.

(2) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm, e miraton Programin vjetor për punë të inspektoratit në afat prej shtatë ditëve nga dita e pranimit të pëlqimit nga paragrafi (3) i këtij neni, përkatësisht më së voni deri më 10 dhjetor në vitin rrjedhës nëse Këshilli Inspektues nuk e shqyrton dhe nuk dorëzon pëlqim, përkatësisht vërejtje në afatin e paraparë në paragrafin (3) të këtij neni.

(3) Në bazë të Programit vjetor të miratuar, drejtori i Inspektoratit Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm, përpilon plane kuartale për punë për çdo inspektor, që i përmbledh në shqyrtim te Këshilli inspektues më së voni dy javë para fillimit të kuartalit të ardhshëm kalendarik, edhe atë deri më 15 dhjetor për tremujorin e parë nga viti i ardhshëm, deri më 15 mars për pjesën e dytë, deri më 15 qershor për pjesën e tretë, dhe deri më 15 shtator për tremujorin e katërt në vitin rrjedhës.

(4) Në planet tremujore për punën e çdo inspektori, drejtori detyrimisht e vendos numrin e mbikëqyrjeve të planifikuara në tre muajt e ardhshëm, si dhe shkallën e ndërlikueshmërisë për secilën mbikëqyrje.

(5) Në bazë të planeve tremujore, për çdo inspektor drejtori i Inspektoratit Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm përpilon plan mujor të punës, i cili përmban edhe orarin e mbikëqyrjeve sipas datave dhe subjekteve të mbikëqyrjes.

(6) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm, më së voni dy javë nga fillimi i tremujorit rrjedhës kalendarik për atë paraprak, në Këshillin Inspektues në mënyrë përmbledhëse dorëzon raporte tremujore për punën e secilit inspektor si vijon, deri më 15 janar për tremujorin e katërt të vitit paraprak, deri më 15 prill për tremujorin e parë të vitit rrjedhës, përkatësisht 15 korrik për të dytin, përkatësisht deri më 15 tetor për tremujorin e tretë të vitit rrjedhës.

(7) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm më së voni deri më 1 mars të vitit rrjedhës, dorëzon raport vjetor për punën e inspektoratit për vitin e kaluar.

Neni 92

(1) Mbikëqyrja inspektuese kryhet me detyrë zyrtare dhe në bazë të propozimit për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese të dokumentacionit të planit urbanistik dhe dokumentacionit projektues, të parashtruar nga organi shtetëror, komuna, komuna në qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit si dhe për çdo person i interesuar juridik dhe fizik.

(2) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori urbanistik kontrollon nëse dokumentacioni i miratuar i planit urbanistik dhe dokumentacioni projektues janë përpunuar në pajtim me rregullat ligjore dhe nënligjore.

(3) Për mbikëqyrjen e realizuar, inspektori urbanistik përpilon procesverbal për gjendjen e konstatuar dhe nëse konstaton parregullsi të caktuara në dokumentacionin e planit urbanistik dhe dokumentacionin projektues është i obliguar që të miratojë vendim me të cilin do ta obligojë organin që e ka miratuar dokumentacionin e planit urbanistik dhe atë projektues ta asgjësojë atë.

(4) Organi kompetent që e ka miratuar dokumentacionin e planit urbanistik dhe atë projektues për të cilin është miratuar vendim me ngarkim për anulim në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni, nëse konsideron se vendimi për anulim është i pabazë, mund të japë ankesë kundër vendimit të inspektorit në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të vendimit, te Komisioni Shtetëror për Vendim në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, e në të kundërtën mund të miratohet vendim i cili do ta asgjësojë dokumentacionin e planit urbanistik dhe atë të projektit urbanistik.

(5) Nëse dokumentacioni i planit urbanistik, dhe ai projektues është anuluar, Inspektorati Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm, obligohet që te organi kompetent i administratës shtetërore për punët nga sfera e rregullimit hapësinor, të parashtrijë propozim për heqjen e licencës së personit juridik që e ka përpiluar dokumentacionin e anuluar të planit urbanistik, përkatësisht dokumentacionin e asgjësuar të projektit urbanistik dhe licencën e personit juridik që e ka përpiluar raportin për revizionin profesional të dokumentacionit dhe projektit të infrastrukturës, ndërsa te Oda propozim për marrjen e autorizimit të personit fizik që është planifikues nënshkrues i dokumentacionit të planit urbanistik dhe autorizimin e personit fizik që është nënshkrues i raportit të revizionit profesional për dokumentacionin e anuluar të planit urbanistik dhe projektit të infrastrukturës.

Neni 93

(1) Inspektorati shtetëror administrativ kryen mbikëqyrje inspektuese në procedurën për dhënien e kushteve për planifikimin e hapësirës, të përcaktuar në nenin 25 të këtij ligji, në procedurën e miratimit të dokumentacionit të planit urbanistik lokal, të përcaktuar në nenin 46 të këtij ligji, në procedurën e miratimit të dokumentacionit shtetëror urbanistik të përcaktuar në nenin 47 të këtij ligji, në procedurën e miratimit të dokumentacionit të planit urbanistik dhe në procedurën e dhënies së ekstraktit të planit urbanistik, dokumentacionit urbanistik dhe projektit arkitekturor urbanistik.

(2) Pas njoftimit të marrë për mosveprim, Inspektorati Shtetëror Administrativ obligohet që të bëjë mbikëqyrje inspektuese dhe të konstatojë nëse:

Në nenin 46 paragrafi (4) fjalët: "kurse për të mirat e mbrojtura të patundshme edhe te organi kompetent i administratës shtetërore për regjistrimin e të drejtës së pronësisë" fshihen.

Neni 14

Titulli i Seksionit 8 ndryshohet si vijon:

"INSTRUMENTE TË PLANIT PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE"

Neni 15

Në nenin 49 në paragrafin (1) fjalët: "Qeveria" zëvendësohen me fjalët: "Kuvendi" kurse pas fjalëve: "me propozim të" shtohen fjalët: "Drejtorisë, e pas mendimit paraprak nga".

Në paragrafin (2) numri "15" zëvendësohen me numrin "5"

Pas paragrafit 2 shtohen pesë paragrafë të rinj (3), (4), (5), (6) dhe (7) si vijojnë:

"(3) Strategjia nacionale i përmban qëllimet dhe parimet themelore të mbrojtjes dhe përcaktimet strategjike në vijim: legjislacioni, financimi, institucione për mbrojtje, vetëdija publike dhe edukimi, identifikimi, hulumtime arkeologjike, mbrojtja e trashëgimisë së patundshme kulturore, mbrojtja e trashëgimisë së tundshme kulturore, mbrojtja e trashëgimisë jomateriale kulturore, parandalimi nga veprime të paligjshme, mbrojtja në rast të fatkeqësive natyrore dhe konfliktit të armatosur, mbrojtja e trashëgimisë kulturore nga ndotja e ambientit jetësor, shfrytëzimi i trashëgimisë kulturore, arsimit dhe edukimi i kuadrove, digjitalizimi i trashëgimisë kulturore dhe popullarizimi i trashëgimisë kulturore. Strategjia nacionale përmban plan aksional për realizimin e aktivitetëve të definuara, dinamikën, bartësit e aktivitetëve dhe projektimet e mjeteve buxhetore dhe jashtëbuxhetore, si dhe indikatorët për evaluimin e zbatimit të Strategjisë nacionale.

(4) Pas tekstit të propozimit të Strategjisë nacionale, Drejtoria organizon debat publik.

(5) Mjetet për realizimin e Strategjisë nacionale sigurohen në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

(6) Strategjia nacionale dorëzohet te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së paku gjashtë muaj para skadimit të vlefshmërisë së strategjisë nacionale paraprake.

(7) Për realizimin e aktivitetëve në pajtim me planin aksional të Strategjisë nacionale, Drejtoria një herë në vit dorëzon raport te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë."

Paragrafi (3) bëhet paragraf (8).

Neni 16

Pas nenit 49 shtohet titull i ri dhe nen i ri 49-a, si vijojnë:

"Plani për menaxhim me trashëgiminë e patundshme kulturore

Neni 49-a

(1) Për menaxhimin me tërësinë monumentale dhe rajonit kulturor për të cilat është miratuar akt për mbrojtje, miratohet plan për menaxhimin e trashëgimisë së patundshme kulturore (në tekstin e mëtejme: plan për menaxhim). Plani për menaxhim mund të miratohet edhe për lloje tjera të trashëgimisë së patundshme kulturore nëse kjo është përcaktuar me aktin për mbrojtje.

(2) Plani për menaxhim duhet të jetë i harmonizuar me qëllimet, masat dhe aktivitetet për mbrojtjen dhe menaxhimin e të mirave të mbrojtura kulturore, të

përcaktuara me këtë ligj, aktin për mbrojtje, standardet ndërkombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë, si dhe planet urbanistike dhe dokumentacionin e planit urbanistik të parapara me ligj. Zbatimi i planit për menaxhim mund të përkrahët edhe me mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, përmes Ministrisë së Kulturës, në procedurë të përcaktuar me ligj.

(3) Plani për menaxhim nga paragrafi (1) i këtij neni duhet t'i përmbajë masat dhe aktivitetet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, edhe atë:

- hyrje (pasqyrë e të mirave të patundshme të mbrojtura me vlerat, rëndësinë, karakteristikat, kufijtë e shprehur në tekst dhe përmes hartës, metodologjia e përgatitjes dhe gjendja);

- zhvillimi historik;
- menaxhimi;
- faktorët dhe rreziqet;
- potencialet dhe vizioni;
- qëllimet kryesore të planit;
- planifikimi i zhvillimit urban dhe rehabilitimi urban;
- plani aksional për zbatimin e planit me implikime fiskale të nevojshme për zbatimin e tij;
- subjektet dhe mënyra e zbatimit të planit dhe
- rezyme dhe shtojca përkatëse të planit.

(4) Planin për menaxhim nga paragrafi (1) i këtij neni, e miraton subjekti i përcaktuar me aktin për mbrojtjen e të mirës, e me pëlqim paraprak nga Drejtoria dhe nga Ministria e Kulturës. Plani për menaxhim është me vlefshmëri prej pesë viteve.

(5) Plani për menaxhim miratohet në afat prej gjashtë muajve llogaritur nga dita e miratimit të aktit për mbrojtje. Në procedurën e miratimit të planit të menaxhimit, subjekti që menaxhon me të mirën e patundshme të mbrojtur, detyrohet që të organizojë debat publik. Mendimet, propozimet dhe rekomandimet e shfaqura në debatin publik merren parasysh gjatë përpilimit të planit të menaxhimit.

(6) Subjekti që menaxhon me të mirën e mbrojtur të patundshme më së voni deri më 31 janar të vitit rrjedhës për vitin e kaluar parashtrohet raport vjetor për zbatimin e planit për menaxhim nga paragrafi (1) i këtij neni, te Drejtoria.

(7) Subjekti nga paragrafi (4) i këtij neni detyrohet që të përpilojë plan të ri të menaxhimit më së voni gjashtë muaj para skadimit të afatit për të cilin është miratuar plani.

(8) Drejtoria e ndjek zbatimin e planit të menaxhimit."

Neni 17

Pas nenit 54 shtohen titulli i ri dhe neni i ri 54-a, si vijojnë:

"Regjimi i mbrojtjes dhe shkallët e mbrojtjes

Neni 54-a

(1) Me aktin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore përcaktohet regjimi për mbrojtje që përcaktohet sipas llojit dhe kategorisë, përkatësisht statusit të mbrojtur të së mirës, edhe atë si:

1. Regjim i mbrojtjes i shkallës së parë;
2. Regjim i mbrojtjes i shkallës së dytë;
3. Regjim i mbrojtjes i shkallës së tretë;

(2) Regjimi i mbrojtjes i shkallës së parë zbatohet mbi:

1. Trashëgiminë kulturore me rëndësi të veçantë dhe
2. Zonës së rezervuar arkeologjike.

(3) Regjimi i mbrojtjes i shkallës së dytë zbatohet mbi:

1. Trashëgimin kulturore me rëndësi dhe
2. Të mirën me mbrojtje të përkohshme.

(4) Regjimi i mbrojtjes i shkallës së tretë zbatohet mbi zonat kontaktuese."

Neni 18

Në nenin 55 paragrafi (2) pas fjalisë së parë shtohet fjali e re si vijon: "Ekzemplar nga leja e dhënë, Drejtoria dorëzon në institucionin publik për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në rajonin e të cilit do të kryhen hulumtimet arkeologjike."

Neni 19

Në nenin 56 paragrafi (2) në pikën 3 fjalët: "me status të" zëvendësohen me fjalët: "që i plotëson kushtet për".

Në pikën 4 fjalët: "me status të" zëvendësohen me fjalët: "që i plotëson kushtet për".

Në paragrafin (4) pas fjalëve: "në organizimin e hulumtimeve" lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje, kurse pas fjalëve: "pas diplomimit" shtohen fjalët: "dhe të botuara së paku tri punime profesionale ose shkencore në publikime vendase ose ndërkombëtare profesionale dhe shkencore."

Pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5) si vijon:

"(5) Bartësi i lejes, me propozim të udhëheqësit profesional të arkeologëve që marrin pjesë në hulumtimet arkeologjike u jep vërtetim për pjesëmarrje në hulumtimet arkeologjike."

Pas paragrafit (5) që bëhet paragraf (6) shtohet paragraf i ri (7) si vijon:

"(7) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e dhënies së vërtetimit nga paragrafi (5) i këtij neni, i përcakton ministri i Kulturës."

Neni 20

Në nenin 58 pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6), si vijon:

"(6) Personi i njëjtë nuk mundet njëkohësisht të jetë udhëheqës profesional i dy ose më shumë hulumtimeve arkeologjike që realizohen në terren në të njëjtën periudhë kohore."

Neni 21

Në nenin 59 paragrafi (1) pika 1 ndryshohet si vijon:

"Të udhëheqë dokumentacion dhe evidencë të rregullt për rrjedhën e hulumtimeve arkeologjike, për gjetjet e zbuluara arkeologjike dhe masat e mbrojtjes që i ndërmerr;"

Pika 4 ndryshohet si vijon:

"Të organizojë punë urgjente konservuese të vendbulimit përkatësisht gjetjeve, në procedurë dhe mënyrë të përcaktuara me aktin e nenit 85 paragrafi (7) të këtij ligji;"

Në paragrafin (3) pika 2 ndryshohet si vijon:

"Në afat prej tre vitesh në Drejtori të dorëzojnë ekzemplar të dokumentacionit final nga hulumtimet e kryera arkeologjike"

Pika 3 ndryshohet si vijon:

"Në afat prej tre vitesh t'i publikojnë rezultatet nga hulumtimet e kryera arkeologjike (në ueb faqen e bartësit të lejes për hulumtim arkeologjik, në publikimi profesional apo shkencor, në revistë profesionale apo shkencore ose në mënyrë tjetër përkatëse të shpalljes në publik) dhe".

Neni 22

Në nenin 63 pas paragrafit (8) shtohet paragraf i ri (9), si vijon:

"(9) Organet doganore detyrohen që menjëherë ta njoftojnë Drejtorinë për detektorë të importuar të metalit dhe mjete tjera teknike, të volitshme për detektimin e vendzbulimeve arkeologjike, përkatësisht të sendeve me rëndësi arkeologjike."

Neni 23

Në nenin 65 në paragrafin (1) pas fjalës "obliguar" shtohen fjalët: "menjëherë, kurse më së voni në afat prej tri ditësh".

Neni 24

Në nenin 71 në paragrafin (4) pas pikës në fund të paragrafit shtohet fjali e re, si vijon "Programi vjetor për përpilimin e bazave mbrojtëse-konservuese, harmonizohet me Programin vjetor për përpilimin e planeve hapësinore dhe urbanistike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë" dhe me programet për përpilimin e planeve urbanistike të komunave dhe të Qytetit të Shkupit".

Pas paragrafit (4) shtohen dy paragrafë të rinj (5) dhe (6), si vijojnë:

"(5) Nëse është i domosdoshëm përpilimi i bazave mbrojtëse - konservuese që nuk janë të parapara në programet nga paragrafi (4) i këtij neni, bazat mbrojtëse - konservuese përpilohen me mjetet e porositësit të planit.

(6) Lartësia e mjeteve të nevojshme për përpilimin e bazave mbrojtëse - konservuese përcaktohet me listë tarifore që e miraton ministri i Kulturës. Lartësia e mjeteve të nevojshme për përpilimin e bazave mbrojtëse - konservuese përcaktohet varësisht nga lloji i planit, madhësia e rajonit të përfshirjes së planit, numri, lloji dhe koncentrimi i të mirave kulturore, lloji i shpenzimeve të nevojshme dhe afati për përgatitjen e bazave mbrojtëse-konservuese."

Paragrafët (5), (6), (7) dhe (8) bëhen paragrafë (7), (8), (9) dhe (10).

Neni 25

"Titulli i nenit 73 dhe neni 73 fshihen."

Neni 26

Në pikën 74 paragrafi (2) pika 1 fshihet.

Pikat 2, 3, 4 dhe 5 bëhen pika 1, 2, 3 dhe 4.

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

"Në rastin nga paragrafi (1) i këtij neni, organi kompetent për dhënien e lejes për ndërtim, në afatin e përcaktuar me ligj, obligohet që ta udhëzojë palën që të sigurojë nga Drejtoria kushte mbrojtëse-konservuese. Kushtet mbrojtëse-konservuese i përpilojnë institucionet publike kompetente, kurse i lëshon Drejtoria me aktvendim."

Në paragrafin (6) fjala "përcaktojnë" zëvendësohet me fjalën "miratojnë".

Neni 27

Në nenin 75 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Për shkak të vlerësimit të zbatimit konsekuent të kushteve mbrojtëse - konservuese, në rastet kur në rajonin e mbrojtur realizohen punë ndërtimore që nuk paraqesin mbrojtje të drejtpërdrejtë të trashëgimisë së patundshme kulturore, Drejtoria jep leje paraprake mbrojtëse-konservuese për trashëgiminë kulturore të patundshme."

Neni 28

Pas nenit 79 shtohet titull i ri dhe nen i ri 79-a, si vijojnë:

"Dhënia me qira ose transformimi

Neni 79-a

Toka bujqësore, kullosat dhe pyjet në pronësi të Republikës së Maqedonisë në të cilat gjendet vendzbulim arkeologjik i evidentuar apo i mbrojtur, i regjistruar në librin publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive, mund të jepen me qira ose t'u bëhet transformim në tokë ndërtimore me pëlqim paraprak nga Drejtoria."

Neni 29

Në nenin 80 në paragrafin (1) pas fjalës "njoftimet" shtohen fjalët: "dhe të vendosen aparate si antena, stabilimente të klimës, kolektorë diellorë dhe pajisje tjetër".

Neni 30

Në nenin 81 paragrafi (1) fjalët: "pëlqim i lëshuar mbrojtës-konservues ose gjatë realizimit të punëve nuk u përmbahet në kushte të përcaktuara mbrojtëse-konservuese" zëvendësohen me fjalët: "leje të lëshuar paraprakisht mbrojtëse-konservuese".

Në pikën 2 fjalët: "e tërheq pëlqimin e dhënë" zëvendësohen me fjalët: "e tërheq lejen e dhënë paraprakisht mbrojtëse-konservuese".

Neni 31

Në nenin 87 paragrafi (8) fjalët: "paragrafi (6)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (7)", ndërsa fjala "janë" zëvendësohen me fjalët: "organi i cili e lëshon lejen sipas rregullave për ndërtim, me detyrë zyrtare e".

Pas paragrafit (8) shtohet paragraf i ri (9), si vijon:

"(9) Bartësi i lejes së lëshuar konservuese detyrohet, në afat prej më së shumti dy ditëve nga dita e fillimit të punëve të mbrojtjes së drejtpërdrejtë të së mirës së patundshme, në Drejtori dhe në subjektin kompetent i cili është kryerës i mbikëqyrjes konservuese të nenit 89 të këtij ligji, në formë të shkruar ta paraqesë fillimin e punëve të mbrojtjes së drejtpërdrejtë."

Neni 32

Në nenin 88 paragrafi (2) shtohet fjali e re, si vijon: "Personi i njëjtë nuk mundet njëkohësisht të menaxhojë me punët e mbrojtjes së drejtpërdrejtë të së mirës së patundshme nëse realizohen në periudhën e njëjtë kohore."

Pas paragrafit (8) shtohet paragraf i ri (9), si vijon:

"(9) Ministri i Kulturës e përcakton llojin, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e menaxhimit të dokumentacionit të realizuar konservues, punët lidhur me realizimin e mbrojtjes së drejtpërdrejtë, mbikëqyrjen konservuese dhe pranimin e punëve të realizuara."

Neni 33

Në nenin 88-a paragrafi (2) në alinenë 2 fjala "dy" zëvendësohen me fjalën "pesë", ndërsa në fund të fjalisë pika shlyhet dhe shtohen fjalët: "ose së paku tre vjet përvojë punë pas diplomimit, në sferën përkatëse të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të tundshme dhe të patundshme dhe studime të përfunduara të magjistraturës, gjegjësisht doktoraturës nga sfera përkatëse."

Neni 34

Në nenin 88-b paragrafi (1) në fjalinë fjala "tre" zëvendësohet me fjalën "dy".

Alineja 2 shlyhet.

Në alinenë 3 fjala "tretë" zëvendësohen me fjalëm "dytë".

Paragrafi (4) shlyhet.

Në paragrafin (5) i cili bëhet paragraf (4) fjala "treti" zëvendësohet me fjalën "dyti", ndërsa pas fjalëve: "neni 88-v" paragrafi (1) të këtij ligji" presja dhe fjalët deri në fund të fjalisë fshihen.

Në paragrafin (6) i cili bëhet paragraf (5) fjalët: "paragrafi (5)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (4)".

Neni 35

Në nenin 88-v në paragrafin (1) pas fjalëve: "literatura" lidhëza "dhe" zëvendësohet me fjalën "për", ndërsa fjala "tematike" zëvendësohet me fjalën "tematike".

Neni 36

Në nenin 88-g paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Bazat e pyetjeve për pjesën e parë të provimit dhe temat profesionale për mbrojtje të pjesës së dytë të provimit nga neni 88-ll paragrafi (6) i këtij ligji, i përpilojnë punëtorë shkencorë dhe profesionalë nga sfera e konservimit dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të tundshme dhe të patundshme, të përcaktuara nga drejtori i Drejtorisë."

Në paragrafin (2) pas fjalëve: "pjesa e parë e provimit" presja dhe fjalët: "pyetjet dhe shembuj praktikë të pjesës së dytë të provimit" shlyhen, ndërsa fjala "tretë" zëvendësohet me fjalën "dytë".

Në paragrafin (4) pas fjalës "pyetjet" presja dhe fjalët: "bazat e shembujve praktikë" shlyhen, ndërsa fjalët: "paragrafi (6)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (4)".

Në paragrafin (5) pas fjalëve: "pyetja" presja dhe fjalët: "përkatesisht shembulli praktik" shlyhen, ndërsa fjalët: "paragrafi (6)" zëvendësohet me fjalët: "paragrafi (4)".

Në paragrafin (6) pas fjalëve: "pyetjet" presja dhe fjalët: "bazat e shembujve praktikë" shlyhen, ndërsa fjalët: "shembuj praktikë" shlyhen, ndërsa fjalët: "paragrafi (6)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (4)".

Në paragrafin (8) pas fjalës "pyetjet" presja dhe fjalët: "shembuj praktikë" shlyhen.

Neni 37

Në nenin 88-i në paragrafin (1) pas fjalës "parë" presja dhe fjala "dytë" shlyhen, fjala "tretë" zëvendësohet me fjalën "dytë", ndërsa pas fjalës "dytë" presja dhe fjalët: "përkatesisht tretë" shlyhen".

Neni 38

Në nenin 88-x në paragrafët (3) dhe (6) fjalët: "dhe dytë", shlyhen.

Neni 39

Titulli i nenit 88-j "Pjesa e parë, e dytë dhe e tretë nga provimi dhe sistemi elektronik" shlyhet.

Në nenin 88-j në paragrafin (1) pas fjalëve: "(pjesa teorike)" presja dhe fjalët: "pastaj të pjesës së dytë (shembullit praktik)" shlyhen, kurse fjala "tretë" zëvendësohet me fjalën "dytë".

Paragrafi (2) shlyhet.

Paragrafi (3) i cili bëhet paragraf (2) ndryshohet si vijon:

"Kandidati i cili e ka dhënë pjesën e parë nga provimi ka të drejtë ta japë pjesën e dytë nga provimi. Komisioni nga neni 88-g paragrafi (2) nga ky ligj, kandidatit, në afat prej pesë ditëve nga dita e dhënies së suksesshme të pjesës

së parë nga provimi, i cakton temë profesionale që kandidati duhet ta përpunojë dhe ta dorëzojë te Drejtoria në afat prej dy muajve duke llogaritur nga dita e pranimi të njoftimit për temën e cila i është caktuar."

Paragrafët (4), (5) dhe (6) bëhen paragrafë (3), (4) dhe (5).

Neni 40

Në nenin 88-k paragrafi (1) fjala " pesë" zëvendësohet me fjalën "tre", kurse fjalët: "ngjashme, njëra nuk është e saktë në masë të vogël (në të humben numër i vogël i pikëve)" dhe njëra nuk është e saktë në masë të madhe (në të humben numër i madh i pikëve) zëvendësohen me fjalët: "të pasakta".

Paragrafi (2) shlyhet.

Paragrafi (3) bëhet paragraf (2).

Paragrafët (4), (5) dhe (6) shlyhen.

Në paragrafi (7) i cili bëhet paragraf (3) fjala "tretë" zëvendësohet me fjalën "dytë".

Neni 41

Në nenin 88-ll paragrafët (3) dhe (4) shlyhen.

Në paragrafin (5) i cili bëhet paragraf (3) pas fjalës "përgjigje" , presja dhe fjalët: " pyetjet për shembullin praktik dhe përgjigjet e tyre, si" shlyhen.

Në paragrafin (6) i cili bëhet paragraf (4) fjalët: "paragrafi (5)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (3)", kurse pas fjalës "provimi" presja dhe fjalët: " bazë publikisht e arritshme nga së paku 100 pyetje për pjesën e dytë të provimit," shlyhen, kurse fjala "tretë" zëvendësohet me fjalën "dytë".

Në paragrafin (7) i cili bëhet paragrafi (5) fjala "paragrafi (5)" zëvendësohet me fjalët: "paragrafi (3)".

Në paragrafin (8) i cili bëhet paragrafi (6), presja dhe fjalët: "shembuj praktikë" shlyhet, kurse fjalët: "paragrafi (6)" zëvendësohet me fjalët: " paragrafi (4)".

Në paragrafin (9) i cili bëhet paragrafi (7) fjala "dytë" shlyhet, kurse fjalët: "paragrafi (5)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (4)".

Neni 42

Në nenin 88-l në paragrafi (1) presja dhe fjalët: "përkatësisht dytë" shlyhen, kurse fjalët: "paragrafi (5)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (3)".

Në paragrafin (2) pas fjalës "provimi" presja dhe fjalët: "përkatësisht shembulli praktik elektronik për pjesën e dytë nga provimi" shlyhen.

Në paragrafin (3) fjalët: " dhe të dytë" shlyhen, kurse fjala " përmbajnë" zëvendësohen me fjalën "përmban".

Në paragrafin (4) pas fjalës "provimi" presja dhe fjalët: "përkatësisht shembulli praktik elektronik për pjesën e dytë nga provimi" shlyhen.

Neni 43

Në nenin 88-m në paragrafi (1) fjalët: "ose të dytë", shlyhen.

Neni 44

Në nenin 88-n paragrafi (3) dhe (4) shlyhen.

Në paragrafi (5) i cili bëhet paragrafi (3) fjala " tretë" zëvendësohet me fjalën "dytë".

Në paragrafi (6) i cili bëhet paragraf (4) fjala "tretë" zëvendësohet me fjalën "dytë".

Neni 45

Në nenin 88-o fjalët: " dhe në shembullin praktik" shlyhen.

Neni 46

Në nenin 88-p paragrafi (1) fjalët: " dhe shembujt praktikë" shlyhen.

Paragrafi (2) ndryshohet dhe vijon:

"Materialet nga provimet e mbajtura dhe temat e dorëzuara profesionale, si dhe incizimet nga provimet e mbajtura përgjithmonë ruhen në Drejtori."

Neni 47

Në nenin 88-r në paragrafin (2) pas fjalës "parë" fjalët: "dytë dhe tretë" zëvendësohet me fjalët: " dhe dytë".

Neni 48

Në nenin 89 pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6), si vijon:

"(6) Realizimi i punëve të mbrojtjes së drejtpërdrejtë nuk mund të fillojë pa emërimin e subjektit që është kompetent për kryerjen e mbikëqyrjes konservatore".

Neni 49

Pas nenit 95 shtohen dy tituj të ri dhe dy nene të reja 95-a dhe 95-b, si vijojnë

"Nxjerrja e trashëgimisë kulturore

Neni 95-a

(1) Trashëgimi kulturore e tundshme me të cilën menaxhojnë institucionet publike për mbrojtje (muze, biblioteka dhe kinoteka) dhe e cila është regjistruar në librat e tyre për evidencë, nuk guxon të nxirret jashtë nga institucioni publik për mbrojtje pa leje të Drejtorisë.

(2) Lejen nga paragrafi (1) i këtij neni e lëshon Drejtoria pas mendimit paraprak nga Ministria e Kulturës. Drejtoria e lëshon leje në afat prej pesë ditësh pune, duke llogaritur nga dita e dorëzimit të kërkesës për marrjen e lejes.

(3) Personat të cilët kanë të drejtë të pronësisë shkencore mbi sende të tundshme, detyrohen përpunimin shkencor të sendeve ta kryejnë në institucion publik nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Personave nga paragrafi (3) i këtij neni, të cilët nuk janë punësuar në institucione publike për mbrojtje nga paragrafi (1) i këtij neni, institucioni detyrohet t'u mundësojë qasje te sendet e tundshme dhe hapësirat përkatëse dhe parakushtet teknike për kryerjen e përpunimit shkencor.

(5) Me përjashtim nga paragrafi (4) të këtij neni, nëse personi kryen përpunim shkencor të sendeve të tundshme është në largësi hapësinore nga institucioni publik për mbrojtje nga paragrafi (1) i këtij neni, institucioni mund të lidh marrëveshje me institucion tjetër publik për mbrojtje që t'ia kalojë sendet përkohësisht, në kohë e cila është e nevojshme për përpunimin e tyre shkencor.

(6) Drejtoria jep pëlqim paraprak të marrëveshjes nga paragrafi (5) të këtij neni.

Përpilimi i kopjes

Neni 95-b

(1) Përpilimi i kopjes së trashëgimisë kulturore të tundshme (kopje muzeore, kopje komerciale të sendit muzeor dhe kpoje të së mirës bibliotekare) me të cilën menaxhojnë institucionet publike për mbrojtje (muze dhe biblioteka) dhe e cila është regjistruar në librat e tyre për evidencë, kryhet në pajtim me dispozitat për muze dhe për biblioteka, e me leje paraprake nga Drejtoria.

(2) Lejen nga paragrafi (1) i këtij neni e lëshon Drejtoria pas mendimit paraprak nga Ministria e Kulturës. Drejtoria e lëshon lejen në afat prej pesë ditësh pune, duke llogaritur nga dita e dorëzimit të kërkesës për marrjen e lejes."

Neni 50

Në nenin 97 në paragrafin (5) pas fjalës "Antikitete" vihet presje dhe shtohen fjalët: " trashëgimi kulturore të tundshme nga neni 32-a paragrafi (2) pika 4 të këtij ligji".

Neni 51

Në nenin 103 paragrafi (1) fjalët: "Këshilli Nacional për Trashëgimi Kulturore" zëvendësohen me fjalën "Drejtoria".

Në paragrafin (3) dhe (4) fjalët: "Këshilli Nacional për Trashëgimi Kulturore" zëvendësohen me fjalën "Drejtoria".

Neni 52

Në nenin 104 paragrafi (5) pas fjalës "persona" shtohen fjalët: " për siguri të trashëgimisë kulturore".

Neni 53

Në nenin 105 paragrafi (1) pas fjalës " kulturë" shtohen fjalët: "dhe të njëjtat duhet të posedojnë certifikatë të sigurisë për qasje dhe shfrytëzimin e informacioneve të klasifikuara të marrë në pajtim me ligj".

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Personat e autorizuar zyrtarë nga paragrafi (1) nga ky nen detyrohen njëherë në vit të dorëzojnë raport për punë të kryera nga paragrafi (2) i këtij neni, te ministri i Kulturës dhe te ministri i Punëve të Brendshme".

Paragrafët (3) dhe (4) bëhen paragrafë (4) dhe (5).

Neni 54

Në nenin 110 paragrafi (1) fjalët: "Këshilli Nacional për Trashëgimi Kulturore" zëvendësohen me fjalën "Drejtoria".

Neni 55

Pas nenit 114 shtohet titull i ri dhe nen i ri 114-a, si vijon:

"Prezantimi i trashëgimisë kulturore

Neni 114-a

(1) Me prezantimin e trashëgimisë kulturore sigurohet qasje te trashëgimia kulturore te publiku për plotësimin e nevojave edukative kulturore dhe shkencore dhe zgjerimin e njohurive mbi vlerat dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore.

(2) Prezantimi i trashëgimisë kulturore, në pajtim me natyrën dhe dedikimin e tij, sigurohet përmes:

- 1) publikimit të botimeve për trashëgiminë kulturore;
- 2) qasjes te të mirat kulturore në mënyrë me të cilën mundësohet arsimit, nxitja e tolerancës së ndërsjellë, mësimi për kulturat e tjera dhe shumëllojshmërinë e tyre;
- 3) zhvillimit të turizmit kulturor;
- 4) pjesëmarrjes në konferencat ndërkombëtare ku prezantohen shkencërisht vlerat dhe rëndësia e trashëgimisë kulturore dhe
- 5) organizimit të ekspozitave në vend dhe jashtë vendit".

Neni 56

Në nenin 115 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Institucionet publike për mbrojtje, për nevojat e Sistemit informativ, detyrohen që në Drejtori në kontinuitet të dorëzojnë të dhëna për trashëgiminë kulturore në kompetencë të tyre dhe të dhënat t'i azhurnojnë në kontinuitet."

Neni 57

Në nenin 140 pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4), si vijon:

"(4) Me kërkesë të Drejtorisë, vlerësim të vlerës materiale të të mirës së mbrojtur kryen Byroja për Ekspertiza Gjyqësore ose vlerësues të autorizuar me ligj, për pronën e tundshme dhe të patundshme."

Paragrafët (4), (5), (6) dhe (7) bëhen paragrafë (5), (6), (7) dhe (8).

Neni 58

Në nenin 143 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Ekzistimi i interesit publik, në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni përcaktohet nga Drejtoria."

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

"(3) Procedura për eksproprijim zbatohet me propozim të Drejtorisë. Mjetet e nevojshme për eksproprijim sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë përmes Drejtorisë."

Paragrafi (3) bëhet paragraf (4).

Neni 59

Pas nenit 144-a shtohen dy tituj të ri dhe dy nene të reja 144-b dhe 144-v, si vijojnë:

"Kompetencat e drejtorit

Neni 144-b

Drejtori i Drejtorisë i kryen këto punë:

- e përfaqëson Drejtorinë dhe përgjigjet për punën materiale-financiare dhe për ligjshmërinë dhe ekonominë e punës së saj;
- e udhëheq, organizon, koordinon dhe e kontroillon punën e Drejtorisë në pajtim me ligjin;
- miraton propozim-buxhetin e Drejtorisë, planin financiar për shfrytëzimin e mjeteve të Drejtorisë, llogarinë përmbyllëse dhe dokumente tjera financiare në pajtim me ligjin.
- dorëzon raport vjetor te Qeveria e Republikës së Maqedonisë për punën e Drejtorisë;
- miraton aktin për organizimin e punës së Drejtorisë dhe sistematizimin e vendeve të punës në Drejtori;
- miraton akte në lidhje me marrëdhënien e punës së të punësuarve në Drejtori;
- emëron bashkëpunëtorë të jashtëm për kryerjen e punëve në kompetencë të Drejtorisë dhe lidh marrëveshje me ta;
- e përcjell punën e institucioneve publike për mbrojtje dhe për gjendjet e konstatuara dorëzon raport dy herë në vit te ministri i Kulturës dhe
- kryen punë tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe ligj tjetër.

Kushtet për shkarkimin e drejtorit

Neni 144-v

(1) Mandati i drejtorit të Drejtorisë i pushon me kërkesë të tij personale, përkatësisht dorëheqje të parashtruar në formë të shkruar dhe me fuqi të ligjit në një prej këtyre rasteve:

- nëse është dënuar për vepër penale me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilin është shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej së paku gjashtë muajve.

- nëse te ai është shkaktuar paaftësi e përhershme ose e përkohshme për kryerjen e funksionit më gjatë se gjashtë muaj ose vdekje dhe

- nëse i fiton kushtet për realizimin e të drejtës për pension sipas pleqërisë.

(2) Drejtori i Drejtorisë mund të shkarkohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, para skadimit të mandatit për të cilin është emëruar, në njërin prej këtyre rasteve:

- nëse nuk punon dhe nuk vepron sipas këtij ligji dhe ligjit tjetër ose akteve të Drejtorisë;

- nëse me punën e tij të pandërgjegjshme dhe të parregullt shkaktonte çrregullim në punët e Drejtorisë dhe shkaktonte dëm dhe

- nëse nuk i kryen punët nga nenet 144-b dhe 145 të këtij ligji.

(3) Nëse ka skaduar mandati i drejtorit ose nëse është shkarkuar para kohe, Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të emërojë ushtrues të detyrës drejtor.

(4) Ushtruesi i detyrës drejtor ka mandat deri në emërimin e drejtorit të ri të Drejtorisë, por jo më gjatë se gjashtë muaj."

Neni 60

Në nenin 145 në paragrafin (1) pas pikës 4 shtohen shtatë pika të reja: 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11, si vijojnë:

„5. E koordinon zbatimin e projekteve të rëndësishme nacionale dhe strategjike, planet dhe programet në realizimin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore;

6. Propozon Strategji nacionale për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore;

7. Propozon Planin nacional aksionar për parandalimin e kriminalitetit kundër trashëgimisë kulturore dhe e koordinon zbatimin e tij;

8. E propozon listën e prioriteteve nga neni 110 i këtij ligji;

9. E koordinon bashkëpunimin e ndërsjellë në lidhje me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;

10. Formon bordet për trashëgiminë jomateriale, të patundshme dhe atë të tundshme kulturore si dhe trupat këshillues dhe

11. Formon këshillin koordinues për mbrojtjen e të mirave kulturore në rast të konfliktit të armatosur dhe trupat tjerë ndihmës të përhershme dhe të përkohshme. “

(2) Pikat 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18 bëhen pika 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24 dhe 25

(3) Në pikën 18, që bëhet pika 25, fjala "kryen" zëvendësohet me fjalët: "organizon kryerjen e"

(4) Në paragrafin (3) pika në fund të fjalisë fshihet dhe shtohen fjalët: "nëpërmjet komisionit profesional që e emëron ministri i Kulturës, i përbërë nga persona profesionalë nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore." Komisioni përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë, me mandat prej tre vitesh."

Neni 61

Në nenin 146 paragrafi (4) pika 4 fjalët: "e objekteve që janë lëndë e konservimit" fshihen.

Në paragrafin (4) pas pikës 10 shtohet pika e re 11 si vijon:

„11. E përcjell gjendjen e trashëgimisë së patundshme kulturore që gjendet në rajonin e komunave për të cilat është kompetent, dhe për çdo ndryshim të të mirave të mbrojtura e njofton Drejtorinë në afat prej dy ditëve nga dita e konstatimit të ndryshimit.“

Pikat 11, 12 dhe 13 bëhen pika 12, 13 dhe 14.

Neni 62

Në nenin 147 paragrafi (3) në pikën 3 fjalët: "një person me status të hulumtuesit të autorizuar dhe" fshihen.

Neni 63

Në nenin 149 paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Institucionet kompetente amë për mbrojtjen e trashëgimisë së tundshme kulturore sipas llojit të lëndës janë: Institucion Nacional "Muzeu i Maqedonisë" - Shkup, Institucioni Nacional "Muzeu i Arteve Bashkëkohore" - Shkup dhe Institucioni Nacional "Muzeu Arkeologjik i Maqedonisë" - Shkup.“

Neni 64

Në nenin 150 fjalia hyrëse ndryshohet si vijon: "Muzetë amë i kryejnë këto punë:"

Neni 65

Në titullin e nenit 157 dhe në nenin 157 paragrafi (1) fjalët: "të qytetarëve" fshihen.

Neni 66

Në paragrafin 158 në paragrafin (2) numri "14" zëvendësohet me numrin "11"

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

"Anëtarët e Këshillit Nacional emërohen nga radhët e individëve të dalluar nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Për anëtar të Këshillit Nacional mund të emërohet person me titull shkencor të lëndës për mbrojtje të trashëgimisë kulturore ose person me titull profesional nga sfera e trashëgimisë kulturore. Gjatë emërimit të Këshillit Nacional mbahet llogari për përfaqësimin e drejtë dhe adekuat të bashkësive në Republikën e Maqedonisë."

Neni 67

Në nenin 159 paragrafi (1) pika 2 fjala "propozon" zëvendësohet me fjalët: "jep mendim".

Pika 5 ndryshohet si vijon:

„Me kërkesë të Drejtorisë, jep mendim për lëshim të lejeve për nxjerrjen e trashëgimisë kulturore jashtë vendit dhe për lëshimin e vërtetimit për eksport të sendeve që nuk kanë status të të mirës së mbrojtur sipas dispozitave të këtij ligji.“

Pika 10 ndryshohet si vijon:

„10. Jep drejtime/rekomandime për përpunimin e projekteve/programave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale.“

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

"(3) Këshilli Nacional mund të formojë edhe këshilla të veçantë këshillues për trashëgiminë e patundshme, të tundshme dhe jomateriale kulturore."

Neni 68

Në nenin 162 paragrafi (1) pika 2 pas fjalëve: "arsim i lartë" shtohen fjalët: "ose arsim sipëror me së paku 180 kredi sipas SETK-së".

Në pikën 3 pas fjalëve: "arsim i lartë" shtohen fjalët: "ose së paku 240 kredi të fituara sipas SETK-së".

Neni 69

Në nenin 163 paragrafi (1) numri "160" zëvendësohet me numrin "161".

Neni 70

Neni 164 ndryshohet si vijon:

“(1) Me titull të zgjedhur profesional konservator i lartë, përkatësisht dokumentues i lartë mund të zgjidhet personi i zgjedhur i cili ka:

- së paku pesë vjet përvojë pune si konservator, përkatësisht dokumentues ose së paku tre vjet përvojë pune si konservator, përkatësisht dokumentues dhe ka përfunduar magjistraturë, përkatësisht studime të doktoraturës nga sfera përkatëse dhe

- provim të dhënë profesional për konservator të lartë, përkatësisht dokumentues të lartë.

(2) Me titull të zgjedhur profesional konservator - këshilltar, përkatësisht dokumentues-këshilltar, mund të jetë i zgjedhur person i cili ka:

- pesë vjet përvojë pune si konservator i lartë, përkatësisht dokumentues i lartë dhe

- kontribut profesional në punët e mbrojtjes, përkatësisht dokumentacionit të cilat mund të shprehen me më së paku 250 pikë në pajtim me aktin nga neni 166 i këtij ligji.

(3) Personat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni rizgjidhen në çdo pesë vjet.

(4) Në titullin profesional konservator i lartë, përkatësisht dokumentues i lartë mund të rizgjidhet person i cili ka dhënë kontribut profesional në punën e mbrojtjes, përkatësisht dokumentacionit, e cila mund të shprehet me më së paku 150 pikë në pajtim me aktin nga neni 166 i këtij ligji.

(5) Në titullin profesional konservator-këshilltar, përkatësisht dokumentues-këshilltar mund të rizgjidhet person i cili ka dhënë kontribut profesional në punën e mbrojtjes, përkatësisht dokumentimit e cila mund të shprehet me më së paku 250 pikë në pajtim me aktin nga neni 166 të këtij ligji.

(6) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni, personat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni të cilët kanë edhe dhjetë vjet deri në realizimin e të drejtës së pensionit, nuk nënshtrohen në rizgjedhje”.

Neni 71

Titulli para nenit 165 dhe neni 165 ndryshohen si vijojnë:

“Procedura për dhënie të provimit profesional për zgjedhje dhe rizgjedhje në tituj profesionalë

Neni 165

(1) Zgjedhjen dhe rizgjedhjen në tituj të zgjedhur profesionalë nga neni 164 i këtij ligji i kryen ministri i Kulturës në bazë të propozimit të komisionit recensues.

(2) Komisioni recensues është i përbërë nga kryetari dhe gjashtë anëtarë të cilët i emëron ministri i Kulturës me mandat prej dy vitesh. Për kryetar dhe anëtarë të komisionit recensues mund të emërohen punëtorë shkencorë me titull doktor i shkencave nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore ose persona me titull profesional konservator-këshilltar, përkatësisht dokumentues-këshilltar. Gjatë emërimit të komisionit të recensimit mbahet llogari për përfaqësimin e drejtë dhe adekuat të bashkësive në Republikën e Maqedonisë.

(3) Komisioni recensues:

- konstaton nëse personat i plotësojnë kushtet për dhënie të provimit profesional për zgjedhje, përkatësisht rizgjedhje në titull profesional me këtë ligj dhe me akte të nenit 166 të këtij ligji;

- e vlerëson dhënien e provimit profesional nga neni 164 paragrafi (1) të këtij ligji;

- e kryen dhënien e pikëve nga neni 164 paragrafët (2), (4) dhe (5) të këtij ligji dhe

- i dorëzon ministrit të Kulturës propozim për zgjedhje/moskryerje të zgjedhjeve, përkatësisht rizgjedhje/moskryerje të rizgjedhjes në titull profesional.

(4) Komisioni recensues, propozimin nga paragrafi (3) alineja 4 të këtij neni ia dorëzon ministrit të Kulturës në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës për zgjedhje, përkatësisht për rizgjedhje në titull profesional.

(5) Propozimi nga paragrafi (3) alineja 4 të këtij neni përmban: të dhëna biografike për kandidatin, vlerësim të plotësimit të kushteve për zgjedhje, përkatësisht rizgjedhje në titull profesional, vlerësim të zgjedhjes në titull profesional sipas rezultateve nga provimi profesional dhe vlerësim për zgjedhje, përkatësisht rizgjedhje në titull profesional në pajtim me pikët e mara nga akti nga neni 166 i këtij ligji.

(6) Procedura për zgjedhje dhe rizgjedhje në titull profesional zgjat më së gjati dy muaj.

(7) Ministri i Kulturës në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të propozimit nga komisioni recensues miraton aktvendim për zgjedhje/ moskryerje të zgjedhjes përkatësisht rizgjedhje/ moskryerje të rizgjedhjes në titull profesional.

(8) Kundër aktvendimit mund të deklarohet ankesë në afat prej 15 ditësh te Komisioni Shtetëror për Vendorsje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë. Ankesa nuk e prolongon zbatimin.

(9) Punët administrative teknike për komisionin recensues i kryen Ministria e Kulturës.”

Neni 72

Pas nenit 165 shtohen titull i ri dhe nen i ri 165-a, si vijojnë:

“Ngritja e procedurës për zgjedhje dhe rizgjedhje në titull profesional

Neni 165-a

(1) Procedura për zgjedhje në titull profesional ngrihet me kërkesë të punëtorit të interesuar profesional.

(2) Nëse punëtori profesional nuk zgjidhet në titull profesional për shkak të mosplotësimit të kushteve për zgjedhje në titull profesional, ka të drejtë në afat prej gjashtë muajsh të dorëzojë kërkesë të re për zgjedhje në titull profesional.

(3) Procedurën për rizgjedhje në titull profesional e ngre drejtori i institucionit publik për mbrojtje, më së voni në afat prej tre muaj para përfundimit të afatit për rizgjedhje.

(4) Nëse punëtori profesional nuk rizgjidhet në titullin profesional për shkak të mosplotësimit të kushteve për rizgjedhje në titullin profesional të përcaktuara me këtë ligj, ka të drejtë në afat prej gjashtë muajsh për rizgjedhje të sërishme, ndërsa vazhdon me punë në vendin e njëjtë të punës me titullin e njëjtë profesional.

(5) Nëse edhe për herë të dytë nuk është i rizgjedhur, punëtori profesional e humb titullin profesional paraprakisht të fituar dhe në afat prej 30 ditësh me aktvendim të drejtorit sistematizohet në vend tjetër të punës në titull më të ultë profesional nga titulli profesional paraprakisht i fituar. Punëtori profesional, në afat prej gjashtë muajsh nga dita e sistematizimit në vend tjetër të punës në titull më të ulët profesional, ka të drejtë të parashtrojë kërkesë të re për zgjedhje në titull më të lartë profesional nga ai ekzistues, në procedurë në pajtim me këtë ligj.

(6) Kundër aktvendimit nga paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni, punëtori profesional në afat prej 15 ditësh ka të drejtë ankesë te bordi drejtues i institucionit publik për mbrojtje. Bordi drejtues vendos për ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

(7) Kundër vendimit të bordit drejtues mund të deklarohet padi te gjykata kompetente. Ankesa nuk e prolongon zbatimin.”

Neni 73

Neni 166 ndryshohet si vijon:

“Ministria e Kulturës i përcakton përkatësinë e llojit të arsimit dhe përshkrimin e titullit profesional në sferën e veprimtarisë së përmendoreve dhe mbrojtjen e drejtpërdrejtë në veprimtaritë për mbrojtje të trashëgimisë së tundshme kulturore, programin për dhënie të provimit profesional dhe mënyrën e përcaktimit të pikëve të zgjedhjes, përkatësisht rizgjedhjes në titujt profesionalë.”

Neni 74

Në nenin 168 paragrafi (1) pikën 7 fjalët: “neni 77”, shlyhen ndërsa, fjalët: “neni 93 paragrafi (1)” zëvendësohen me fjalët: “neni 93 paragrafi (2)”.

Pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj, (3) dhe (4), si vijojnë:

“(3) Inspektori është i obliguar së paku dy herë në vit të kryejë mbikëqyrje në institucionet publike për mbrojtje, në aspekt të zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe rregulla tjera nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, me përjashtim të mbikëqyrjes inspektuese në Arkiv.

(4) Inspektori është i obliguar të kryejë mbikëqyrje:

- në çdo ndërmarrje të masave të mbrojtjes së ndërsjellë të trashëgimisë së patundshme kulturore për të cilën është dhënë leje e konservatoit nga Drejtoria dhe
- mbi çdo kryerje të hulumtimeve arkeologjike për të cilat është dhënë leje nga Drejtoria.”

Neni 75

Në nenin 171-a alineja 1 ndryshohet si vijon:

“- kur ajo është e domosdoshme për shkak të ndërprerjes së punëve të ndërtimit të cilat realizohen në kundërshtim me lejen e dhënë të konservatorit ose të projektit të konservatorit dhe”.

Neni 76

Në nenin 171-b në paragrafin (3) fjalët: “Ministria e Kulturës” zëvendësohen me fjalën “Drejtoria”.

Neni 77

Në nenin 172 në paragrafi (1) pika 3 shlyhet.

Pikët 4, 5, 6 dhe 7 bëhen pikë 3, 4, 5 dhe 6.

Në pikën 8 e cila bëhet pikë 7 pas fjalës “leje” shtohen fjalët: “ose punët e mbrojtjes së ndërsjellë kryhen nga person i cili nuk është i autorizuar për kryerje të punëve të mbrojtjes së ndërsjellë, ndërsa fjala në kllapë “87” zëvendësohet me fjalët: “87 paragrafi (1)”.

Pikët 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18 bëhen pikë 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 17.

Në paragrafin (3) numrat: „1, 2, 3, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18“ zëvendësohen me numrat: „1, 2, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 17“.

Neni 78

Pas nenit 172 shtohet nen i ri 172-a, si vijon:

“Neni 172 - a

Gjobë në shumë prej 1 500 deri në 3 000 euro në kundërvlerë me denarë do të shqiptohet për kundërvajtje të personit përgjegjës, përkatësisht personit zyrtar në Drejtori nëse:

1. nuk i mban evidencat qendrore dhe të veçanta dhe kadastrën arkeologjike (neni 34 paragrafi (5));

2. nuk e mban Regjistrin (neni 45 paragrafi (5));

3. nuk ngre procedurë të kundërvajtjes kundër bartësit të lejes për hulumtime arkeologjike dhe udhëheqësit profesional të cilët, pas përfundimit të punëve në afatin e përcaktuar me ligj, te Drejtoria nuk do të dorëzojnë raport për hulumtime arkeologjike, nuk do të dorëzojnë ekzemplar nga dokumentacioni final, nuk do t'i shpallin rezultatet nga hulumtimet arkeologjike dhe nuk do t'i dorëzojnë konstatimet të tundshme të muzeut (neni 59 paragrafi (3));

4. lëshon leje për përdorim të pajisjes për detektim pa pajtim të ministrit të Kulturës (neni 63 paragrafi (2));

5. nuk mban evidencë për lejet e lëshuara për përdorim të pajisjes për detektim (neni 63 paragrafi (7));

6. nuk e njofton organin i cili e ka lëshuar lejen për ndërtim dhe nuk kërkon nga inspeksioni i ndërtimit ndërprerje të përkohshme në rast kur investitori i realizon punët në kundërshtim me dokumentacionin e projektit dhe të dokumentacionit tjetër teknik (nenin 81 paragrafi (1));

7. nuk ngre procedurë të kundërvajtjes kundër bartësit të lejes së konservatorit i cili në afat të përcaktuar me ligj nuk do të parashtrojë raport dhe nuk do t'ia dorëzojë dokumentacionin final Drejtorisë (neni 84 paragrafët (1) dhe (2));

8. nuk mban evidencë të veçantë për koleksionuesit dhe për përmbljedhet e mbrojtura private (neni 93 paragrafi (4));

9. jep leje për nxjerrje të trashëgimisë kulturore jashtë nga institucioni pa mendimin paraprak të Ministrisë së Kulturës (nenin 95-a paragrafi (2));

10. lëshon leje për përpunimin e kopjes të trashëgimisë kulturore pa mendim të Ministrisë së Kulturës (nenin 95-b paragrafi (2));

11. nuk e njofton publikun për të mirat nga neni 97 paragrafi (11) të këtij ligji (neni 97 paragrafi (11));

12. nuk e njofton organin doganor për çdo aktvendim të miratuar për ndalim për eksport ose për leje të lëshuar, përkatësisht vërtetim për nxjerrje ose eksport (neni 98 paragrafi (1));

13. nuk e mban Sistemin informativ në pajtim me këtë ligj (neni 115);

14. dy herë në vit nuk realizon kontroll në punën e institucioneve publike për mbrojtje (neni 168 paragrafi (3));

15. nuk kryen mbikëqyrje në çdo ndërmarrje të masave të mbrojtjes së drejtpërdrejtë të trashëgimisë të patundshme kulturore për të cilën është dhënë leje e konservatorit nga Drejtoria (neni 168 paragrafët (4) alineja 1);

16. nuk kryen mbikëqyrje në çdo realizim të hulumtimeve arkeologjike për të cilën është lëshuar leje nga Drejtoria (neni 168 paragrafi (4) alineja 2)”.

Neni 79

Neni 173 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 2 000 deri në 2 500 euro në kundërvlerë me denarë do të shqiptohet për kundërvajtje personit juridik që:

1. nuk e përpunon në mënyrë plotësuese në pajtim me vërejtjet e Drejtorisë në afat prej 30 ditësh (neni 35 paragrafi (7));

2. nuk miraton plan për menaxhim në afat prej gjashtë muajsh nga dita e miratimit të aktit për mbrojtje (neni 42-a paragrafi (5));

3. nuk i ndërmer masat e domosdoshme për sigurim teknik të vendit të gjetjes dhe rregullim të rrethin e vet të drejtpërdrejtë para lëshimit të terrenit (neni 59 paragrafi (2) pika 1);

4. nuk e kthen gjendjen paraprake në terrenin në të cilin janë kryer hulumtime arkeologjike, para lëshimit të terrenit, nëse vendi i gjetjes nuk konservohet ose prezantohet (neni 59 paragrafi (2) pika 2);

5. në afatin e caktuar nuk dorëzon raport për hulumtimet arkeologjike (nenin 59 paragrafi (3) pika 1);

6. në afatin e caktuar nuk e dorëzon dokumentacionin final për hulumtime arkeologjike (nenin 59 paragrafi (3) pika 2);

7. në afatin e caktuar nuk i shpall rezultatet nga hulumtimet arkeologjike (nenin 59 paragrafi (3) pika 3);

8. nuk ia dorëzon konstatimet e tundshme muzeut të caktuar në afatet të përcaktuara ligjore (neni 59 paragrafi (3) pika 4);

9. nuk e respekton të drejtën e pronësisë shkencore (neni 62 paragrafi (2) pikat 2 dhe e);

10. përdor detektorë të metalit dhe pajisje tjetër për detektim gjatë hulumtimeve arkeologjike pa leje për përdorim ose pajisjen e tillë e përdor për realizim ose nxitje të gërmimeve të palejuara (nenin 63 paragrafët (1) dhe (3));

11. nuk i dorëzon sendet rastësisht të zbuluara të mara nga vendi ku janë gjetur ose nuk i ndërmerr masat të domosdoshme të sigurohet mbrojtja e tyre nga prishja ose tjetërsimi (neni 65 paragrafi (2) pika 1);

12. nuk i jep të dhënat relevante në lidhje me vendin, pozitën e sendeve, kohën e gjetjes së rastësishme dhe rrethanat në të cilat është bërë ajo (neni 65 paragrafët (2) pika 2);

13. nuk e miraton aktin për mbrojtje të të mirës në afat prej një viti nga dita e miratimit të planit (neni 70 paragrafi (4));

14. për përpilimin e projekt-planit hapësinor dhe urbanistik shfrytëzon baza mbrojtëse-të konservatorit të cilat nuk janë lejuar dhe në rregull të verifikuara nga Drejtoria (neni 71 paragrafët (6));

15. nuk parashtron raport për hulumtime të kryera të konservatorit dhe nuk e dorëzon dokumentacionin final në afatet e përcaktuara me ligj (neni 84);

16. nuk kryen kontroll profesional të projektit të konservatorit (neni 86 paragrafi (1));

17. nuk vepron për vërejtjet e dhëna në raport për kontrollin e kryer profesional të projektit të konservatorit (neni 86 paragrafi (5));

Судот доколку оцени дека постои некоја од горенаведените околности при одмерувањето на казната, а во рамки на иста категорија, ќе го класифицира кривичното дело во построгите вертикални колони, при што не може да се движи повеќе од две колони во десно од колоната во која е основната класификација на делото.

По извршената рекласификација предметот според објективната категоризација на кривичното дело спаѓа во _____ хоризонтална категорија.

Според податоците за поранешниот живот на сторителот предметот спаѓа во _____ вертикална колона, за која е предвидена казна од _____ со средна вредност од _____.

6. При изрекувањето на кривична санкција за кривични дела за кои на обвинетиот истовремено му се суди, судот претходно ќе ги утврди казните за секое од тие дела во согласност со одредбите од овој закон а потоа за сите дела ќе изрече единствена казна со примена на одредбата од чл.44 од КЗ.

L I G J PËR ÇAKTIMIN E LLOJIT DHE MATJEN E LARTËSISË SË DËNIMIT

I. DISPOZITA THEMELORE

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet çaktimi i llojit dhe matja e dënimit, marrëveshja për llojin dhe lartësinë e dënimit ndërmjet prokurorit publik dhe të akuzuarit në kuadër të marrëveshjes si dhe formimi, përbërja, mandati dhe kompetencat e Komisionit për Barazim të Politikës Ndëshkuese.

Neni 2

Qëllimi i ligjit është barazimi i politikës ndëshkuese gjatë shqiptimit të dënimeve nga gjykatat në Republikën e Maqedonisë nëpërmjet përcaktimit të kritereve objektive për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit.

Neni 3

- Ligji bazohet në parimet në vijim:
- Ligjshmëri,
- Individualizim i dënimit,
- Proporcionalitet i dënimit me veprën penale të kryer,
- Efikasitet,
- Barazim i politikës ndëshkuese dhe
- Transparencë.

II. KOMISIONI PËR BARAZIM TË POLITIKËS NDËSHKUESE

Neni 4

Themelohet Komisioni për barazim të politikës ndëshkuese (në tekstin e mëtejme: Komisioni).

Komisioni është trup i pavarur dhe këshillëdhënës i cili kujdeset për barazimin e politikës ndëshkuese në shqiptimin e dënimeve përmes propozimit të kritereve për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit.

Neni 5

Komisioni përbëhet nga shtatë anëtarë të cilët i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me mandat prej katër vitesh, me të drejtë të zgjedhjes së sërishme nga të cilët:

- dy anëtarë zgjidhen me propozim të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë, nga radhët e prokurorëve publikë me së paku 10 vite përvojë pune në materien penale,
- dy anëtarë zgjidhen me propozim të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, nga radhët e gjykatësve me së paku 10 vite përvojë pune në materien penale,
- një anëtar zgjidhet me propozim të Dhomës së Avokatëve të Maqedonisë, nga radhët e avokatëve me së paku 10 vite përvojë pune në materien penale,
- një anëtar zgjidhet me propozim të ministrit të Drejtësisë, nga radhët e profesorëve të ordinarë ose inordinarë për lëndët nga sfera ndëshkuese dhe
- një anëtar zgjidhet me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, nga radhët e profesorëve ordinarë ose inordinarë për lëndët nga sfera ndëshkuese.

Komisioni ka seli në Ministrinë e Drejtësisë dhe në raportet me organet tjera dhe personat paraqitet me logon e vet, që e përcakton Komisioni.

Nga radhët e anëtarëve të zgjedhur, Komisioni zgjedh kryetar me mandat prej dy viteve, me të drejtë të zgjedhjes së sërishme.

Mandati i anëtarit të Komisioni i pushon para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhur:

- me kërkesë personale,

- për shkak të vdekjes dhe
- nëse e humb përgjithmonë aftësinë për kryerjen e funksionit.

Plotësimin e kushteve nga paragrafi 4 i këtij neni i përcakton Komisioni me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve dhe parashtron iniciativë për ndërprerjen e mandatit të Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

Gjatë zgjedhjes së anëtarëve të komisionit, pa u cenuar kriteret e parapara me këtë ligj, sigurohet përfaqësim i drejtë dhe adekuat i qytetarëve të cilët u takojnë të gjitha bashkësive në Republikën e Maqedonisë.

Neni 6

Komisioni i ka kompetencat në vijim:

- e ndjek dhe analizon politikën ndëshkuese të gjykatave në Republikën e Maqedonisë, në kuptim të qëllimeve të dënimit (përkatesisht, dënimin e përcaktuar, dënimin që kanoset, aftësinë për faj, parandalimin dhe rehabilitimin, si dhe aktgjykimet e miratuara në bazë të marrëveshjes ndërmjet prokurorit publik dhe të akuzuarit);
- propozon masa për garantimin e sigurisë dhe drejtësisë në plotësimin e qëllimeve të dënimit, për shmangie të disparitetit të paarsyeshëm ndërmjet kryerësve të veprave penale me karakteristika të ngjashme të gjykuar për vepra penale të njëjta ose të ngjashme (sipas kategorizimit objektiv për vepra penale në pajtim me këtë ligj), me respektimin e dispozicionit të gjykatës gjatë vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese;
- dorëzon propozime te Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë për ndryshim dhe plotësim të Kodit penal dhe të këtij ligji;
- dorëzon raport vjetor te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë;
- te Ministria e Drejtësisë dorëzon raporte gjashtëmujore për çështje në kompetencë të vet, për çka Ministria e njofton Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe
- dorëzon njoftime te Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, Këshilli i Prokurorëve Publikë, te Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë dhe Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë për zbatimin e këtij ligji sipas gjykatave dhe jep propozime dhe sugjerime për mënyrën e barazimit të politikës ndëshkuese.

Neni 7

Punët administrative të Komisioni i kryen Ministria e Drejtësisë.

Mjetet për realizimin e programit, si dhe për punën e Komisionit sigurohet në suaza të mjeteve financiare nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë.

Anëtarët e Komisionit të cilët janë nga brendia e Republikës së Maqedonisë, respektivisht jashtë Qytetit të Shkupit kanë të drejtë të kompensimit përkatës të shpenzimeve të rrugës.

Anëtarët e Komisionit kanë të drejtë të kompensimit mujor për punën në Komisioni në lartësinë e një rrugë mesatare bruto mujore të paguar në muajin paraprak në nivel të Republikës së Maqedonisë.

Neni 8

Komisioni miraton Statut dhe Program për punë për çdo punë rrjedhëse.

Me Statutin rregullohen:

- organizimi i brendshëm dhe mënyra e kryerjes së punës së Komisionit,
- udhëheqja me Komisionin,
- të drejtat dhe obligimet e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit dhe
- përdorimi i mjeteve për punë të Komisionit.

III. PËRCAKTIMI I LLOJIT DHE MATJA E
LARTËSISË SË SANKSIONEVE PENALE

Neni 9

Përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së sanksioneve penale gjykatësi i kryen në bazë të kriterëve objektivë në vijim:

1. kategorizimi objektiv i veprës penale dhe
2. jeta e mëparshme e kryerësit të veprës penale.

Neni 10

Veprat penale të përcaktuara në Kodin penal dhe në ligje tjera materiale kategorizohen në kategoritë horizontale në vijim:

- I. dënim me para,
- II. dënim me para ose burg deri në 3 muaj,
- III. dënim me para ose burg deri në 6 muaj,
- IV. burg deri në 6 muaj,
- V. dënim me para ose burg deri në 1 vit,
- VI. burg deri në 1 vit dhe dënim me para,
- VII. dënim me para ose burg nga 3 muaj deri në 1 vit,
- VIII. burg prej 3 muaj deri në 1 vit,
- IX. dënim me para ose burg prej 6 muaj deri në 1 vit,
- X. burg prej 6 muaj deri në 1 vit,
- XI. dënim me para ose burg deri në 3 vite,
- XII. burg deri në 3 vite dhe dënim me para,
- XIII. dënim me para ose burg prej 3 muaj deri në 3 vite,
- XIV. burg prej 3 muaj deri në 3 vite,
- XV. dënim me burg prej 6 muaj deri në 2 vite dhe dënim me para,
- XVI. dënim me para ose burg prej 6 muaj deri në 3 vite
- XVII. burg prej 6 muaj deri në 3 vite,
- XVIII. dënim me burg prej 6 muaj deri në 3 vite dhe dënim me para,
- XIX. dënim me para ose burg prej 1 deri në 3 vite,
- XX. burg prej 1 deri në 3 vite,
- XXI. dënim me para ose burg deri në 4 vite,
- XXII. dënim me para ose burg deri në 5 vite,
- XXIII. burg deri në 5 vite dhe dënim me para,
- XXIV. burg prej 3 muaj deri në 5 vite,
- XXV. dënim me para ose burg prej 6 muaj deri në 5 vite,
- XXVI. burg prej 6 muaj deri në 5 vite,
- XXVII. burg prej 6 muaj deri në 5 vite dhe dënim me para,
- XXVIII. dënim me para ose burg prej 1 deri në 5 vite,
- XXIX. burg prej 1 deri në 5 vite,
- XXX. burg prej 1 deri në 5 vite dhe dënim me para,
- XXXI. burg prej 3 deri në 5 vite,
- XXXII. burg prej 3 muaj deri në 6 vite ose dënim me para,
- XXXIII. burg prej 1 deri në 8 vite,
- XXXIV. burg prej 1 deri në 8 vite dhe dënim me para,
- XXXV. burg prej 3 deri në 8 vite,
- XXXVI. burg prej 5 deri në 8 vite,
- XXXVII. dënim me para ose burg prej 1 deri në 10 vite,
- XXXVIII. burg prej 1 deri në 10 vite,
- XXXIX. burg prej 1 deri në 10 vite dhe dënim me para,
- XL. burg prej 3 deri në 10 vite,
- XLI. burg prej 4 deri në 10 vite,
- XLII. burg prej 5 deri në 10 vite,
- XLIII. së paku 1 vit burg,
- XLIV. së paku 2 vite burg,
- XLV. dënim me para ose burg prej së paku 3 vite,
- XLVI. së paku 3 vite burg,
- XLVII. së paku 4 vite burg,

- XLVIII. së paku 4 vite burg ose dënim me para,
- XLIX. së paku 5 vite burg,
- L. së paku 8 vite burg,
- LI. së paku 10 vite burg,
- LII. së paku 12 vite burg,
- LIII. së paku 5 vite burg ose burg të përjetshëm,
- LIV. së paku 10 vite burg ose burg të përjetshëm dhe
- LV. së paku 15 vite burg ose burg të përjetshëm.

Neni 11

Kriteri për jetën e mëparshme të kryerësit të veprës penale përcaktohet në bazë të kategorive vertikale në vijim:

- I. i padënuar
 - II. deri në dy aktgjykime të plotfuqishme për vepra penale për të cilat është paraparë dënim me para ose dënim me burg deri në 5 vjet
 - III. deri në dy aktgjykime të plotfuqishme nga të cilat të paktën njëra është për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg mbi 5 vjet
 - IV. tre aktgjykime të plotfuqishme ose dy aktgjykime me dënim të shqiptuar efektiv me burg mbi 6 muaj ose një aktgjykim me dënim të shqiptuar efektiv me burg prej së paku 3 vjet
 - V. katër aktgjykime të plotfuqishme ose dy aktgjykime me dënim të shqiptuar me burg prej së paku dy vjet ose një aktgjykim me dënim të shqiptuar me burg prej së paku 5 vjet
 - VI. pesë ose më shumë aktgjykime të plotfuqishme ose dy aktgjykime prej së paku 5 vjet burg ose një aktgjykim prej së paku 8 vjet burg
- Në këtë kriter bëjnë pjesë edhe gjykimet të cilat janë parashkruar në fazë të përmbartimit.
- Në këtë kriter nuk bëjnë pjesë gjykimet e shlyera si dhe gjykimet me dënim me burg deri në tre vjet për të cilat në pajtim me ligj janë plotësuar kushtet për shlyerjen e tyre.

Neni 12

Në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenet 10 dhe 11 të këtij ligji, në çdo rend horizontal janë dhënë kufijtë minimalë dhe maksimalë të dënimeve të cilat do të mund t'i shqiptohen kryerësit të veprës penale (në muaj), varësisht nga ajo se në cilën kategori vertikale kryerësi do të klasifikohet, nëse gjykata jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm konstaton se kryerësi e ka kryer veprën penale, që i ngarkohet.

Në çdo kategori vertikale është përcaktuar vlera e mesme e lartësisë së dënimit (në muaj), nga e cila gjykata do të fillojë t'i llogaritë rrethanat lehtësuese dhe rënduese në bazë të së cilës do ta individualizojë lartësinë e dënimit për kryerës konkret.

Kriteret e përpunuara nga paragrafi 1 të këtij neni janë dhënë në tabelën e përmbajtur në shtojcën numër 1 e cila është pjesë përbërëse e këtij ligji.

Neni 13

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese llogariten me shtimin respektivisht heqjen e pikëve, me ç'rast baza fillestare paraqet vlerë të mesme të lartësisë së përcaktuar të dënimit në çdo kategori vertikale në pajtim me tabelën e përmbajtur në Shtojcën numër 1.

Neni 14

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë mbi lartësinë e dënimit janë grupuar në kategoritë në vijim:

- I. Shkalla e përgjegjësisë penale,
- II. Motivet nga të cilat është kryer vepra penale,

III. Forca e rrezikimit ose cenimit të së mirës mbrojtëse,

IV. Rrethanat në të cilat është kryer vepra,

V. Kontributi i viktimës në kryerjen e veprës,

VI. Jeta e mëparshme e kryerësit,

VII. Rrethanat personale dhe sjellja pas kryerjes së veprës penale,

VIII. Rrethana tjera që kanë të bëjnë me personalitetin e kryerësit dhe

IX. Vepra e mëparshme është nga lloji i njëjtë i veprës së re, veprat janë kryer nga motivet e njëjta, koha e kaluar nga gjykimi paraprak, respektivisht nga dënimi i vuajtur ose i falur.

Lista e rrethanave lehtësuese dhe rënduese në të cilën është kryer ndarja e pikëve në mënyrë individuale në çdo rrethanë është dhënë në tabelën e përmbajtur në Shtojcën 2 e cila është pjesë përbërëse e këtij ligji.

Neni 15

Gjatë përlogaritjes së rrethanave lehtësuese dhe rënduese, si dhe gjatë përcaktimit të llojit dhe matjes së lartësisë së dënimit, gjykatësit i shfrytëzojnë fletët e punës të cilat janë pjesë përbërëse nga shkresat e lëndës dhe janë dhënë në Shtojcën numër 3, Shtojcën numër 4 dhe Shtojcën numër 5 të cilat janë pjesë përbërëse e këtij ligji.

Neni 16

Nëse gjykata përcakton dënim me burg në kohëzgjatje deri në 24 muaj, ndërsa gjatë evaluimit në vëllim të konsiderueshëm dominojnë rrethana lehtësuese, me ç'rast dallimi është së paku 5 pikë në dobi të rrethanave lehtësuese, mundet dënimin e përcaktuar të këtillë me burg ta kushtëzojë ose të zbatojë ndonjë nga masat tjera alternative të parapara në nenin 48-a të Kodit pena, nëse vlerëson se edhe me gjykimin e shqiptuar me kusht ose masës tjerë alternative do të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të preventimit special dhe të përgjithshëm.

Neni 17

Për vepra penale të personave juridikë si dënim kryesor shqiptohet dënim me para.

Dënimi me para shqiptohet në shumë që nuk mund të jetë më e vogël se 100 000 denarë, as më e madhe se 30 milionë denarë.

Për vepra penale të kryera nga lakmia, si dhe për vepra penale me të cilat realizohet dobi ose shkaktohet dëm me përmasa të mëdha, mund të shqiptohet dënim me para deri në shumën e dyfishtë të maksimumit të këtij dënimi ose në përmasa me lartësinë e dëmit të shkaktuar, përkatësisht dobinë e realizuar, por më së shumti deri në shumën e tyre të dhjetëfishtë.

Neni 18

Gjatë matjes së dënimit gjykata do ta marrë parasysh bilancin e gjendjeve dhe bilancin e suksesit të personit juridik, llojin e veprimtarisë, natyrën dhe peshën e veprës së kryer.

Nëse gjykata përcakton dënim me para për dy ose më shumë vepra në varg, dënimi i vetëm nuk mund ta tejkalojë shumën e dënimeve të përcaktuara në mënyrë individuale, as ta tejkalojë maksimumin ligjor të dënimit të përcaktuar për personin juridik.

Neni 19

Për veprat penale për të cilat është përcaktuar dënim me para ose dënim me burg deri në tri vite, personi juridik dënohet me dënim me para deri 500 000 denarë ose, nëse

vepra është kryer nga lakmia ose është shkaktuar dëm me përmasa të mëdha më së shumti deri në shumën e dyfishtë të dëmit të shkaktuar ose të dobisë së realizuar.

Për veprat penale për të cilat është përcaktuar dënim me burg prej së paku tre vite, personi juridik dënohet me dënim me para deri një milion denarë ose, nëse vepra është kryer nga lakmia ose është shkaktuar dëm me përmasa të mëdha më së shumti deri në shumën e pesëfishtë të dëmit të shkaktuar ose të dobisë së realizuar.

Për veprat penale për të cilat është përcaktuar dënim me burg prej së paku katër vite, personi juridik dënohet me dënim me para së paku 500 000 denarë ose, nëse vepra është kryer nga lakmia ose është shkaktuar dëm me përmasa të mëdha më së shumti deri në shumën e pesëfishtë të dëmit të shkaktuar ose të dobisë së realizuar.

Për veprat penale për të cilat është përcaktuar dënim me burg prej së paku pesë vite, personi juridik dënohet me dënim me para së paku një milion denarë ose, nëse vepra është kryer nga lakmia ose është shkaktuar dëm me përmasa të mëdha deri në shumën e dhjetëfishtë të dëmit të shkaktuar ose të dobisë së realizuar.

IV. MARRËVESHJA PËR LLOJIN DHE LARTËSINË E DËNIMIT NDËRMJET PROKURORIT PUBLIK DHE TË AKUZUARIT NË KUADËR TË MARRËVESHJES

Neni 20

Gjatë marrëveshjes së prokurorit publik dhe të akuzuarit gjatë procedurës së hetimit dhe në procedurë të shkurtuar deri në parashtrim të propozim-akuzës, nuk mund të kontraktohet dënim më i vogël se 50% i dënimit që do të shqiptohet me aplikimin e dispozitave të këtij ligji në procedurë të rregullt gjyqësore.

Gjatë marrëveshjes së prokurorit publik dhe të akuzuarit në fazën e vlerësimit të akt-akuzës, nuk mund të kontraktohet dënim më i vogël se 60% e dënimit që do të shqiptohet me aplikimin e dispozitave të këtij ligji në procedurë të rregullt gjyqësore.

V. PRANIMI I FAJIT GJATË DEBATIT KRYESOR

Neni 21

Gjatë debatit kryesor, pas mbajtjes së fjalimeve hyrëse të palëve, nëse i akuzuari e pranon fajin gjykata nuk mund t'i shqiptojë të akuzuarit dënim më të vogël se 70% të dënimit që do të shqiptohet me aplikimin e dispozitave të këtij ligji në procedurë të rregullt gjyqësore.

VI. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 22

Komisioni do të formohet në afat prej tre muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 23

Me fillimin e zbatimit të këtij ligji, shfuqizohet Rregullorja për mënyrën e matjes së dënimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 64/14).

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", kurse do të fillojë të zbatohet pas kalimit të gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi.

III dënim në para ose burg deri në 6 muaj	Në para	30 ditë - 6 m	3-6 m	3-6 m	3-6 m
	5-80 gjoba ditore	60-120 gjoba ditore	100-180 gjoba ditore	160-240 gjoba ditore	200-280 gjoba ditore
IV burg deri në 6 muaj	30 ditë - 3 m	30 ditë - 6 m	3-6 m	3-6 m	3-6 m
V dënim në para ose burg deri në 1 vit	dënim me para/30 ditë deri 2 muaj 5-120 gjd	3-5 m 60-200 gjd	4-6m 100-280 gjd	5-7m 140-360 gjd	7-9m jo
VI burg deri në 1 vit dhe dënim në para	30 ditë deri 2 m dhe në para	3-5m dhe në para	4-6 m dhe në para	5-7 m dhe në para	7-9 m dhe në para
VII dënim në para ose burg nga 3 muaj deri 1 vit	në para/3 muaj 5-120 gjd	3-5 m 60-200 gjd	4-6m 100-280 gjd	5-7m 140-360 gjd	7-9m jo
VIII burg prej 3 muaj deri në 1 vit	3-4 m	3-5 m	4-6m	5-7m	7-9m
					9-12m

IX Dënim në para ose burg prej gjashtë muaj deri në një vit	Në para/6 muaj 5-120 gjd	6-8 m 60-200 gjd	7-9m 100-280 gjd	8-10 m 140-360 gjd	9-12m jo	10-12 m jo
X Burg prej gjashtë muaj deri në një vit	6-7 m.	6-8 m	7-9m	8-10 m	9-12m	10-12 m
XI dënim në para ose burg deri në 3 vite	30 ditë -12 m 6 m 5-120 gjd	6-18 m 12m 100-240 gjd	12-24m 12 m 200-360 gjd	18-30 m 24 m jo	26-36 m 31 m jo	30-36 m 33 m jo
XII burg deri në 3 vite dhe dënim në para	30 ditë - 12 m dhe në para 6 m	6-8 m dhe në para 12m	12-24 m dhe në para 18 m	18-30 m dhe në para 24 m	26-36 m dhe në para 31 m	30-36 m dhe në para 33 m
XIII dënim në para ose burg prej 3 muaj deri 3 vite	3-12m 8 m 5-120 gjd	6-18 m 12m 100-240 gjd	12-24m 18 m 200-360 gjd	18-30 m 24 m jo	26-36 m 31 m jo	30-36 m 33 m jo
XIV burg prej 3 muaj deri 3 vite	3-12m 8 m	6-18 m 12m	12-24m 18 m	18-30 m 24 m	26-36 m 31 m	30-36 m 33 m

XV бург преј 6 муај дер 2 вите dhe дѐним нѐ пара	6-12 m dhe нѐ пара 9 m	9-15 m нѐ пара 12m	12-18m нѐ пара 15 m	12-24m нѐ пара 18 m	52-24m нѐ пара 20 m	18-24 m. нѐ пара 21 m
XVI дѐним ме пара осе бург преј 6 муај дер 3 вите	6-15 m 10 m 5-120 gjd	12-18m 15 m 100-240 gjd	12-24m 12 m 200-360 gjd	18-36 m 27 m jo	26-36 m 31 m jo	30-36 m 33 m jo
XVII бург преј 6 муај дер нѐ 3 вите	6-15 m 10 m	12-18m 15 m	12-24m 12 m	18-36 m 27 m	26-36 m 31 m	30-36 m 33 m
XVIII бург преј 6 муај дер нѐ 3 вите dhe дѐним нѐ пара	6-15 m. dhe нѐ пара 10 m	12-18 m нѐ пара 15 m	12-24m нѐ пара 12 m	18-36 m нѐ пара 27 m	26-36 m. нѐ пара 31 m	30-36 m. нѐ пара 33 m
XIX дѐним нѐ пара осе бург преј 1 дер 3 вите	12-16 m 14 m 5-120 gjd	12-20 m 16 m 100-240 gjd	18-26 m 22 m. 200-360 gjd	20-36 m 28 m jo	26-36 m 31 m jo	30-36 m 33 m jo

XX burg prej 1 vit deri në 3 vite	12-16 m 14 m	12-20 m 16 m	18-26 m 22 m	20-36 m 28 m	26-36 m 31 m	30-36 m 33 m
XXI dënim në para ose burg deri në 4 vite	30 ditë -12 m 6 m 5-120 gjd	6-18 m 12m 100-240 gjd	12-24m 12 m 200-360 gjd	18-30 m 24 m jo	26-36 m 31 m jo	30-48 m 39 m jo
XXII dënim në para ose burg deri në 5 vite	30 ditë -12 m 6 m 5-120 gjd	6-18 m 12m 100-240 gjd	18-30 m 24 m 200-360 gjd	24-36 m 30 m jo	30-48 m 39 m jo	48-60 m 54 m jo
XXIII burg deri në 5 vite dhe dënim në para	30 ditë - 12 dhe në para 6 m	6-18 m dhe në para 12m	18-30 m dhe në para 24 m	24- 36 m dhe në para 30 m	30- 48 m dhe në para 39	48- 60 m. dhe në para 54
XXIV burg prej 3 muaj deri në 5 vite	3-24 m 18 m	9-30 m 20 m	12-36 m 24 m	24-48 m 36 m	36-54 m 45 m	48-60 m 54 m
XXV dënim në para ose burg prej 6 muaj deri në 5 vite	6-24 m. 15 m. 5-120 gjd	12-30 m. 21 m. 100-240 gjd	18-36 m. 27 m. 200-360 gjd	24-48 m. 36 m. jo	36-54 m. 45 m. jo	48-60 m. 54 m. jo

XXVI бург преј 6 муај дер не 5 vite	6-24 m. 15 m.	12-30 m. 21 m.	18-36 m. 27 m.	24-48 m. 36 m.	36-54 m. 45 m.	48-60 m. 54 m.
XXVII бург преј 6 муај дер не 5 vite dhe dënim ne para	6-24 m. dhe ne para 15 m.	12-30 m. dhe ne para 21 m.	18-36 m. dhe ne para 27 m.	24-48 m. dhe ne para 36 m.	36-54 m. dhe ne para 45 m.	48-60 m. dhe ne para 54 m.
XXVIII dënim ne para ose бург преј 1 deri ne 5 vite	12-24 m. 18 m. 5-120 gjd	18-30 m. 24 m. 100-240 gjd	24-36 m. 30 m. 200-360 gjd	30-48 m. 39 m. jo	36-54 m. 45 m. jo	48-60 m. 54 m. jo
XXIX бург преј 1 deri ne 5 vite	12-24 m. 18 m.	18-30 m. 24 m.	24-36 m. 30 m.	30-48 m. 39 m.	36-54 m. 45 m.	48-60 m. 54 m.
XXX бург преј 1 deri ne 5 vite dhe dënim ne para	12-24 m. dhe ne para 18 m.	18-30 m. dhe ne para 24 m.	24-36 m. dhe ne para 30 m.	30-48 m. dhe ne para 39 m.	36-54 m. dhe ne para 45 m.	48-60 m. dhe ne para 54 m.
XXXI бург преј 3 deri ne 5 vite	36-40 m. 38 m.	40-46 m. 43 m.	44-50 m. 47 m.	46-52 m. 49 m.	48-56 m. 52 m.	52-60 m. 56 m.,
XXXII Бург преј tre муај deri ne 6 vite ose dënim ne para	3-24 m 18 m 5-120 gjd	9-30 m 20 m 100-240 gjd	12-36 m 24 m 200-360 gjd	24-48 m 36 m jo	36-60 m 48 m jo	48-72 m 60 m jo

XXXIII burg prej 1 deri në 8 vite	12-36 m. 24 m.	24-40 m. 32 m.	36-48 m. 42 m.	42-54 m. 48 m.	48-60 m. 54 m.	60-96 m. 78 m.
XXXIV burg prej 1 deri në 8 vite dhe dënim në para	12-36 m. dhe në para 24 m.	24-40 m. dhe në para 32 m.	36-48 m. dhe në para 42 m.	42-54 m. dhe në para 48 m.	48-60 m. dhe në para 54 m.	60-96 m. dhe në para 78 m.
XXXV burg prej 3 deri në 8 vite	36-48 m. 42 m.	42-54 m. 48 m.	48-60 m. 54 m.	60-72 m. 66 m.	72-84 m. 78 m.	84-96 m. 90 m.
XXXVI burg prej 5 deri në 8 vite	60-66 m. 63 m.	62-68 m. 65 m.	64-70 m. 67 m.	68-78 m. 73 m.	72-84 m. 78 m.	84-96 m. 90 m.
XXXVII dënim në para ose burg prej 1 deri në 10 vite	12-36 m. 24 m. 5-120 gjd	24-48 m. 36 m. 100-240 gjd	42-66 m. 54 m. 200-360 gjd	60-84 m. 72 m. jo	72-96 m. 84 m. jo	90-120 m. 105 m. jo
XXXVIII burg prej 1 deri në 10 vite	12-36 m. 24 m.	24-48 m. 36 m.	42-66 m. 54 m.	60-84 m. 72 m.	72-96 m. 84 m.	90-120 m. 105 m.
XXXIX burg prej 1 deri në 10 vite dhe dënim në para	12-36 m. dhe në para 24 m.	24-48 m. dhe në para 36 m.	42-66 m. dhe në para 54 m.	60-84 m. dhe në para 72 m.	72-96 m. dhe në para 84 m.	90-120 m. dhe në para 105 m.
XL burg prej 3 deri në 10 vite	36-50 m. 43 m.	44-64 m. 54 m.	58-78 m. 68 m.	72-92 m. 82 m.	86-106 m. 96 m.	100-120 m. 110 m.

XL I burg prej 4 dëri 10 në vite	48-60 m 54 m.	54-72 m 63 m.	60-78 m 69 m.	72-92 m 82 m.	86-106 m 96 m.	100-120 m 110 m.
XL II burg prej 5 deri në 10 vite	60-72 m. 66 m.	66-78 m. 72 m.	72-84 m. 78 m.	80-92 m. 86 m.	86-106 m. 96 m.	100-120 m. 110 m.
XL III së paku 1 vit burg	12-86 m. 48 m.	24-96 m. 60 m.	66-132 m. 99 m.	84-156 m. 120 m.	120-192 m. 156 m.	182-240 m. 211 m.
XL IV së paku 2 vite burg	24-90 m. 57 m.	36-102 m. 69 m.	72-138 m. 105 m.	90-162 m. 126 m.	126-198 m. 162 m.	188-240 m. 214 m.
XL V dënim në para ose burg prej së paku 3 vite	36-96 m. 66 m. 5-280 gjd	48-108 m. 78 m. 260-360 gjd	78-144 m. 111 m. jo	96-168 m. 132 m. jo	132-204 m. 168 m. jo	194-240 m. 217 m. jo
XL VI së paku 3 vite burg	36-96 m. 66 m.	48-108 m. 78 m.	78-144 m. 111 m.	96-168 m. 132 m.	132-204 m. 168 m.	194-240 m. 217 m.
XL VII së paku 4 vite burg	48-102 m. 75 m.	60-114 m. 87 m.	84-150 m. 117 m.	102-174 m. 138 m.	138-210 m. 174 m.	200-240 m. 220 m.
XL VIII së paku 4 vite burg dhe dënim në para	48-102 m. dhe në para 75 m.	60-114 m. dhe në para 87 m.	84-150 m. dhe në para 117 m.	102-174 m. dhe në para 84 m.	138-210 m. dhe në para 24 m.	200-240 m. dhe në para 220 m.

XLIX сè пaku 5 vite bur	60-108 m. 84 m.	72-120 m. 96 m.	90-156 m. 123 m.	108-180 m. 144 m.	144-216 m. 180 m.	206-240 m. 223 m.
L сè пaku 8 vite burg	96-126 m. 111 m.	108-138 m. 123 m.	114-174 m. 144 m.	126-198 m. 162 m.	160-222 m. 191 m.	212-240 m. 226 m.
LI сè пaku 10 vite burg	120-138 m. 129 m.	132-150 m. 141 m.	138-186 m. 162 m.	144-210 m. 177 m.	172-228 m. 200 m.	218-240 m. 229 m.
LII сè пaku 12 vite burg	144-180 m. 162 m.	156-192 m. 174 m.	168-204 m. 186 m.	180-216 m. 198 m.	192-234 m. 213 m.	224-240 m. 232 m.
LIII сè пaku 5 vite burg, ose burg i pëjjetshëm	60-114 m. ose 40 vite burg 87 m.	72-126 m. ose 40 vite burg 99 m.	90-162 m. ose 40 vite burg 126 m.	108-186 m. ose burg i pëjjetshëm 174 m.	144-222 m. ose burg i pëjjetshëm 183 m.	206-240 m. ose burg i pëjjetshëm 223 m.
LIV сè пaku 10 vite burg, ose burg i pëjjetshëm	120-114 m. ose 40 vite burg 132 m.	132-156 m. ose 40 vite burg 144 m.	138-192 m. ose 40 vite burg 165 m.	144-216 m. ose burg i pëjjetshëm 180 m.	172-234 m. ose burg i pëjjetshëm 203 m.	218-240 m. ose burg i pëjjetshëm 229 m.
LV сè пaku 15 vite burg, ose burg i pëjjetshëm	180-210 m. ose 40 vite burg 195 m.	186-216 m. ose 40 vite burg 201 m.	192-222 m. ose 40 vite burg 207 m.	198-228 m. ose burg i pëjjetshëm 213 m.	204-234 m. ose burg i pëjjetshëm 219 m.	222-240 m. ose burg i pëjjetshëm 231 m.

SHTOJCA numër 2

I. SHKALLA E PËRGJEGJËSISË PENALE					
rend.	LEHTËSUESE	pikë	rend.	RËNDUESE	pikë
1	pengesa mentale ose trupore	10	1	planifikimi i veprës penale	8
2	tejkalimi i imbrojtjes së detyrueshme	10	2	përpjekje e madhe gjatë realizimit	6
3	nevojë e skajshme	10		të veprës penale konkrete	
4	përgjegjshmëri e zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme	7			
5	pakujdesi				
	nëse nuk është element i veprës	6			
6	tentim nëse nuk është paraparë				
	dënim i veçantë për tentim	6			
7	nxitje e madhe pa fajin e tij				
	nëse nuk është element i veprës	5			
8	përgjegjshmëri e zvogëluar	4			
9	pjesmarje në realizim të aktit kriminal				
	nuk është ekzekutues direkt (psh. ka bërë roje, etj.)	4			
10	paramendim eventual				
	nëse nuk është element i veprës	3			
II. MOTIVE PREJ TË CILAVE ËSHTË KRYER VEPRA PENALE					
rend.	LEHTËSUESEE	pikë	rend.	RËNDUESE	pikë
1	ndihmë personit tjetër	6	1	urrejtie nacionale/fetare/racore	8
			2	lloj tjetër i urrëjtjes përcazim gjinor/i moshës/ seksual person me hendikep dhe ngjashëm	6
			3	vepra penale është kryer pa pretekst ose arsye	5
			4	sjellje e pakujdesshme nëse nuk është rrethanë kualifikuese e veprës	3
			5	tinëzi nëse nuk është rrethanë kualifikuese e veprës	3
			6	lakmi nëse nuk është rrethanë kualifikuese e veprës	3
			7	xhelozii	2
			8	zili	2

III. FORCA E RREZIKIMIT OSE CENIMIT TË SË MIRËS SË MBROJTUR					
ren.	LEHTËSUESE	pikë	ren.	RËNDUESE	pikë
1	nuk është krijuar pasojë e dëmshme nëse nuk është element i veprës	2	1	vrazhdësi/barbari/shprehje e kënaqësisë dhe ngjashëm nëse nuk janë elemente të	
2	mungesë e pasojës së përhershme	2		veprës penale	10
3	mosinteresim i të dëmtuarit për përndjekje	1	2	shpeshësi e kryerjes së veprës konkrete penale - si dukuri	9

IV. RRETHANA NË TË CILAT ËSHTË KRYER VEPRA					
ren.	LEHTËSUESE	pikë	ren.	RËNDUESE	pikë
1	nëse vetë është lënduar (tek vepra penale nga pakujdesia)	2	1	shfrytëzim i pafuqisë së viktimës	10
			2	nëse shuma e dobisë kundërligjore pronësore ose dëmi i shkaktuar trefish e tejkalon shumën e determinuar të paraparë në KP për veprë penale adekuate (neni. 122 p.33, 34, 35, 36 të KP)	8
			3	vepra është kryer në vend publik/ në prani të fëmijëve/ në përbërje të grupit nëse nuk paraqet vepër të veçantë penale/gjatë kryerjes së veprës janë rrezikuar edhe persona të tjerë	7
			4	shfrytëzimi i pozitës të caktuar cilësisë ose raportit të besimit numër më i madh i të dëmtuarve/viktimave	7
			5	(tri ose më shumë) pa dallim sa prej tyre kanë paraqitur kërkesë pronësore-juridike.	4

V. KONTRIBUTI I VIKTIMËS NË KRYERJEN E VEPRËS				
ren.	LEHTËSUESE	pikë	ren.	RËNDUESE
1	kontributi i të dëmtuarit	4		pikë

VI. JETA E MËPARSHME E KRYERËSIT				
ren.	LEHTËSUESE	pikë	Ren.	RËNDUESE
1	nuk mbahet procedurë për vepër tjetër penale	5	1	shqetësim i përparshëm i të dëmtuarit
			2	masa të shqiptuara të sigurisë
			3	i dënuar për kundërvajtje
				7
				4
				2

VII. RASTE PERSONALE DHE SJELLJE PAS VEPRËS SË KRYER PENALE				
ren.	LEHTËSUESE	pikë	ren.	RËNDUESE
1	dëm i kompensuar/ pasoja të dëmshme të mënjanuara		1	i zhduk gjurmët dhe dëshmitë nëse nuk është vepër e veçantë penale
	para fillimit të procedurës	8		ndikon mbi dëshmitarët/ persona
2	dhënie ndihmë viktimës		2	ekspertë
	para fillimit të procedurës	5		për paraqitje të rrejshme të fakteve - nëse nuk është vepër e veçantë penale
				10
3	ka kryer arsim	2		u premtan shpërblim dëshmitarëve/personave të ekspertë
			3	ekspertë

4	shprehje keqardhjeje dhe pendimi për shkak të		2	dhe ngjashëm për paraqitje të rrejshme të akteve – nëse nuk është vepër e veçantë penale	10
5	veprës së kryer penale		1		
6	ka lidhur kurorë		1	4 mungesë e pendimit edhe krahas pranimit të të akuzuarit	2
7	është punësuar		1		
	sjellje korrekte gjatë procedurës penale		1		
8	Kontribut në përfundimin efikas të procedurës penale		1		

VIII. RRETHANA TJERA TË CILAT KANË TË BËJNË ME PERSONALITETIN E KRYERËSIT

ren.	LEHTËSUESE	pikë	ren.	RËNDUESE	pikë
1	gjendje e keqe shëndetësore	4	1	vepra penale është kryer gjatë kohës së vuajtjes së dënimit me burg-vikendit	10
2	gjendje e keqe shëndetësore e anëtarëve të familjes më të ngushtë të të akuzuarit me të cilët jeton në bashkësi familjare	3	2	arratisë dhe ngjashëm vepra penale është kryer gjatë kohës së lëshimit me kusht	9
3	gjendja e keqe materiale gjendja pronësore shfrytëzues i ndihmës sociale i papunësuar – të hyra tjera	2	3	vepra penale është kryer gjatë kohës së kontrollit të gjykimit me kusht	9
			4	autoriteti në shoqëri përkatësisht në bashkësinë ku jeton -	

4	gjendje familjare: i martuar – fëmijë mbajtës i vetëm i familjes kujdes për persona të tjerë (prind, vëlla, motër etj.).			vetëm për vepra penale të kryera me paramendim ose me fjalim të urrejtjes dhe ngjashëm	8
				5 karakter i dhunshëm	5
5	moshë - mbi 60 vjet ose i moshës madhore më i ri	2		6 sëmundje të varësisë	4
6	autoriteti në shoqëri përkatësisht në bashkësinë ku jeton	2		7 rrethana ose aftësi të posaçme të kryerësit	2
	vetëm për vepra penale të kryera nga pakujdesia			8 sjellje asociale	1
				9 përvoja e kryerësit	1
7	i punësuar	1		10 kryerësi ka nivel të ulët të kulturës dhe sjellje negative ndaj vlerave të pranuarra përgjithësisht	1
8	ka arsimim të kryer	1			
9	niveli i kulturës dhe sjellja ndaj vlerave				
	të pranuarra përgjithësisht	1			
10	mirënjohje shoqërore (çmime, dekorata dhe ngjashëm),	1			

IX. VEPRA E MËPARSHME ËSHTË E LLOJIT TË NJËJTË SI DHE VEPRA E RE, VEPRAT JANË KRYER NGA MOTIVET TË NJËJTA DHE KOHA E KALUAR NGA GJYKIMI I MËPARSHËM, PËRKATËSISHT NGA DËNIMI I VUAJTUR OSE I FALUR					
ren.	LEHTËSUESE	pikë	ren.	RËNDUESE	pikë
1	ka kaluar kohë më e gjatë nga dënimi		1	ka kaluar kohë e shkurtër nga dënimi	
	i vuajtur me burg (më shumë se 10 vjet)	4		i vuajtur paraprak me burg (deri në tri vjet)	4

SHTOJCA numër 3

FLETA E PUNËS A

RRETHANA LEHTËSUESE

I. SHKALLA E PËRGJEGJËSISË PENALE

1. pengesë mentale ose trupore10

po ☐ jo ☐

2. tejkalim i mbrojtjes së nevojshme10

po ☐ jo ☐

3. nevojë e skajshme10

po ☐ jo ☐

4. përgjegjshmëri dukshëm e zvogëluar7

po ☐ jo ☐

5. pakujdesi nëse nuk është element i veprës6

po ☐ jo ☐

6. tentim nëse nuk është paraparë dënim i veçantë për tentim6

po ☐ jo ☐

7. zemërim i madh pa fajin e tij nëse nuk është element i veprës 5

po ☐ jo ☐

8. përgjegjshmëri e zvogëluar4

po ☐ jo ☐

9. pjesëmarrje në realizimin e aktit kriminal - nuk është kryerës i drejtpërdrejtë (për shembull ka bërë roje dhe ngjashëm) 4

po ☐ jo ☐

10. paramendim eventual nëse nuk është element i veprës3

po ☐ jo ☐

II. MOTIVE PËR TË CILAT ËSHTË KRYER VEPRA PENALE

1. ndihmë personit tjetër 6

po ☐ jo ☐

III. FORCA E RREZIKIMIT OSE CENIMIT TË SË MIRËS SË MBROJTUR

1. nuk është krijuar pasojë e dëmshme nëse nuk është element i veprës 2

po ☐ jo ☐

2. mungesë e pasojës së përhershme 2

po ☐ jo ☐

3. mosinteresim i të dëmtuarit për ndjekje 1

po ☐ jo ☐

IV. RRETHANA NË TË CILAT ËSHTË KRYER VEPRA

1. nëse vetë është lënduar (te vepra penale nga pakujdesia)2

po ☐ jo ☐

V. KONTRIBUTI I VIKTIMËS NË KRYERJEN E VEPRËS

1. kontributi i të dëmtuarit4

po ☐ jo ☐

VI. JETA E MËPARSHME E KRYERËSIT

1. nuk mbahet procedurë për vepër tjetër penale 5

po ☐ jo ☐

VII. RRETHANA PERSONALE DHE SJELLJA PAS VEPRËS SË KRYER PENALE

1. dëm i kompensuar/pasoja të dëmshme të mënjanuara para fillimit të procedurës8

po ☐ jo ☐

2. dhënie ndihmë viktimës para fillimit të procedurës 5

po ☐ jo ☐

3. ka kryer arsimim 2

po ☐ jo ☐

4. shprehje e keqardhjes dhe pendimit për kryerjen e veprës penale 2

po ☐ jo ☐

5. është martuar 1

po ☐ jo ☐

6. është punësuar 1

po ☐ jo ☐

7. sjellje korrekte gjatë procedurës penale 1

po ☐ jo ☐

8. kontributi në përfundimin efikas të procedurës penale 1

po ☐ jo ☐

VIII. RRETHANA TJERA TË CILAT KANË TË BËJNË ME PERSONALITETIN E KRYERËSIT

1. gjendje e keqe shëndetësore 4

po ☐ jo ☐

2. gjendje e keqe shëndetësore e anëtarëve të familjes më të ngushtë të të akuzuarit me të cilët jeton në bashkësi familjare 3

po ☐ jo ☐

3. gjendje e keqe materiale, gjendje pronësore, shfrytëzues i ndihmës sociale, i papunësuar – të hyra të tjera 2

po ☐ jo ☐

4. gjendja familjare: grua-fëmijë, mbajtës i vetëm i familjes, përkujdesje për persona tjerë (prindër, vëlla, motër etj.) 2

po ☐ jo ☐

5. mosha – mbi 60 vjet ose i moshës madhore më i ri 2

po ☐ jo ☐

6. autoriteti në shoqëri përkatësisht në bashkësinë ku jeton vetëm për vepra penale të kryera nga pakujdesia 2

po ☐ jo ☐

7. i punësuar 1

po ☐ jo ☐

8. ka kryer arsimim 1

po ☐ jo ☐

9. niveli i kulturës dhe sjellja ndaj vlerave të pranuar përgjithësisht 1

po ☐ jo ☐

10. mirënjohje shoqërore (çmime, dekorata dhe ngjashëm) 1

po ☐ jo ☐

IX. VEPRA E MËPARSHME ËSHTË E LLOJIT TË NJËJTË SI DHE VEPRA E RE,
VEPRAT JANË TË KRYERA NGA MOTIVE TË NJËJTA DHE KOHA E KALUAR NGA
GJYKIMI I MËPARSHËM, PËRKATËSISHT NGA DËNIMI I VUAJTUR OSE I FALUR

1. ka kaluar kohë më e gjatë nga dënimi me burg i vuajtur paraprakisht (më shumë se 10 vjet) 4

po ☐ jo ☐

10.TËTJERA¹

.....
.....
.....
.....

PËRSHKRIMI

.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....

.....

GJITHSEJ:

¹ Me rrethana tjera lehtësuese nënkuptohen rrethanat lehtësuese të cilat nuk janë në listën e sipërme, ndërsa janë specifike për vepra të caktuara penale dhe mund të vlerësohen me gjithsej më së shumti **10 pikë**.

SHTOJCA 4

FLETA E PUNËS B

RRETHANA RËNDUESE

I. SHKALLA E PËRGJEGJËSISË PENALE

1. planifikimi i veprës penale 8

po ☐ jo ☐

2. vendosmëri e madhe gjatë kryerjes së veprës konkrete penale 6

II. MOTIVE PËR TË CILAT ËSHTË KRYER VEPRA PENALE

1. urrejtje nacionale/fetare/racore 8

po ☐ jo ☐

2. lloj tjetër i urrejtjes: gjinia/mosha/përcaktimi seksual/persona me hendikep dhe ngjashëm 6

po ☐ jo ☐

3. vepra penale është kryer pa pretekst ose arsye 5

po ☐ jo ☐

4. sjellje e pakujdesshme nëse nuk është rrethanë kualifikuese e veprës 3

po ☐ jo ☐

5. tinëzi nëse nuk është rrethanë kualifikuese e veprës 3

po ☐ jo ☐

6. lakmi nëse nuk është rrethanë kualifikuese e veprës 3

po ☐ jo ☐

7. xhelozia 2

po ☐ jo ☐

8. zili 2

po ☐ jo ☐

III. FORCA E RREZIKIMIT OSE CENIMIT TË SË MIRËS TË MBROJTUR

1. vrazhdësi/barbari/shprehje e kënaqësisë dhe ngjashëm nëse nuk është element i veprës penale 10

po ☐ jo ☐

2. shpeshtësi e kryerjes së vepër konkrete penale – si dukuri 9

po ☐ jo ☐

IV. RRETHANA NË TË CILAT ËSHTË KRYER VEPRA

1. shfrytëzimi i pafuqisë së viktimës 10

po ☐ jo ☐

2. nëse shumta e dobisë pronësore kundërligjore ose dëmi i shkaktuar trefish e tejkalon shumën e determinuar të paraparë në KP për veprën përkatëse penale (neni 122 p. 33, 34, 35, 36 të KP) 8

po ☐ jo ☐

3. vepra është kryer në vend publik/ në prani të fëmijëve/në përbërje të grupit nëse nuk paraqet vepër të veçantë penale/gjatë kryerjes së veprës janë rrezikuar persona tjerë 7

po ☐ jo ☐

4. shfrytëzim i pozitës së caktuar, cilësisë ose raportit të besimit 7

po ☐ jo ☐

5. numër më i madh i të dëmtuarve/viktimave (3 ose më shumë) pa dallim sa prej tyre kanë paraqitur kërkesë pronësore-juridike 4

po ☐ jo ☐

V. KONTRIBUTI I VIKTIMËS NË KRYERJEN E VEPRËS

VI. JETA E MËPARSHME E KRYERËSIT

1. shqetësim i mëparshëm i të dëmtuarit 7

po ☐ jo ☐

2. masa të shqiptuara të sigurisë 4

po ☐ jo ☐

3. i dënuar për kundërvajtje 2

po ☐ jo ☐

VII. RRETHANA PERSONALE DHE SJELLJA PAS VEPRËS SË KRYER PENALE

1. i zhduk gjurmët dhe dëshmitë nëse nuk është vepër e veçantë penale 10

po ☐ jo ☐

2. ndikon mbi dëshmitarë/persona ekspertë për paraqitje të rrejshme të fakteve/nëse nuk është vepër e veçantë penale 10

po ☐ jo ☐

3. u premtan shpërblim dëshmitarëve/personave ekspertë për paraqitje të rrejshme të fakteve/nëse nuk është vepër e veçantë penale 10

po ☐ jo ☐

4. mungesë e pendimit edhe krahas pranimit të të akuzuarit 2

po ☐ jo ☐

VIII. RRETHANA TJERA TË CILAT KANË TË BËJNË ME PERSONALITETIN E KRYERËSIT

1. vepra penale është kryer gjatë kohës së vuajtjes së dënimit me burg - vikendit, arratisë dhe ngjashëm 10

po ☐ jo ☐

2. vepra penale është kryer gjatë kohës së lëshimit me kusht 9

po ☐ jo ☐

3. vepra penale është kryer gjatë kohës së kontrollit të gjykimit me kusht 9

po ☐ jo ☐

4. autoriteti në shoqëri përkatësisht në bashkësinë ku jeton/ - vetëm për vepra penale të kryera me paramendim ose me fjalim të urrejtjes dhe ngjashëm 8

po ☐ jo ☐

5. karakter i dhunshëm 5

po ☐ jo ☐

6. sëmundje të varësisë 4

po ☐ jo ☐

7. prirje ose aftësi të veçanta të kryerësit 2

po ☐ jo ☐

8. sjellje asociale 1

po ☐ jo ☐

9. përvoja e kryerësit 1

po ☐ jo ☐

10. kryerësi ka nivel të ulët të kulturës dhe sjellje negative ndaj vlerave të pranuar përgjithësisht 1

po ☐ jo ☐

IX. VEPRA E MËPARSHME ËSHTË E LLOJIT TË NJËJTË SI DHE VEPRA E RE,
VEPRAT JANË TË KRYERA NGA MOTIVE TË NJËJTA DHE KOHA E KALUAR NGA
GJYKIMI I MËPARSHEM, PËRKATESISHT NGA DËNIMI I VUAJTUR OSE I FALUR

1. ka kaluar kohë e shkurtër nga dënimi me burg i vuajtur paraprakisht (deri në 3 vjet) 4

po ☐ jo ☐

10. TËTJERA².....
.....
.....
.....

PËRSHKRIMI

..... GJITHSEJ:

² Me rrethana tjera rënduese nënkuptohen rrethanat rënduese të cilat nuk janë në listën e sipërme, ndërsa janë specifike për vepra të caktuara penale dhe mund të vlerësohen me gjithsej më së shumti **10 pikë**.

SHTOJCA 5

FLETA E PUNËS V

PROCEDURA PËR PËRCAKTIMIN E SANKSIONIT

1. Lënda sipas kategorizimit objektiv të veprës penale bën pjesë në _____ kategorinë horizontale.

2. Sipas të dhënave për jetën e mëparshme të kryerësit lënda bën pjesë në _____ kolonën vertikale, për të cilën është paraparë dënim prej _____ me vlerë mesatare prej _____.

3. Pas evaluimit të kryer të të gjitha rrethanave nëpërmjet fletëve të punës A dhe B gjykata përcaktoi se dominojnë rrethana lehtësuese - rënduese.

3.1 Lehtësuese:

3.2 Rënduese:

Dallimi: _____

4. Nëse gjykata përcakton dënim me burg në kohëzgjatje deri në 24 muaj, e gjatë evaluimit në masë të konsiderueshme dominojnë rrethana lehtësuese, me ç'rast dallimi është së paku 5 pikë në dobi të rrethanave lehtësuese, mundet dënimin e tillë të përcaktuar me burg ta kushtëzojë ose të zbatojë ndonjërin nga masat tjera alternative të parapara me nenin 48-a të Kodit penal, nëse vlerëson se edhe me gjykimin e shqiptuar me kusht ose masës tjetër alternative, do të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të parandalimit special dhe të përgjithshëm.

5. Rrethana për ndryshim të klasifikimit në më të rëndë:

5.1 Përsëritës special;

5.2 Vepër e vazhduar penale;

Gjykata nëse vlerëson se ekziston ndonjëra nga rrethanat e lartpërmendura gjatë matjes së dënimit, e në korniza të kategorisë së njëjtë, do ta klasifikojë veprën penale në kolonat më rigorozë vertikale, me ç'rast nuk mund të lëvizë më shumë se dy kolona në të djathtë nga kolona në të cilën është klasifikimi themelor i veprës.

Pas riklasifikimit të kryer lënda sipas kategorizimit objektiv të veprës penale bën pjesë në _____ kategorinë horizontale.

Sipas të dhënave për jetën e mëparshme të kryerësit lënda bën pjesë në _____ kolonën vertikale, për të cilën është paraparë dënim prej _____ me vlerë mesatare prej _____.

6. Gjatë shqiptimit të sanksionit penal për vepra penale për të cilat të akuzuarit njëkohësisht i gjykohej, gjykata paraprakisht do t'i përcaktojë dënimet për çdonjërin nga ato vepra në pajtim me dispozitat e këtij ligji e mandej për të gjitha veprat do të shqiptojë dënim unik me zbatimin e dispozitës nga neni 44 të KP.



Службен весник
на Република Македонија



www.slvesnik.com.mk

contact@slvesnik.com.mk

Издавач: ЈП СЛУЖБЕН ВЕСНИК НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА, ц.о. Ы Скопје

бул. „Партизански одреди“ бр. 29. Поштенски фах 51.

в. д. директор и одговорен уредник – м-р Тони Трајанов

телефон: +389-2-55 12 400

телефакс: +389-2-55 12 401

Претплатата за 2014 година изнесува 10.100 денари.

„Службен весник на Република Македонија“ излегува по потреба.

Рок за рекламации: 15 дена.

Жиро-сметка: 300000000188798.

Депонент на Комерцијална банка, АД Ы Скопје.

Печат: ГРАФИЧКИ ЦЕНТАР ДООЕЛ, Скопје.

Цената на овој број е 280 денари.

ISSN 0354-1622



2014199